

ETIKA



SHQETËSIMI
I NJË BESIMTARI
PËR BREZAT

OSMAN NURI TOPBASH



MIRËSIA E DASHURISË
ZEJNEB ALLBAJRAK

DR. MURAT KAJA
PO HUMBET NJË AMANET...



NUREDIN JËLLDËZ
SI ISHIN ATO DITË...



LUTFI ISMAIL ÇAKAN
DINJITETI NJERËZOR




PROF. DR. SULEJMAN DERIN
FUQIA E LUTJES



Pishtari *i njerëzimit*

Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË



Prill 2015

VITI: IX

NUMRI: 85

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.revistaetika.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Ai (a.s), nuk ishte prijës i një populli, i një kohe dhe i një vendi të caktuar.

Ai (a.s), ishte prijësi i të gjithë njerëzimit, i të gjitha kohërave dhe i të gjithave vendeve.

Ai (a.s), ishte edukuar nga Vetë Zoti në mënyrën më të bukur.

Ai (a.s), i ishte dërguar njerëzimit si **"Usue-i Hasene/Shembulli më i bukur"**.

Ai (a.s), kishte një moral shumë të lartë, për të cilin ka dëshmuar Vetë Allahu Teala. (Kalem, 4)

Ai (a.s), ishte i vetëdijshëm se me këtë moral të lartë, të cilin e kishte arritur në sajë të edukimit hyjnor, ishte dërguar si prijës për njerëzimin.

Në kohën kur jetoi, e mori një brez njerëzish prej buzës së gropës së zjarrit dhe e barti në atmosferën e lumturisë.

Moralin e tij, pra thelbin e personalitetit të tij fisnik, Krijuesi i Lartmadhëruar e kishte përkufizuar si **"Mëshirë për botët"**.

Nëse ai (a.s), ka ardhur në një vend, do të thotë se aty ka ardhur mëshira.

Nëse flladi i tij (a.s), ka fryrë në një zemër, do të thotë se në një vend ka fryrë flladi i mëshirës.

Ai (a.s), vetë e ka thënë, se **"është dërguar për të plotësuar moralet e larta"**.

Ndërsa Ai që tha, **"Të kemi dërguar vetëm si mëshirë për botët"**, i ngarkoi atij (a.s), detyrën e pejgamberit. Në këtë mënyrë, qelizave të virtyteve të tij morale, iu ngarkua elementi thelbësor që rrjedh nga Rrahmani, Rrahimi, Raufi.

Ai (a.s), do të nxirrte prej një shoqërie beduine, një shoqëri të civilizuar.

....

Që atëherë kaluan katërmëdhjetë shekuj.

"Mysliman", është ende ai që përpiqet ta jetojë Rasulullahun (a.s), ashtu siç ka qenë, që bëhet një me të (a.s), që unifkohet me atë (a.s), që e bart atë (a.s), ashtu siç është, në personalitetin e vet dhe që ngjyroset me ngjyrën e tij (a.s).

Sepse ai (a.s), e jetoi më bukur islamin.

Sepse ai (a.s), e jetoi më bukur Kuranin, Librin e islamit.

Sepse "moralin e tij, pra i gjithë identiteti i tij ishte Kurani". Sepse ai (a.s), u bë Kuran i gjallë.

Sepse ta jetosh atë (a.s), do të thotë të bëhesh Kuran.


Pa e jetuar atë (a.s), nuk mund të jesh mysliman, sepse ai që jeton i mangët, është mysliman i mangët.

Ai që e jeton atë (a.s), edhe sot quhet njeri i vërtetë, i drejtë, real, pra, është njeri me kuptimin e plotë të fjalës.

Sepse ai (a.s), ishte njeri i përsosur.

Ai (a.s), ishte maja, horizonti i njeriut, madje edhe përtej tij.

Përmbajtja



20

Sirishin ato ditë
Nuredin Jellëz



Shqetësimi i një besimtari për brezat
Osman Nuri Topbash

34




12

24




Nëse do të bësh plane fillo nga vetja
Mehmet Dinç

- 5 Të jetojmë rasulullahun në kohën tonë
Ahmet Tashgetiren
- 8 Dinjiteti njerëzor
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 10 Niveli i moralit është grada e besimit
Dr. Adem Ergyl
- 12 Pejgamberi (a.s.) dhe dinjiteti njerëzor
Ali Riza Temel
- 15 O robër të Allahut, ruhuni nga kundërshtimi i Tij!
Sadik Dana
- 18 Emri i tij, duhet të përmendet me respekt
Xhafer Durmush
- 22 Fuqia e lutjes
Prof. dr. Sulejman Derin



40

- Muhamedi (a.s.), projektues i qytetërimit 26
Ma. Merxhan Shehu
- Ku jeni ju, ku jemi ne? 29
Fehmi Çiçek
- Mrekullitë e Kuranit 30
- Një Ajet - Një Hadith 32
- Salim Ibn Umejr 40
Mustafa Erish
- Reflektim mbi ripërtëritjen Ikbaliste të mendimit Islam 44
Dr. Muhamed Mustafi
- Ihsani, përmasa kulmore e fesë 48
Dr. Selver Xhemali
- Rituali i çeljes 52
Edison Çeraj
- Rëndësia e edukimit të hershëm të fëmijës 54
Nuredin Nazarko



Mirësia e dashurisë
Zejneb Albajrak

42

Zemra që nuk kuptojnë
Muhamed El-Gazali

47

Të jetojmë RASULULLAHUN NË KOHËN TONË

Ahmet Tashgetiren

Ai (a.s), nuk ishte prijës i një populli, i një kohe dhe i një vendi të caktuar.

Ai (a.s), ishte prijësi i të gjithë njerëzimit, i të gjitha kohërave dhe i të gjithave vendeve.

Ai (a.s), ishte edukuar nga Vetë Zoti në mënyrën më të bukur.

Ai (a.s), i ishte dërguar njerëzimit si **“Usue-i Hase-ne/Shembulli më i bukur”**.

Ai (a.s), kishte një moral shumë të lartë, për të cilin ka dëshmuar Vetë Allahu Teala. (Kalem, 4)

Ai (a.s), ishte i vetëdijshëm se me këtë moral të lartë, të cilin e kishte arritur në sajë të edukimit hyjnor, ishte dërguar si prijës për njerëzimin.

Në kohën kur jetoi, e mori një brez njerëzish prej buzës së gropës së zjarrit dhe e barti në atmosferën e lumturisë.



Moralin e tij, pra thelbin e personalitetit të tij fisnik, Krijuesi i Lartmadhëruar e kishte përkufizuar si **“Mëshirë për botët”**.

Nëse ai (a.s), ka ardhur në një vend, do të thotë se aty ka ardhur mëshira.

Nëse flladi i tij (a.s), ka fryrë në një zemër, do të thotë se në një vend ka fryrë flladi i mëshirës.

Ai (a.s), vetë e ka thënë, se **“është dërguar për të plotësuar moralet e larta”**.

Ndërsa Ai që tha, **“Të kemi dërguar vetëm si mëshirë për botët”**, i ngarkoi atij (a.s), detyrën e pejmberit. Në këtë mënyrë, qelizave të virtyteve të tij morale, iu ngarkua elementi thelbësor që rrjedh nga Rrahmani, Rrahimi, Raufi.

Ai (a.s), do të nxirrte prej një shoqërie beduine, një shoqëri të civilizuar.

....

Që atëherë kaluan katërmëdhjetë shekuj.

“Mysliman”, është ende ai që përpigjet ta jetojë Rasulullahun (a.s), ashtu siç ka qenë, që bëhet një me të (a.s), që unifikohet me atë (a.s), që e bart atë (a.s), ashtu siç është, në personalitetin e vet dhe që ngjyroset me ngjyrën e tij (a.s).

Sepse ai (a.s), e jetoj më bukur islamit.

Sepse ai (a.s), e jetoj më bukur Kuranin, Librin e islamit.

Sepse “moralin e tij, pra i gjithë identiteti i tij ishte Kurani”. Sepse ai (a.s), u bë Kuran i gjallë.

Sepse ta jetoj atë (a.s), do të thotë të bëhesh Kuran.

Pa e jetuar atë (a.s), nuk mund të jesh mysliman, sepse ai që jeton i mangët, është mysliman i mangët.

Ai që e jeton atë (a.s), edhe sot quhet njeri i vërtetë, i drejtë, real, pra, është njeri me kuptimin e plotë të fjalës.

Sepse ai (a.s), ishte njeri i përsosur.

Ai (a.s), ishte maja, horizonti i njeriut, madje edhe përtej tij.

Ngrihu në të gjitha horizontet dhe përtej tyre do të shohësh bukurinë e tij (a.s). Magjepsu pas tij dhe në zemër ndjen dëshirën për të vrapuar drejt tij (a.s).

Të mësoh atë (a.s), është përgjegjësia e njerëzimit për edukimin themelor në të gjitha kohërat.

A.B.C-ja e njerëzimit duhet të fillojë duke gërmëzuar atë (a.s).

Në të gjitha problemet që po jeton njerëzimi, ndihet ndikimi që ka shkaktuar largimi prej tij (a.s), vendosja e distancave me të (a.s).

Le t'i shohim e t'i analizojmë jetët tona, identitetet tona.

Çfarë ka në jetët dhe identitetet tona prej **“moralit të Muhamedit (a.s)”** e çfarë nuk ka?

Si myslimanë, sa i ngajmë atij (a.s) dhe sa nuk i ngajmë?

Rasulullahun (a.s), nuk duhet ta lexojmë siç lexojmë historinë.

Nuk duhet ta ngrijmë atë në frigoriferin e historisë.

Në rrezet më të imëta të jetës sonë, duhet të bartim dritë prej Rasulullahun (a.s).

Meqenëse ai (a.s), është **“i bukur”** sipas dëshmisë hyjnore, ajo bukuri duhet të bartet në botën ku jetojmë dhe duhet mbajtur gjallë në jetët tona.

Në kohën tonë duhet të jetoj Rasulullahu (a.s).

Nëse do të ishim një shoqëri e formuar me “moralin e Muhamedit (a.s)”, një “shoqëri mëshire”, njerëzimi do ta zbulonte patjetër të fshehtë të tij.

Sot, çdo problem që po përjeton njerëzimi, është reflektimi i përmallimit të thellë që ndihet ndaj moralit dhe virtyteve të tij (a.s).

Në thelb të krizave të identitetit që po përjetojmë si myslimanë, ndodhet distanca që ka hyrë ndërmjet nesh dhe atij (a.s).

Pajisu me mëshirë ndaj tokës e qiellit, gurit e dheut, pemës e shpendit, kafshës e njeriut dhe do të përparosh drejt Muhamedit (a.s).

Nxirre gënjeshtërën prej jetës tënde.

*“Mysliman”,
është ende ai që
përpigjet ta jetojë
Rasulullahun (a.s), ashtu
siç ka qenë, që bëhet një
me të (a.s), që unifikohet
me atë (a.s), që e bart atë
(a.s), ashtu siç është, në
personalitetin e vet dhe
që ngjyroset
me ngjyrën
e tij (a.s).*

Pajisu me drejtësi.

Qëndro në rrugë të drejtë.

Dhe do të hysh në rrugën drejt Muhamedit (a.s).

Mbushu me dashuri dhe dhembshuri për familjen tënde, shihe në sy bashkëshorten, vendosi një kafshatë në gojë dhe vrapo me të në lëndina. Ndonjëherë qep diçka të shqepur në shtëpi. Dhe do të drejtohesh në atmosferën e lumturisë së tij (a.s).

Qëndro me Zotin tënd ditë e natë, e ngopu me Kuran në namaz. Ndonjëherë qëndro në kijam¹ derisa të të enjten këmbët, ndonjëherë kur je duke lexuar Kuran, le të dalë prej kraharorit tënd një zë sikur vlon kazani, ndonjëherë vëre ballin në rërë dhe loto, e ndonjëherë hapi krahët sikur do të përqafosh qiejt, që prej botës së tij (a.s), të rrjedhin ndjenja në botën tënde.

Ndonjëherë ledhatoi kokën fëmijëve, hapu krahët jetimëve.

Edhe sikur të hipin në shpinë nipërit gjatë namazit, mos ua prish qefin. Mos ki frikë, Zoti ynë nuk mërzhitet me ty. I thuaj që edhe Pejgamberi im (a.s), kështu ka vepruar.

Pranë teje të gjenden të varfrit e të mjerët. Ndaje ushqimin me ta. Ndaji vuajtjet me ta.

Bujaria jote le të fryjë si fllad përreth teje, që prej bukurisë së tij (a.s), të arrijnë fllade në botën tënde.

Mos ceno askënd, mos rrih askënd, mos shaj askënd, mos fyej askënd. Thuaj: *“Nëse dikush ka ndonjë të drejtë mbi mua, le të vijë e ta marrë, nëse kam cenuar ndokënd, ja kurrizi im, le të gjuajë”*. Pajisu me një ndjenjë që të mund ta thuash këtë, bart në vete shqetësimin ndaj botës tjetër, që në botën tënde të vendoset disiplina e jetës së tij (a.s), që ishte më e ndjeshme se peshorja e argjendarit.

Ai (a.s), ishte “Muhamedi i besueshëm”. Prandaj, bëhu njeri i besueshëm, që njerëzit të kenë besim tek ti, për gjërat që ndajnë me ty në këtë botë prej jetës, pasurisë dhe nderit. Kështu do të fitosh edhe respektin e armiqve të tu.

Mbushe zemrën me dashuri. Kur sahabët tregonin për të (a.s), thoshin: **“Çdonjëri prej nesh besonte se Rasullahu (a.s), na donte më shumë ne”**. Kjo, do të thotë që ta ngopësh me dashuri shoqërinë dhe njerëzit me të cilët jeton. Ke një Pejgamber që don-

1. Kijam: Qëndrimi në këmbë gjatë namazit.

te malin, gurin dhe Uhudin². Nëse i afrohesh botës së zemrës së tij (a.s), me dashuri do të zbukurohet bota jote.

Brenda teje, në zemrën tënde, në jetën tënde, le të jetë ai (a.s).

Jeto bashkë me të. Jeto duke e mbajtur për dore. Aty ku jeton, merr një frymë prej atmosferës së Mesxhdit Nebeui. Freskoje vetveten me Rasullahun (a.s). Kuroji ndjenjat dhe gjymtyrët e tua të vjetëruara, të rrudhura e të lodhura, me melhemin e Rasullullahut (a.s), që të shpëtosh prej sëmundjeve të shekullit.

Në fytyrën tënde le të çelin lulet e buzëqeshjes që kanë ngelur kujtim prej tij (a.s), që në çehren e vrenjtur të shekullit të vijë drita e një pejgamberi.

Të jetosh Rasullahun (a.s), në kohën tonë, do të thotë ta ndërtosh nga e para këtë kohë.

Për një kohë “ringjalljeje pas vdekjes”, për njerëzimin.

Kjo, është përgjegjësia që umeti islam nuk mund ta neglizhojë.

Dashurinë dhe mallin tënd mos i dërgo dhe mos i lër në të shkuarën, merre brenda vetes dashurinë për të (a.s) dhe ec drejt zemrës së shekullit.

Të gjithë shekujt kanë nevojë për udhëheqjen e tij (a.s). Të gjithë shekujt atë (a.s), kërkojnë.

Nëse je në gjurmët e tij (a.s), le ta shohë bota. Le ta shohë bota umetin e Muhamedit (a.s).



2. Uhud: Një mal në veri të Medinës.

Dinjiteti njerëzor

Dinjiteti i njeriut buron nga marrëdhënia që ka me Krijuesin. Përmes mesazhit hyjnor, pejgamberët kanë synuar lartësimin e dinjitetit njerëzor. Njeriu mund ta fitojë dinjitetin vetëm përmes ibadetit.

NJERIU DHE IBADETI

Njeriu është krijesa më e përsosur dhe e nderuar ndër të gjitha krijesat. Prandaj krahas jetës, pasurisë, fesë, nderit dhe pasardhësve i është marrë në mbrojtje edhe dinjiteti, krenaria dhe ndjenjat.

SHKAKU DHE QËLLIMI I KRIJIMIT TË NJERIUT

Ajeti Kuranor: **“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.”** (Dharrijat, 51) e shpreh qartë qëllimin e krijimit dhe burimin e dinjitetit të tij. Pra, dinjiteti i njeriut është i lidhur ngushtë me ibadetin ndaj Allahut.

Pengimi i njerëzve nga ibadeti ndaj Allahut është cënimi më i madh që i bëhet dinjitetit të njeriut. Pengimi i njerëzve dhe moskrijimi i kushteve për të praktikuar fenë, është përdhosje e dinjitetit të njeriut. Pengimi i njerëzve nga feja është ndër mëkatet e mëdha.

“Të pyesin ty për muajin e shenjtë, për luftën në të. Thuaju: ‘Luftimi në atë kohë është gjynah i madh, por pengimi i njerëzve prej udhës së Allahut, mohimi i Tij, pengimi i njerëzve nga vizita e Xhamisë së Shenjtë dhe dëbimi i banorëve të saj nga ajo, janë gjynah më i madh tek Allahu.” (Bekare, 217)

Kurse në një ajet tjetër, Kurani na informon se pengimi nga rruga e fesë dhe Allahut është veprim dhe investim i mosbesimtarëve:

“Në të vërtetë, jobsimtarët e shpenzojnë pasurinë e tyre për t’i penguar njerëzit nga rruga e Allahut. Ata do ta shpenzojnë atë, por në fund ajo do jetë vetëm dëshpërim për ta, sepse do të jenë të mundur.” (Enfal, 36)

Edhe qëllimi i Xhihadit është mbrojtja e dinjitetit njerëzor, nxjerrja e njeriut nga robërimi ndaj njeriut, në robërimin ndaj Krijuesit të gjithësisë.

DETYRA E PEJGAMBERËVE

Allahu në një ajet Kuranor thotë:

“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: ‘S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!” (Enbija, 25)

Kurse në një ajet tjetër thotë:

“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): ‘Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!’” (Nahl, 36)

Siç vihet re lehtësisht, ajetet përcaktojnë dy detyra kryesore të Pejgamberëve:

1. Thirrjen në Tevhid, njësimin e Allahut.
2. Tërheqjen e vëmendjes për t’u distancuar nga çdo gjë tjetër që nuk ka lidhje me Allahun.

Plotësimi i këtyre dy detyrave i jep njeriut dinjitetin dhe nderin e merituar.

Për të ruajtur të pastër Tevhidin, është e domosdoshme njohja e politeizmit. Dhe të gjithë pejgamberët ia kanë bërë të njohur bashkësisë së vet politeizmin.

POLITEIZMI

Politeizmi është t’i atribuosh cilësitë e Allahut dikujt tjetër, thënë ndryshe, t’i dedikosh krijesës cilësi hyjnore. Pra, politeizmi nuk është mohim i Zotit, por shoqërimi shok Atij. Politeizmi në Kuran konsiderohet si padrejtësi e madhe dhe faj i pafalshëm. **“Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.”** (Lukman, 13) **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.”** (Nisa, 48)

Politeizmi është shfaqur në fillim si idhujtari. Disa idhujtarë i konsideronin idhujt si ndërmjetës midis tyre dhe Zotit, kurse disa të tjerë kërkonin ndihmë prej tyre.

Shembuj primitivë të politeizmit janë shfaqur në kohën e Nuhut (a.s.). Më vonë filluan të shfaqen forma të tjera të politeizmit, si shenjtërimi i zjarrit, njerëzve, kafshëve, diellit dhe yjeve, kurse sot politeizmi na shfaqet përmes sistemeve, koncepteve dhe parimeve.

Sot disa koncepte, parime dhe sisteme janë shenjtëruar, hyznizuar. Kjo gjendje ka sjellë shfaqjen e një lloji politeizmi të ri. Shembuj të këtij politeizmi janë demokracia, modernizmi, laicizmi, teknologjia etj. Të gjitha këto kanë cenuar dinjitetin e njeriut sepse dinjiteti është shprehje e ibadetit të lirë ndaj Allahut. Nëse një person ose një shoqëri privohet nga kjo mundësi apo nuk e gjen këtë mundësi, atëherë dinjiteti i atij personi apo asaj shoqërie është nëpërkëmbur.

THIRRJA E PEJGAMBERËVE PËR TEVHID DHE LUFTA E TYRE PËR DINJITET

Në një hadith, Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

“Fjala më e rëndësishme që kam predikuar unë dhe pejgamberët para meje, ka qenë fjala: Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut.” (Muvatta, Kuran, 32)

Pejgamberët janë dërguar për udhëzimin e njerëzimit. Nga kjo pikëpamje, mesazhi i tyre është shumë i rëndësishëm për arritjen e lumturisë në këtë botë dhe botën tjetër. Më gjithë qëllimin kryesor të njëjtë, mësimet dhe mesazhet e pejgamberëve kanë pasur edhe dallime ndërmjet tyre në varësi të kohës dhe vendit. Predikimi i fjalës së shëhadetit ka qenë për të gjithë pejgamberët pa përjashtim. Pra, kauza kryesore dhe më e rëndësishme e pejgamberëve ka qenë njësimi i Allahut dhe skalitja e këtij parimi në zemrat e njerëzve për ta pasqyruar në jetën e tyre të përditshme.

Të gjithë pejgamberët kanë luftuar për lartësimin dhe respektimin e dinjitetit njerëzor, të bazuar në parimet e Tevhidit. Në këtë luftë ata gjetën përballë drejtuesit dhe parinë e shoqërisë, e shprehur ndryshe, gjetën përballë të ashtuquajturit intelektualë. Intelektualët hapën një front të gjerë dhe të ashpër kundër pejgamberëve dhe mesazhit të tyre. Për të penguar përhapjen e mesazhit, filluan një propagandë denigruese dhe shpifje. Kurse besimtarët që ndoqën pejgamberët i diskriminuan, torturuan dhe i bojkotuan duke ndërprerë lidhjet shoqërore, fisnore dhe ekonomike. Shkurtimisht, përdorën mënyrat më çnjerëzore për të larguar besimtarët nga Tevhidi. Të gjitha këto ishin veprime kundër dinjitetit njerëzor.

Pastrimin e Tevhidit nga idhujtaria, e cila ndot dhe cenon drejtpërdrejt dinjitetin njerëzor, pejgamberët e kanë filluar nga fjala “la ilahe il-la Allah”.

Të gjithë pejgamberët kanë luftuar për lartësimin e kësaj fjale. Sepse çdo çoroditje dhe shthurje që shfaqet në shoqëri është e lidhur në mënyrë direkte me Tevhidin. Në momentin që turbullohet pastërtia dhe kthjelltësia e Tevhidit, fillojnë të shfaqen shthurjet dhe shkeljet e dinjitetit njerëzor.

Fatkeqësisht, në ditët tona, ibadetit të pastër i është bashkëngjitur një formë idhujtarie.

Prandaj, pejgamberët e kanë filluar luftën për lartësimin e dinjitetit të njeriut duke vendosur përballë politeizmit Tevhidin dhe përballë ateizmit imanin.

Janë dy qëndrime të pejgamberëve në përpjekjen për lartësimin e Tevhidit dhe dinjitetit njerëzor, të cilat duhen zbatuar nga të gjithë myslimanët sot.

1. Mbrojta e besimtarëve

Asnjë pejgamber nuk i ka larguar besimtarët dhe dëbuar besimtarët për shkak të kërcënimeve të drejtuesve, përkundrazi i kanë mbështetur dhe mbrojtur ata. Fjala e Nuhut është dëshmi për këtë: **“Unë nuk mund t'i dëboj ata që besojnë... O populli im, kush do të më mbrojë nga Allahu, nëse unë i dëboj** (besimtarët)? **A nuk doni të merrni këshillë?... Nuk do t'u them atyre, të cilët sytë tuaj i nënçmojnë, se Allahu nuk do t'u japë kurrfarë të mire. Allahu e di më mirë se ç'ka në shpirtat e tyre. Atëherë, sigurisht që do të isha prej të padrejtëve.”** (Hud, 29-31)

Besimtari qoftë edhe i vetëm është një burim virtyti, mirësie dhe dinjiteti.

Sido që të jenë kushtet, myslimanët e kanë obligim madhor mbështetjen, ndihmën dhe daljen për zot të dinjitetit të besimtarit, moslejimin në asnjë mënyrë të përdhosjes së dinjitetit të besimtarit.

2. Përpjekja për të rritur dhe edukuar pasardhës besimtarë.

Një veçori tjetër e pejgamberëve ka qenë përgjegjësia dhe përpjekja e tyre për të rritur dhe edukuar pasardhës besimtarë. Lutja e Pejgamberit (a.s.): **“O Zot, unë nuk dëshiroj shkatërrimin e tyre, por të lutem Ty të nxjerrësh prej tyre pasardhës besimtarë.”** Për popullin e Taifit është shprehje e qartë e kujdesit të pejgamberëve për të edukuar pasardhës besimtarë.

Zgjerimi, përhapja e Islamit në një kohë të shkurtër në katër anët e botës dhe krijimi i një qytetërimi madhështor, erdhi si pasojë e brezave besimtarë të cilët morën në mbrojtje dhe nderuan dinjitetin njerëzor.

Prandaj, detyra kryesore e besimtarëve sot është rritja dhe edukimi i pasardhësve besimtarë, të cilët mund të marrin përsipër mbrojtjen dhe lartësimin e dinjitetit njerëzor.



Niveli I MORALIT është grada e BESIMIT

Dr. Adem Ergyl

Çdo besim dhe kulturë krijon moralin e vet. Kur natyrshmëria e pastër e njerëzve, e cila pëshpërit gjithnjë të njëjtat mirësi, ndeshet me disa vlera dhe koncepte që krijojnë shoqëria e prishur, me kalimin e kohës ndryshon dhe prishet. Si kapitalizmi ashtu edhe komunizmi me ateizmin kanë parimet e veta morale. Këto parime mund të jenë të mira sipas tyre, por ato nuk përputhen me moralin që dëshiron Allahu. Në këtë artikull do të flasim për marrëdhënien e ngushtë të moralit islam me besimin.

Në të vërtetë, të gjitha fetë e drejta e thërrasin njerëzimin për të dëgjuar zërin e natyrshmërisë dhe për të qenë në harmoni me të. Nga ky aspekt, detyra e përbashkët e të gjithë profetëve mund të arrijë meritën për t'u bërë një mëkëmbës (që do të zbatojë ligjet e Zotit) në tokë, nga aspekti i moralit. Është ndërtimi i botës intelektuale, i botës shpirtërore madje edhe sistemi i raporteve me të gjitha krijesat që ndërton në mënyrë të shëndetshme tullë-tullë në themelin e besimit ndaj Allahut. Pohimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s): "Unë jam dërguar

për të plotësuar moralin e mirë!" (Muvatta, Husnū'l-huluk - Morali i Bukur, 8) është shprehje pikërisht e këtij realiteti. Pra, themeli i moralit islam, është besimi në Zot.

Njeriu besimtar, siç organizon botëkuptimin e tij sipas këtij besimi, ashtu formon edhe ndjenjat dhe sjelljet e veta në kuadër të këtij parimi. Prandaj, çdo gjë që i përket atij ka lidhje me besimin. Kurani i Madhërishtëm e trajton këtë realitet në mënyrë shumë të qartë në

kuadër të ajeteve që trajtojnë besimin. Për shembull, ndërkohë që bujaria, falja, mëshira, drejtësia, ndershmëria, modestia dhe mirësi të tjera si këto u dhurohen personave që kanë përqaftuar besimin; jobesimtarëve dhe hipokritëve u atribuohen cilësi të këqija, si koprracia, padrejtësia, mendjemadhësia, gënjeshtria, frika, vrazhdësia dhe zemërligësia. Morali islam është si besimi që shfaqet në mendje, në zemër dhe në të gjitha fushat e jetës. Me fjalë të tjera, është si fara e besimit që është mbjellë në zemër, e cila ka tendencë të degëzohet dhe të japë fryte. Në të vërtetë,

*Treguesi i forcës
dhe i thellësisë së besimit
është niveli i moralit
të mirë që ka personi.
Besimi është një dritë
hyjnore, që realizon
transformimin dhe
zhvillimin e unit.*

fjala (*Kelime-i tevhid – Fjala e Dëshmisë*), që qartëson ralitetin e besimit në Kuranin e Madhërisëm është krahasuar me pemën:

“Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e krahason fjalën e mirë (kelime-i tevhid) me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj (pema) jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj (bën krahasime të tilla) njerëzve, që t’ua vënë veshin.” (Ibrahim, 24)

Edhe Profeti i Nderuar, (a.s), e shpreh kështu lidhjen e ngushtë midis moralit dhe besimit:

“Besimtari më i përkryer në aspektin e besimit është ai që është më i mirë në aspektin e moralit.” (Tirmidhi, Rada’ 11. Përveç kësaj, shik. Ebu Davud, Sunne, 15)

“Besimi ka shtatëdhjetë (ose gjashtëdhjetë) e disa (veçori) degë. Më e larta është të thuash: ‘Nuk ka zot tjetër përveç Allahut – La ilahe il’allah’; ndërsa më e ulëta është heqja e sendeve që pengojnë nga rruga. Modestia-turpi është një pjesë e besimit.” (Muslimi, Iman 58. Përveç kësaj, shik. Buhari, Iman 3; Ebu Davud, Sunnet 14) Sipas ndryshimeve në transmetime, këto degë janë ose shtatëdhjetë ose gjashtëdhjetë e disa degë. Ka libra të veçantë që i përmbledhin këto deri në 77 dhe japin njohuri të detajuara për secilën prej tyre. Një prej vepërave më të njohura rreth kësaj, është Shuabu'l-Iman i muhadtithit Bejhaki (v. 458/1066). Prej 77 veçorive (ose degëve) të cilat përmbledhen në librat tona si “degë të besimit” përfshijnë 30 tema që kanë lidhje me besimin, dhe 47 tema që kanë lidhje me adhurimet që bëhen me gjuhë dhe trup dhe përveç kësaj, që kanë të bëjnë me të drejtat (e përgjithshme) familjare dhe shoqërore.

Këto hadithe sherife, me një metodë mahnitëse, vënë në dukje domosdoshmërinë e reflektimit të besimit në moral. Për rrjedhim, mund të thuhet se treguesi i forcës dhe i thellësisë së besimit është niveli i moralit të mirë që ka personi. Besimi është një dritë hyjnore, që realizon transformimin dhe zhvillimin e unit. Kjo dritë, në fillim e shpëton zemrën nga mosbesimi dhe errësira e shirkut (*politeizmit*). E pajis atë me besim dhe ndjenja të varura tek Zoti dhe si përfundim, i ngjyros dhe i zburkon punët dhe sjelljet e tij me aktivitete që do të jetë i kënaqur Allahu. Kjo bojë, sipas shprehjes kuranore, është bojë e Allahut dhe nuk ka askush bojë më të mirë se boja e Allahut. (Shik. Suretu'l-Bekare, 138)

Një nga objektivat më të rëndësishme të Islamit, është eliminimi i injorancës. Ndërsa, si një koncept

kuranor, injoranca (*xhahilije*) është ashpërsi. I Dërguari i Allahut, (a.s), i tërheq vëmendjen një sahabi, i cili e lëndon shokun e vet, duke i thënë: “biri i gruas së zezë” për domosdoshmërinë e ndërtimit të mirësjelljes së besimit dhe të Islamit, duke thënë: “Domethënë, ti ke akoma injorancë...” Sepse Islami, përkrah objektivave të tjera, ka ardhur për të zëvendësuar mirësjelljen, virtytin, edukatën dhe në përgjithësi moralin e bukur në vend të ashpërsisë.

Nga ky aspekt, mund të thuhet se Islami ndërton një edukatë të re në çdo dispozitë të saj. Sepse Kurani dhe Suneti, fund e krye përbëhen nga edukata. Madje, një prej fryteve më të rëndësishme të adhurimeve tona është zbukurimi i moralit. Ndërkohë që namazi të mbron nga ndyrësit, zekati të shpëton prej sëmundjes së koprracisë dhe të shpie në virtytin e bujarisë.

Ndërsa haxhi, është pikërisht një praktikim i mirësjelljes dhe i modestisë. Ndërsa agjërimi, është shiringa e edukimit të gjuhës dhe e mëshirës. Ndërsa edukatorët dhe udhëzuesit, të cilët mund t’i quajmë edukuesit e personaliteteve të qytetërimit tonë, kanë bërë të qartë se qëllimi përfundimtar në edukimin mistik është “moralit edukues”, që është manifestuar në personalitetin e të Dërguarit të Allahut.

Ata kanë theksuar se nuk mund të përmendim asnjëfarë hierarkie shpirtërore, nëse nuk realizohet kjo gjendje që shpreh “të pajisesh me moralin e Allahut”. Nga sqarimet e Kuranit të Madhërisëm kuptojmë se moralit me të cilën kënaqet Allahu është moralit i Profetit tonë të nderuar, i cili është i Dashuri i Allahut.

Sepse deklarata për të: “... (Betohe) **se ti je me virtyte madhore.**” është bërë nga vetë Zoti ynë i Madhërisëm. (Kalem, 4)

Atëherë, njësimi është i qartë. Sipas kësaj, grada e besimit tonë është në proporcion me afrimitetin tonë ndaj të Dërguarit të Allahut, nga aspekti i moralit. Një afrimitet i tillë, mund të konsiderohet një shenjë e rëndësishme që tregon gradën tonë në xhenet.

Në të vërtetë, ai ka thënë kështu: “Personat që do të dua më shumë midis jush dhe do të jenë më afër meje në Ditën e Gjykimit, janë ata që gëzojnë moral të mirë...” (Tirmidhi, Birr 71)

Shkurtimisht, problemi i moralit është një problem besimi. Moralit i gjithësecilit është sipas nivelit të besimit. Ky pra, është treguesi i cilësisë së besimit.

Islami ndërton një edukatë të re në çdo dispozitë të saj. Sepse Kurani dhe Suneti, fund e krye përbëhen nga edukata. Madje, një prej fryteve më të rëndësishme të adhurimeve tona është zbukurimi i moralit. Ndërkohë që namazi të mbron nga ndyrësit, zekati të shpëton prej sëmundjes së koprracisë dhe të shpie në virtytin e bujarisë.



Pejgamberi dhe

DINJITETI NJERËZOR

Alli Riza Temel

Misioni më i rëndësishëm i Pejgamberit (a.s), ka qenë lartësimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor, sepse dinjiteti është ai që e bën njeriun njeri. Një njeri i privuar nga vlerat dhe dinjiteti, në thelb nuk është njeri.

Njeriu si përfaqësues i Allahut në tokë, ka kuptim dhe vlerë me virtytet dhe dinjitetin e tij. Është detyrë themelore e çdo njeriu të ruajë dhe të kultivojë virtytet. Njeriu e ka të nevojshme të njohë cilësitë dhe vlerat që e lartësojnë dhe sublimojnë atë. Mësuesit dhe zbatuesit më të mirë të këtyre vlerave kanë qenë pejgamberët. Ata janë model në çdo çështje për njerëzimin dhe njerëzit fitojnë dinjitet dhe vlera në raport me zbatimin e mësimave të tyre.

Nga faktorët kryesorë që e rrezikojnë dhe cenojnë dinjitetin e njeriut, janë politeizmi dhe idhujtaria. Sjellja më fisnike dhe dinjitoze në këtë botë është përpjekja për ta shpëtuar njeriun nga robërimi i krijesave dhe orientimi i tij drejt Allahut, krijesit të gjithësisë. Kurse robërimi ndaj krijesave të tjera është poshtërsi dhe çnderim i njeriut. Besimtari nuk i nënshtrohet askujt përveç Allahut. Kjo është liria e vërtetë. **“Janë dy njerëz: njëri ka shumë bashkë-**

pronarë që e kundërshtojnë njëri-tjetrin, ndërsa tjetri ka vetëm një pronar, të cilit i përkushtohet. A janë të njëjtë ata në krahasim?” (Zumer, 29)

Siç thotë Isai (a.s), një skllav nuk mund të ketë dy pronarë. Lufta për Tevhid është luftë për dinjitet. Dinjiteti i personave që nuk i nënshtrohen Allahut, është i destinuar të përdhohet dhe nëpërkëmbet.

Nënshtimi dhe përulja përballë çdo dëshire dhe fuqie shkakton humbje dhe prishje të personalitetit njerëzor. Personi që nuk i nënshtrohet Allahut, është si gjethja që e fluturon era sa andej-këndeje. Persona të tillë nuk kanë parime, ata jetojnë vetëm momentin, nuk kanë as rrugë as drejtim. Kurse besimtari ka një drejtim të caktuar dhe drejtimi themelor i besimtarit është fitimi i kënaqësisë së Allahut. Besimtari nuk ndryshon drejtim sipas interesave dhe dëshirave. Ai nuk e shet dhe nuk e bën veten objekt shitblerjeje. Ai i përdor mirësitë e Allahut në rrugën dhe çështjen islame. Besimi dhe mbështetja te Krijuesi i gjithësisë i jep atij forcë dhe fuqi të pashtershme. Kjo gjë e bën krenar atë përballë jobesimtarëve. Këta burra as nuk blihen, as nuk shiten. Pejgamberi (a.s), është përfaqësuesi më shembullor i dinjitetit dhe krenarisë së njeriut, të cilit kur i ofruan pasuri, pozitë dhe femra në këmbim të braktisjes së kauzës islame, i refuzoi duke thënë: “Edhe sikur të më vendosni diellin në krahun e djathtë dhe hënën në krahun e majtë, unë nuk heq dorë nga kjo çështje.”

Pejgamberi (a.s), ka respektuar maksimalisht dinjitetin njerëzor pa dallim gjinie, moshe dhe feje. Sepse Ai është pejgamber për gjithë njerëzimin. Nga respekti i madh për dinjitetin njerëzor, Pejgamberi (a.s), asnjëherë nuk korrigjonte personin direkt për gabimet që evidentonte, por veprimin në përgjithësi. Sepse e rëndësishme është të korrigjohet gabimi, pa ofenduar dhe cenuar sedrën e personit.

Hadithi i Pejgamberit (a.s): “Kush shikon një gabim dhe e mbulon atë, është sikur ka shpëtuar një vajzë, të cilën janë duke e varrosur për së gjalli.” (Ebu Davud, 4891), mjafton për të treguar rëndësinë e madhe që i jepte Pejgamberi dinjitetit të njeriut. Mbrojta e dinjitetit të njeriut është e barabartë me shpëtimin e jetës së tij, sepse jeta e vërtetë është

jeta me dinjitet.

Përqeshja, shpotia, ironia, përçmimi dhe përdorja e epiteteve fyese për të tjerët është e ndaluar rreptësisht në Islam. Mosrespektimi i dinjitetit të njeriut shkakton erozion të personalitetit të tij. Pejgamberi (a.s), këtë fakt e ka shprehur kështu: “Nëse vë në dukje gabimet e njerëzve, i shkatërron ata ose i sjell në prag shkatërrimi.” (Ebu Dabur, Adab, 37) Është prej moralit të Islamit të mos hetosh gabimet dhe mëkatet e njerëzve të tjerë. Besimtari përpiqet të rregullojë gabimin e tjetrit përmes këshillës së urtë. Besimtari shërben si pasqyrë për besimtarin. Një nga cilësitë e Allahut është edhe “ Mbulues i mëkateve”

Një nga detyrat kryesore të myslimanit është edhe ruajtja e nderit dhe krenarisë së besimtarit. Në lidhje me rëndësinë e kësaj, Pejgamberi (a.s), në një hadith është shprehur: “Kush nuk ndihmon besimtarin, të cilit po i cenohet nderi dhe dinjiteti edhe Allahu do ta lërë atë vetëm kur t’i kërkojë ndihmë, kurse kush ndihmon besimtarin të cilit po i cenohet nderi, Allahu do ta ndihmojë sa herë të ketë nevojë.” (Mexhmau’z-zevaid, 1/89)

Njeriu, së pari duhet të tregojë kujdes në respektimin e dinjitetit të vet. Pejgamberi (a.s), i ka këshilluar besimtarët të qëndrojnë larg ambienteve ku mund të bëhen objekt fyerjeje dhe dyshimesh. Pejgamberi (a.s), i ka kërkuar mbrojtje Allahut nga poshtërimi. Pejgamberi (a.s), i ka këshilluar besimtarët t’i kërkojnë mbrojtje Allahut nga varfëria, mjerimi, poshtërimi dhe padrejtësitë. Ai thotë: “Besimtarit nuk i ka hije të poshtërojë veten.” (Ibn Maxhe, 4016) Kurse në një hadith tjetër thotë: “Mos e poshtëroni veten.” Të pranishmit i thanë: “O i Dërguari i Allahut, si e poshtëron njeriu veten? Tha: “Nëse hesht kur duhet folur për hir të Allahut në Ditën e Gjykimit, Allahu do t’i thotë: ‘Çfarë të pengoi të flasësh kur duhej folur?’ ‘Më pengoi frika nga njerëzit.’ Allahu i thotë: ‘A nuk duhej të më kishe më shumë frikë Mua se ata?’” (Ibn Maxhe, 4008) Siç kuptohet edhe nga hadithi, një kusht tjetër për të jetuar me dinjitet është edhe përpjekja për të mbajtur në këmbë të vërtetën. Heshtja përballë padrejtësive dhe mosmbrojtja e së drejtës nuk i ka hije një njeriu me dinjitet. Lufta që realizo-

“Kush nuk ndihmon besimtarin, të cilit po i cenohet nderi dhe dinjiteti edhe Allahu do ta lërë atë vetëm kur t’i kërkojë ndihmë, kurse kush ndihmon besimtarin të cilit po i cenohet nderi, Allahu do ta ndihmojë sa herë të ketë nevojë.”

het për të mbrojtur nderin personal dhe nderin e të tjerëve, është një luftë e shenjtë. Ata që nuk marrin pjesë në këtë luftë, dalëngadalë humbasin ndjeshmërinë dhe vlerat pësojnë inflacion. Në këtë mënyrë, pandershmëria shndërrohet në karakter.

Muslimani nuk ia shtrin dorën askujt, sepse kjo bie ndesh me dinjitetin e tij. Këshillat e Pejgamberit (a.s), në lidhje me këtë janë të shumta. *“Është më mirë për ju të merrni një litar dhe të pritni dru (nga mali), t’i bartni ato me shpinën tuaj dhe t’i shitni, (si mjet për të fituar të ardhurat tuaja), sesa të lypni nga një person i cili mund t’ju japë ose mund t’ju refuzojë”.* (Buhari, 536) *“Mos kërkoni gjë prej njerëzve”* *“Kush lyp për të fituar para, ka fituar zjarr.”* (Rrijadus Salihin, 526-529)


Muslimani është plot krenari, fisnikëri dhe dinjitet. Kjo natyrë e tij është e dukshme në të gjitha sjelljet dhe veprimet e tij. ***“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: ‘Paqe qoftë!’*** (Furkan, 63)

Të parët tanë vazhdimisht kanë treguar respekt ndaj dinjitetit njerëzor. Në mënyrë që të varfrit të mos ndiheshin keq, e linin lëmoshën në të ashtuquajturit gurët e lëmoshës. Të parët tanë kanë treguar kujdes maksimal në ndihmën ndaj të varfërve, duke e realizuar pa u diktuar nga ata. E gjitha kjo bëhej për të ruajtur dinjitetin njerëzor. Shprehja: *“Kur jep dora e djathtë, të mos e shikojë dora e majtë”* i shërben pikërisht këtij qëllimi. Përndryshe, sadaka-

ja e bërë e humb vlerën. ***“O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato*** (atyre që ua keni dhënë) ***dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit.”*** (Bekare, 264)

Për ta përmbyllur me një ngjarje shumë të goditur në lidhje me respektimin e dinjitetit njerëzor. Një grua e moshuar vjen tek dijetari dhe asketi i famshëm Hatem Esami për një çështje. Gjatë paraqitjes së çështjes, pa dashje i shpëtojnë gazrat. Gruaja mezi po qëndronte në këmbë nga sikleti dhe turpi. Esami i tha gruas: *“Përsëriti me zë të lartë ato që the, sepse unë nuk dëgjova, jam i shurdhër.”* Në këtë mënyrë, grua u qetësua dhe u lehtësua nga turpi që e kishte kapluar. Duke u nisur nga kjo ngjarje, preferoi të përdorte si epitet emrin *esam*, i cili do të thotë i shurdhër. Njerëzit dhe mediat e ndryshme, të cilat nuk pushojnë së shpifuri për nderin dhe dinjitetin e njerëzve, duhet të marrin shembull nga kjo ngjarje dhe plot të tjera në historinë islame. Dinjiteti është e drejtë e çdo njeriu dhe respekti ndaj dinjitetit të njeriut është obligim për gjithësecilin.

“Është më mirë për ju të merrni një litar dhe të pritni dru (nga mali), t’i bartni ato me shpinën tuaj dhe t’i shitni, (si mjet për të fituar të ardhurat tuaja), sesa të lypni nga një person i cili mund t’ju japë ose mund t’ju refuzojë”.





Sadik Dana

O robër të Allahut, ruhuni nga kundërshtimi i Tij!

Aliu, (r.a), ka thënë:

Unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Përsëri, dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i Allahut.

Kini frikë nga kundërshtimi i Allahut. Shkaqet më të sigurta që e shpëtojnë robin janë: besimi, përpjekja në rrugë të Allahut, sinqeriteti, që është prezent në natyrshmërinë e njeriut, falja e namazit, që është shtylla e fesë, dhënia e zekatit, që është obligim nga Allahu, agjërimi i Ramazanit, që është mburojë nga dënimi i Allahut, kryerja e haxhit-pelegrinazhit, që të largon varfërinë dhe të bien gjynahet, vizita e të afërmeve, që të begaton pasurinë, të zgjat jetën dhe të bën të fitosh dashurinë e miqve, sadakaja-lëmosha që jepet fshehurazi, e cila të fshin gabimet dhe pengon zemërimin e Allahut; si dhe bamirësia, që parandalon vdekjen që shfaqet në një formë të mjerueshme dhe që të ruan nga frika.

Allahu përmendeni shpesh, sepse përmendja e Allahut është dhikri më i bukur. Kërkoni ato që u janë premtuar të devotshmëve, sepse premtimi i Allahut është premtimi më i drejtë. Shkoni drejt rrugës së Profetit tonë, sepse ajo është rruga më e vyer. Pasoni sunetet e tij! Sepse sunetet e tij janë rrugët më të nderuara. Mësoni librin e Allahut! Sepse libri i Allahut është fjala më e drejtë. Kuptojeni mirë fenë! Sepse ta kuptosh mirë fenë, ndriçon zemrat. Kërkoni shërim prej dritës së Allahut, sepse ajo është shërim për sëmundjet e zemrave. Lexojeni Kuranin duke respektuar rregullat e drejtshqiptimit (*texhvidit*)! Sepse lajmi më i mirë është atje. Kur të këndohet-recitohet Kuran, dëgjoni! Mos flisni! Shpresohet se Allahu do t'ju mëshirojë. Kur të gjeni rrugën e drejtë nëpërmjet Kuranit, qëndroni vazhdimisht në udhëzim me ato që keni mësuar. Dijetari që nuk punon me diturinë e vet, është si injoranti gjynahqar, që nuk e gjen dot rrugën e drejtë, për shkak të paditurisë.

Mos humbisni në vegime! Do të bini në dyshime. Mos bini në dyshime, se pastaj do të shkoni në mosbesim. Mos u shmangni tek lehtësia e punës! Se pastaj do të bini në shkujdesje. Mos u bëni të shkujdesur nga realiteti! Se më pas do të dilni të lënduar. Nëse do të veproni me kujdes e maturi, do të keni siguri në vetvete. Ata që janë më të

sinqertë ndaj vetes së tyre midis jush, janë ata që i binden më shumë Zotit të tyre. Ndërsa ata që e mashtrojnë më së shumti vetveten, janë ata që e kundërshtojnë më shumë Zotin e tyre.

Ata që i binden Allahut, janë të sigurt ndaj fatkeqësive dhe janë të qetë ndaj veprave të tyre. Ndërsa, ata që e kundërshtojnë Allahun, kanë frikë nga çdo gjë dhe pendohen nga ato që kanë vepruar. Kërkoni prej Allahut dituri dhe shëndet haptazi në çdo çështje. Duhet të zgjidhni qëndrueshmëri në besimin e vërtetë dhe në veprat tuaja, të cilat janë më të vyerat prej atyre që bartni në zemra.

Syfaqësia, në njëfarë mënyre, është ortakëri ndaj Allahut. Sinqeriteti është argument për pranimin e veprës dhe një domosdoshmëri e besimit. Vazhdimësia në tubimet argëtuese bën që të harrosh urdhrat e Kuranit. Atyre u vjen shejtani dhe ai e nxit njeriun për çdo lloj devijimi. Shoqërimi me gra e prish zemrën. Sytë tuaj mbrojnë nga shikimi i grave, të cilat janë kurthe të shejtanit! Qëndroni të palëkundur në fjalën që i keni dhënë Allahut. Sepse Allahu është me ata që e mbajnë fjalën e dhënë. Largohuni prej gënjeshtres, sepse besimi nuk qëndron bashkë me gënjeshtren. Drejtësia është shkak për shpëtim dhe lavdi.

Porositë lërin tek ata që keni besim. Vizitoni miqtë që ju kanë harruar. Vizitoni ata që janë zemëruar me ju, duke sakrifikuar ju. Qëndroni në fjalën që keni dhënë. Bëhuni të drejtë, kur të jeni në postin prej të cilit jepni vendime. Mos u mburrni me etërit tuaj. Mos i ngjisni njëri-tjetrit nofka. Mos u tallni me njëri-tjetrin! Mos urreni njëri-tjetrin! Ndihamoni të dobëtit, të shtypurit, të braktisurit, ata që janë në rrugë të Allahut, udhëtarët dhe skllëvërit! Kini dhembshuri për vejanët dhe jetimët! Përsëndeteni njëri-tjetrin me selam! Kthejeni selamin-përsëndetjen e dhënë me të njëjtën mënyrë ose më bukur. Allahu i Lartësuar thotë:

"Ndihamojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat! Dhe mos ndihmoni njëri-tjetrin në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse dënimi i Tij është i ashpër." (Maide,2)

Përse është i rëndësishëm Suneti i Resulullahut?

(sal-lallahu alejhi ve sel-lem)

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare ose sunetin), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.” (Al-i Imran, 164)

“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja (udhëheqësve). Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.” (Nisa, 59)

“(O njerëz!) Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëri-tjetrit; Allahu, me siguri, i di ata që shkëputen prej jush tinëzisht. Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e Tij, që të mos i prekë ndonjë sprovë ose të mos i godasë ndonjë dënim i dhembshëm.” (Nur, 63)

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë; e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër.” (Hashër, 7)

Fjala sunet në aspektin leksikor vjen në kuptimin e “rrugës që ndiqet dhe është bërë zakon, e mirë apo e keqe qoftë ajo.” (Metoda e të kuptuarit të Sunetit, Jusuf Karadavi, përkthyes në Turqisht: Bunjamin Erul, Stamboll, 2009. f. 23. Përveç kësaj, për njohuri më të

detajuar rreth kuptimit terminologjik të sunetit, mund të shikohet në vazhdim në faqet 23-38 në të njëjtën vepër, përveç kësaj, mund të shikohen artikujt “Sunnet” dhe “Hadith”, DIA, dhe Metodologjia e Hadithit, Ismail Lutfi Çakan)

Duke pasur parasysh këtë kuptim të fjalëve, stili i jetës është ajo që njeriu e ndjek “sunet”. Ky hadith i të Dërguarit të Allahu (a.s), na tregon mënyrën për ta kuptuar më mirë këtë kuptim që qartëson fjala “Sunet”: “Kush hap një rrugë të mirë (sunneten haseneten) në Islam, ka shpërblimin e tij dhe të pasuesve, pa ju pakësuar atyre asgjë. Dhe kush hap një rrugë të keqe (sunneten sejjieten) ka gjynahun e tij dhe të atyre që e ndjekin atë, pa ju pakësuar atyre asgjë.” (Tirmidhi, IIm-Dija 16, Ebu Davud, Sunne 5. Përveç kësaj, kjo është një prej dyzet haditheve të zgjedhura nga Imam Nebevi. (Metodë e të uptuarit të Sunetit, f. 23, Fusnotë 3)

Përsëri, fjala sunet në Kuran, do të thotë: “Ligjet dhe rregullat e pandryshueshme që ka vendosur Allahu i Lartësuar.” (Për shembujt në Kuran shiko: Al-i Imran, 3/137, Fatir, 35/43, Ahzab, 33/38, Ahzab, 33/62)

Ky sunet, kuptimi leksikor i të cilit u cek më sipër, përbën një stil jete, qoftë ajo e mirë apo e keqe, qoftë e vërtetë apo e gabuar. Dhe këtë mënyrë jete e formojnë elementet: besimi dhe aprovimet e personit, zakonet dhe traditat e shoqërisë etj. Në fakt, këtu ekziston një pyetje që përbën kriterin kryesor të problemit:

"Atëherë, çfarë është ai "sunet" që ndjekim ose me një shprehje më të qartë "Stil i të jetuarit?" Apo, "Si duhet të jetë suneti ynë?"

Këto pyetje, në të vërtetë janë pyetjet themelore, që sot përbëjnë gjendjen aktuale të njeriut modern. Njerëzimi kërkon një zgjidhje të problemeve individuale dhe shoqësore që përjeton dhe rreth recetës së kësaj zgjidhjeje ai ka rënë në një tollovi marramendthi. Sepse filozofitë, ideologjitë dhe në kuptimin më të gjerë sistemet e mendimit njerëzor që burojnë nga njeriu, tashmë kanë ngritur flamurin e falimentimit dhe njeriu ka filluar të anojë në disa koncepte që shprehen me emërtimet e sotme, si: parapsikologji, metafizikë etj. dhe në përgjithësi ka gjetur përdorim të gjerë në Lindjen e Largët dhe në Indi.

Atëherë, cili është shërimi? Cila është receta e shpëtimtimit të botës dhe ahiretit? Natyrisht që receta është tek realiteti për të cilin na ka bërë të ditur Krijuesi i Lartësuar, i cili krijoi gjithësinë bashkë me këtë dynja. Prandaj, në në ajetin 2 të sures së begatë el-Mulk thuhet kështu: **"A nuk e di (Allahun e Lartësuar) që krijoi (gjithë krijesat)? (Natyrisht që i di) Ai njuh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëformuar."** Domethënë, nën dritën e Kuranit të Madhërishtëm dhe edukimit dhe mbikëqyrjes së saj, për 23 vjet u qëndis bashkë me jetën dhe sa herë që të vazhdojë "Sunnetit Nebevi" do të shprehet "usve-i hasene = shembulli më i mirë".

"Suneti", kuptimi leksikor i të cilit është dhënë më sipër, sipas terminologjisë së dijetarëve islamë do të thotë: "Metoda profetike që ka sjellë Profeti (a.s), si teori dhe praktikë në kuptimin e fesë së Allahut dhe në kryerjen e të gjitha punëve në jetën e tij." (Metodologji e të kuptuarit të Sunetit, f. 24)

Po të studiojmë në përgjithësi sunetin e Profetit (a.s), do të vëmë re se paraqiten disa funksione si: Tezkijepastrim (pastrimi i as'habëve dhe në përgjithësi i njerëzve nga çdo e keqe), Irshad-udhëzim (udhëheqja për t'u treguar njerëzve rrugën e hairit (të mirësisë) dhe të udhëzimit), Terbije-edukim (edukimi i gjithë njerëzisë, duke filluar nga as'habët dhe personalitetet e larta prej tyre, për të arritur përsosurinë në rrugën e udhëzimit), Ta'lim-mësim (mësimi i as'habëve për të vërtetat dhe urtësitë kuranore në aspektin e mendimit dhe të zbatimit) etj. Pra, këto cilësi të lartpërmendura përbëjnë rrugën dhe metodologjinë e Profetit tonë (a.s). Sepse ai (a.s), u urdhërua në Kuran: **"Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur..."** (Nahl, 125) Nëse do t'i shprehim shkurtimisht të gjitha këto që përmendëm, rruga dhe metodologjia e Sunetit të Profetit (a.s), është "të kuptuarit e fesë, zbatimi dhe thirrja në të". Të gjitha këto bashkë, kanë gjetur kuptim në jetën sublime të Profetit tonë (a.s) dhe për shkak të këtyre çështjeve madhështore, ai është ofruar për njerëzit në

Kuran si **"shembulli i mrekullueshëm"**. (Ahzab, 21)

Kurani i Madhërueshëm përsëri na bën të ditur se suneti është dimension i dytë i shpalljes. Sepse në ajetet 3 dhe 4 të Suretut'n-Nexhm thuhet kështu: **"Ai (Profeti) nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që vjen tek ai."** Pothuajse është shumë kuptimplotë edhe ky hadith-i sherif rreth shprehjes së kësaj çështjeje. Abdullah b. Amr b. As (r.a), shkruante çdo gjë që dëgjonte nga Profeti (a.s). Kurejshët e ndaluan këtë, duke i thënë: "Ti shkruan çdo gjë që dëgjon prej tij, ndërkohë që Resulullahu është një njeri që flet në rastet kur është i zemëruar dhe i gëzuar, apo jo?" Pas kësaj, Abdullahu hoqi dorë nga shkrimi dhe e pyet Profetin e Nderuar (a.s), për gjendjen. Ai (a.s), tha kështu, duke bërë me shenjë tek goja: **"Shkruaj! Beto hem për (Allahun) Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, prej këtej nuk del asgjë tjetër, përveç të vërtetës."** (Musned, II, 162, Ebu Davud, Ilm-Dija, 3) Pra, sipas asaj që kuptohet edhe nga këta shembuj, hadithet janë shprehur mjaft bukur nga dijetarët si vahji-gajri metluvv (shpallje e pashkruar).

As'habët, që ishin në dijeni të këtij burimi të lartësuar, janë munduar të tregojnë të gjitha përpjekjet në çështjen e bindjes së plotë për të dhe kanë sakrifikuar shumë në këtë rrugë për të qenë një popull besnik ndaj tij (a.s). As'habët, që janë përgatitur nën edukimin e Profetit (a.s), kanë shpëtuar nga vorbulla e injorancës, brenda së cilës ndodheshin. Prej tyre doli në pah një shoqëri që zotëronte një kapacitet për të formuar Qytetërimin Islam, i cili përhapi anekënd botës të vërtetën dhe drejtësinë; dhe përveç kësaj, përparoi në çdo fushë të jetës. Ky transformim, që i mahnit ata të cilët janë të angazhuar deri më sot për të bërë hulumtime në fushën e sociologjisë, nuk ka mundur të kuptohet nga mendjet e ndërtuara nga vahji-revelata.

Nëse do të bëjmë një pyetje: "Si përfundim, ku po shkon njerëzimi?", me siguri shumica prej nesh nuk mund t'i japë përgjigje pozitive. Jeta kalon dhe me përparimin e njerëzimit në fushën e teknologjisë, problemet individuale dhe shoqërore sa vijnë e rriten. Njeriu sa vjen e largohet nga vlerat morale. Sa vjen e nderi dhe ndërgjegjja njerëzore humbet. Ndërkohë që vdekja, e cila është kiameti ynë i vogël afrohet çdo ditë nga pak, llogaria e jetës sonë fiton një rëndësi në çdo moment që kalon. Atëherë, duhet të jemi të vetëdijshëm se si dhe në ç'mënyrë duhet ta kalojmë jetën dhe me këtë ndërgjegje duhet ta vazhdojmë jetën tonë.

Mos na ndaftë Allahu nga Suneti i Resulullahut (a.s). Amin!



Xhafer Durmush



Emri i Tij

DUHET TË PËRMENDET ME RESPEKT

Në Kuranin e Madhërishëm ka shumë ajete që njoftojnë për vlerat e Profetit tonë të Nderuar. Allahu i Lartësuar e përçon këtë, duke thënë: **“... se, me të vërtetë, ti je me virtyte madhore.”** (Kalem, 4) Shembulli i përgjeshëm kumtohet me fjalën: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe tek Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”** (Ahzab, 21) Dhe thotë: **“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni me një “selam” të vërtetë!”** (Ahzab, 56)

Këtu dëshirojmë të mendojmë rreth domethënies së një prej ajeteve që parashetrohen për të kuptuar pozitën e nderuar të Profetit tonë tek Allahu. Urdhërohet kështu: **“O besimtarë! Mos thoni: ‘Rá’íná (në hebraishten-arabe të shekullit të shtatë ishte sharje me kuptimin “O i keqi ynë!”), por thoni: ‘Undhurná! – ‘Na shiko!’ dhe dëgjoni! Për mohuesit ka dënim pikëllues. Ata që mohojnë, si ithtarët e Librit, ashtu edhe paganët, nuk dëshirojnë që t’ju zbresë ndonjë e mirë nga Zoti juaj. Por Allahu ia dhuron mëshirën e Vet kujt të dojë. Allahu zotëron mirësi të madhe.”** (Bekare, 104-105)

Sipas përcaktimeve në komentim, kuptimi i ajetit të madhërishëm është: O myslimanë, të cilët miratojnë shpalljen e Muhamedit! Kur ta thërrisni “Profetin Madhështor”, mos i thoni “Raina”. Mos e thërrisni Profetin Famëmadh, duke thënë: “Si urdhëron tek ne!” Thoni: “Undhurna!” Thirreni me fjalët: “Na shiko, kujdesuni për ne!” Dhe dëgjoni fjalët e Profetit Famëmadh me fjalë të respektueshme. Dëgjoni ato për t’i kuptuar mirë.

Sipas shpjegimeve të disa komentuesve, fjalën *raina*, që përmendet në ajetin e madhërishëm, e kanë përdorur kryesisht ensarët gjatë bisedave të përditshme. Por, për shkak se e kanë përngjasuar thirrjen ndaj Profetit, (a.s), në fjalimet e pasjellshme, u bë e ndaluar ta përmendin përsëri këtë fjalë. Sepse kuptimi i *raina* është “na shiko që edhe ne të të shikojmë ty.” Edhe pse i Dërguari i Allahut nuk i shikon ata, detyra e tyre është që ata ta shikojnë atë.

Sepse për jobesimtarët që nuk e respektojnë atë, që nuk e miratojnë shpalljen e tij, që bëjnë vërejtje në sjelljet kundrejt tij dhe e mohojnë atë, ka një ndëshkim shumë të hidhur dhe të ashpër. Për shkak të sjelljeve të tyre kaq të këqija, pa dyshim që do të ndëshkohen me një dënim shumë të tmerrshëm. (Përkthimi dhe Komentimi në Turqisht i Kuran-i Kerimit, Omer Nasuhi Bilmen, Shtëpia Botuese Bilmen, Stamboll. 1992. vol. 1, f. 101)

Sipas transmetimeve, shkak i zbritjes së ajetit madhështor është si vijon: Disa prej myslimanëve shkonin shpesh tek shtëpia e Profetit dhe kur ai i urdhëronte për diçka, ata thoshin: “O i Dërguari i Allahut! Si urdhëron, të dëgjojmë!” Me këtë, ata donin të thoshin: “Shiko gjendjen tonë, që ne ta kuptojmë më mirë fjalën tënde të bekuar, ndërsa kur nuk e kuptojmë dot fjalën tënde, na jep kurajë dhe prit!”, duke pasur një përpjekje të pareshtur për një qëllim shumë të mirë.

Megjithatë, çifutët, të cilët komunikuan me të Dërguarin e Allahut, (a.s), me mënyra të ndryshme, me shprehjen *raina* kishin për qëllim një domethënie tjetër

dhe donin të thoshin me këtë: *"Ti je çobani ynë."* Dhe kur vinin te shtëpia e të Dërguarit të Allahut, bashkëbisedonin në këtë mënyrë me Profetin tonë, me qëllim që ta fyenin e të mos e respektonin. Prandaj, pas kësaj zbriti ajeti madhështor që u paraqit më sipër dhe myslimanët u mësuan se si duhet të bashkëbisedonin me Profetin dhe që paralajmëron se çfarë fjalësh duhet të përdorëshin kur ta thërrisnin atë.

Is'hak ibn Ibrahim et-Tyxhibi ka thënë: "Si duhej ta respektoje Profetin tonë të Nderuar, kur ai ishte gjallë; në të njëjtën mënyrë duhet të respektohet edhe pas vdekjes dhe duhet të lartësohet emri i tij dhe të nderohet. Si duhet të respektohet kur përmendet emri apo përmenden hadithi dhe suneti i tij, ashtu duhet të respektohet edhe kur përmendet nga dikush emri dhe stili i jetës së tij dhe kur përmendet nga rrethi i tij i ngushtë."

Besimtari, kur përmendet emri i Profetit tonë të Nderuar, duhet të sillet me modesti, bindje dhe respekt. Si do të duhej të sillej, nëse do të ishte Profeti i Nderuar

pranë tij, ashtu duhet të përpiqet të sillet edhe tani ndaj tij. Një sjellje e tillë është detyrë për çdo besimtar. Gjithashtu, as'hab-i kiram (*shokët e tij të nderuar*), sa herë që përmendej emri i tij, ndjenin një përlulje të thellë, u rrëqethej trupi dhe derdhnin lotë. Dijetarët tanë të mëdhenj dhe tabiinët e nderuar vepronin në këtë mënyrë. (*Komentimi i Shifa-i Sherif, Prof. M. Jashar Kandemir, Shtëpia botuese Tahlil, Stamboll, 2011, vëll. II, f. 362-264*)

Në Kuranin e Madhërishtëm, siç bëhet e ditur se si duhet qëndruar para të Dërguarit të Allahut (*a.s.*), si duhet të flitet me të dhe si duhet t'i përmendet emri; ashtu bëhet e ditur edhe se si duhet ta thërrasim atë. Profeti i nderuar (*a.s.*), na mëson në hadithet sherife se si duhet të sjellim salavat për të.

Për fat të keq, në çdo periudhë ka pasur prej atyre që kanë guxuar ta përmendin emrin e tij me mosrespektim. Atëherë, detyra jonë është t'ia deklarojmë njerëzimit domosdoshmërinë e përmendjes me respekt të të gjithë profetëve me në krye Profetin tonë (*a.s.*), dhe këtë e kemi obligim ta bëjmë në formën më të mundshme.

Lexo Mendo

MIRËSJELLJA E ETËRVE TANË

Këtu dëshirojmë të paraqesim dy shembuj, që kanë lidhje me respektin dhe mirësjelljen që tregohet ndaj të Dërguarit të Allahut, (*a.s.*). E para nga këto: Është një bisedë që u zhvillua midis Kalifit Mansur bin Xh'afër dhe Imam Malikut (*Shik. Malik ibn Enes*) në Xhaminë e Profetit. Imam Maliku tha:

"O udhëheqësi i besimtarëve! Mos fol me zë të lartë në këtë xhami! Sepse për të Dërguarin e Allahut, (*a.s.*), është thënë: **"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos humbasin veprat tuaja dhe ju nuk do të keni fare dijeni për këtë."** (*Huxhurat*, 2) dhe ai që e respekton këtë edukatë është lavdëruar me fjalët e Allahut të Gjithëpushtetshëm: **"Me të vërtetë, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit e sinqertë, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh."** (*Huxhurat*, 3)

Ndërsa disa të tjerë janë kritikuar me fja-

lët: **"Në të vërtetë, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica nuk marrin vesh (janë të trashë)."** (*Huxhurat*, 4) Imam Maliku e lidhi fjalën e tij si vijon: "Siç tregohet respekt në jetën e të Dërguarit të Nderuar, ashtu duhet treguar respekt edhe pas vdekjes së tij."

Së dyti: I Dërguari i Allahut, (*a.s.*), kaloi pranë një xhemati që po bënte konkurs për të mësuar shigjetën. Atyre u tha: "Hidheni bijtë e Eslemit! Edhe babai juaj ishte shigjetar. Edhe unë jam me Mihxhen Ibn-i Edra' dhe shokët e tij."

Kur tha kështu i Dërguari ynë i Nderuar, (*a.s.*), pala kundërshtarë tërhoqi duart dhe pyetjes së të Dërguarit të Allahut, (*a.s.*): "Përse nuk hidhni?" iu përgjigjën me fjalët: "Si mund të hedhim ne, ndërkohë që ti je bashkë me ta?" Pas kësaj, i Dërguari i Nderuar tha: "Ejani, hidhni! Unë jam me të gjithë ju." (*Buhari, Xhihad*, 78)

Gjurma e mirësjelljes duhet të vijojë në vazhden e shembujve kulmorë.





Nuredin Jëldëz

Si ishin ATO DITË...

*Sa të bekuara ishin gjurmët e tyre,
e begatë ishte puna e tyre dhe si ishin ditët e tyre, me të vërtetë!
Kjo është e drejtë. Ndërsa e padrejtë është të mbetemi në ditët e tyre
dhe të mos arrijmë t'i jetojmë ditët tona si në ditët e tyre.*

Duke parë ditët kur Allahu mbyti në ujë ata që e kundërshtuan dhe kur i shpëtoi besimtarët në anijen e Nuhut, (a.s), mund të themi: "Si ishin ato ditë!" Një triumf i fituar në emër të besimit ose shpëtimi i Allahut për besimtarët, me siguri është burim lumturie edhe pas mijëra vitesh. Ata që besuan asokohe dhe ata që besojnë edhe sot në këto ditë, ngaqë ndajnë së bashku besim të njëjtë, është e pamundur të mos e konsiderojnë atë ditë si burim lumturie!

Kur po mbytej Faraoni, një prej zullumqarëve të rrallë që e vendosi veten e tij në vend të Hyjnisë, fitoi besimi; ndërsa mosbesimi dhe revoltimi humbën. Ata që besuan prej njerëzve, e bënë detin rrugë, jobesimtarët u fundosën në fund të detit. Kjo do të kujtohet si një ditë gëzimi dhe fitoreje, pa dyshim. Me të vërtetë, "çfarë dite ishte ajo ditë!"

Gjithashtu, sa e madhe ishte ajo ditë, kur muslimanët korrën fitore në ditën e Bedrit, kur u përballën me armiqtë, të cilët ishin banorët e një qyteti nga ku u detyruan të emigronin. Pjesëmarrja e engjëjve në radhë për të mbështetur besimtarët, ishte pothuajse si bashkimi i qiejve me tokën. Mposhtja e atyre që i detyruan të emigronin, atë ditë për besimtarët ishte një triumf madhështor; për gjithë besimtarët nga sot deri në Kiamet, po të shikojmë Bedrin pas disa shekujsh më vonë, është e pamundur të mos thuash për atë ditë: "Çfarë ditësh të jashtëzakonshme ishin!"

I Dërguari i Allahut, (a.s), i cili dha shenjë për çlirimin e Kostandinopojës, Sulltan Mehmeti, i cili pas shekujsh e shndërroi këtë shenjë në një objektiv dhe e realizoi këtë çlirim të madh, korri një sukses që nuk do të harrohet kurrë ndër shekuj. Me çlirimin u gëzua vetë dhe bëri edhe të tjerët të gëzoheshin. E solli në realitet atë që pritej prej shekujsh. Atë ditë mosbesimi u mposht edhe një herë. Besimi u lartësua edhe një herë. Sulltan Mehmeti bëri të gëzueshëm engjëjt në qiej, besimtarët në tokë dhe Profetin, (a.s), në varrin e nderuar. Pa dyshim që kjo ishte një situatë e gëzueshme. Çfarë dite ishte ajo ditë e çlirimit, që si tani edhe atëherë na gëzoi dhe do të vazhdojë bëjë të tillë?

Ndërsa Ebu Hanife dhe nxënësit e tij, kanë bërë vepra që sa herë të përmenden, do të kujtohen me

respekt. Sa të bukura ishin ato ditë kur ata merrnin dije?.. Sa të begata ishin fjalët që derdheshin nga gojët e tyre dhe boja që rridhte nga duart e tyre! Ata lanë gjurmë të pashlyeshme, saqë do t'i mjaftonin çdo besimi për t'u krenuar dhe ashtu plot fisnikëri ikën... Sa të mrekullueshme ishin ditët kur kanë jetuar ata, sa gjurmë të mëdha kanë lënë!

A mund të harrohet Umer bin Abdulaziz, i cili me asketizmin e tij pothuajse nisi dhe mbylli një epokë. Edhe ajo, çfarë dite e veçantë ishte, në të vërtetë. Ai jetoi në mesin e njerëzve si një personalitet dhe jeta e tij u bë burim jete edhe për të tjerët. Emri i tij u shkrua si i një njeriu që do të lavdërohet përherë. Ai kishte një identitet që çdo besimtar do ta përvetësonte, duke thënë: "Ai është i imi!" ishte i mrekullueshëm dhe bëri punë të mrekullueshme. Bëri lutje dhe lutje pafund mori.

Ndërsa besimtarët, që mundën të qëndronin të paepur në kohën e stuhisë si Fudajli, Basriu, Abdulkadir Xhejlani, në sa ditë të mira kanë jetuar, kanë jetuar si besimtarët më të mirë dhe kanë ikur si të tillë. Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithëve. Fituan vetë dhe neve na lanë një trashëgimi të lavdërueshme.

Sa të bekuara ishin gjurmët e tyre, e begatë ishte puna e tyre, me të vërtetë! Kjo është e drejtë. E padrejtë do të ishte të mbeteshim sipërfaqësisht në gjurmët e tyre dhe të mos arrinim t'i jetonim dot ato. Anija e Nuhut, (a.s), është e domosdoshme edhe sot. Edhe sot mund të vijë një katastrofë, që do t'i ngjante stuhisë së asaj kohe. Revolta është po ajo, ndoshta është bërë më e madhe.

Nëse Musai, (a.s), e mbyti faraonin dhe shkoi, bota sot është përsëri plot me faraonë. Nëse ai e shpalli hyjninë e vet, sot i njëjti pretendim është shtuar, aq sa nuk mund të njehsohet. Tashmë është koha kur njerëzit duhet të ecin nëpër det. Ndërkohë që brezat e sotëm thonë: "Si ishin ato ditë!", sot duhet t'i përmendin ata që e bëjnë rrugëtimin e tyre nëpër dete.

Duhet të bëjmë vepra që do të mbeten trashëgimi, në vend që t'i konsumojmë trashëgimitë. Nuk është koha e lavdërimit, por është koha për të bërë punë të lavdërueshme.

FUQIA E LUTJES



Prof. dr. Sulejman Derin

Për realizimin e objektivave, padyshim që është shumë e rëndësishme të kapesht fort tek shkaqet e saj. Megjithatë, Zoti ynë, që ka fuqi absolute për çdo gjë, i ka dhënë lutjes fuqi të pashembullt. Nuk ka asnjë çështje tjetër që do ta shpjerë njeriun në sukses, sesa orientimi i robit drejt Zotit të vet me zemër të pastër, duke perceptuar paaftësinë e tij. Madje, ajo mund t'i tejkalojë arsyet e lutjeve të tilla dhe mund t'i bëjë ato të paefektshëm. Për këtë arsye, Imam Rabbani në një letër që shkroi për sulltanin e asaj kohe, shpjegon se çdo lloj fitore materiale dhe shpirtërore është për shkak të begatisë së lutjes. Imami e shpreh kështu çështjen, si më poshtë vijon:

Çdo njeri është krijuar për të kryer një punë dhe njeriu është i suksesshëm vetëm në atë punë që i përshtatet natyrshmërisë së tij. Sepse, nuk është e mundur që Allahu i Lartësuar të bëjë një gjë më kot. Detyra që bie mbi luftëtarët, është fortifikimi i parimeve që siguron jetësimin e fesë me autoritet dhe që mbajnë në këmbë shtetin. Kjo punë sublime, në të njëjtën kohë varet edhe nga moria e dua

bërësve që përbëhet nga të dobëtit që janë fatkeqë dhe të urtët. Sepse çlirimi dhe triumfi janë dy pjesë. E para është pjesë e varur nga shkaqet, që është forma e çlirimit dhe e triumfit që ka lidhje me ushtrinë luftëtare. Ndërsa e dyta është realiteti i çlirimit dhe i triumfit, që cilat vijnë nga Allahu i Lartësuar, i cili i ka krijuar shkaqet. Në të vërtetë, ajeti i Allahut të Plotfuqishëm: "Triumfi, është vetëm tek Allahu, i cili ka fuqi dhe urtësi absolute.", tregon për këtë kuptim, i cili është i lidhur me ushtrinë e lutjes.

Ushtria e lutjes e lartëson ushtrinë luftëtare (tek Allahu i Lartësuar) nga shkak i vërtetë tek shkaktari. (Vol. III., Letra 47)

Sipas imamit, shkak se përse ushtari i ushtrisë së lutjes qëndron në krye të ushtrisë, është të zhvishesh nga shkaqet dhe të kapesht tek poseduesit e tyre. Për këtë arsye, gjatë gjithë historisë së Islamit, i kushtohet rëndësi marrjes së lutjeve nga të urtët, të braktisurit dhe të varfërit para se udhëheqësit dhe sulltanët të dilnin në xihad. Në këtë kontekst, është interesant dialogu që u zhvillua midis një komandanti dhe **Nureddin**

*Profeti (a.s) me gjithë ekzistencën e ushtrisë dhe fuqisë së madhe të luftëtarëve, kërkonte çlirim për hatër të fukarenjve muhaxhirë.
U formua ushtria e lutjeve, megjithëse fukarenjtë ishin shtresa më e nënçmuar dhe e braktisur.*

Zengi-ut, muxhahidit të famshëm që e harxhoi gjithë jetën e vet për të shpëtuar Jeruzalemin nga kryqtarët: Një burrë ankohej për pamjaftueshmërinë e buxhetit për luftë i thotë **Nureddin Zengi**-ut, "Ke rroga dhe lëmosha që ua jep fakihëve, të varfërve, mistikëve, lexuesve të Kur'anit dhe disa personave të tjerë në shtetin tënd. Në këto ditë të vështira mos ua jep atyre këtë para, por do të ishte më mirë sikur t'i harxhoje për ushtrinë." Nureddini u zemërua nga këto fjalë dhe i kthen këtë përgjigje: "Unë besoj se triumfi që do të përfitoj më vjen vetëm nëpërmjet atyre (dijetarëve, mistikëve dhe të varfërve). T'ua pres rrogat njerëzve që luftojnë për mua me shigjetat (lutjet) e tyre që nuk devijojnë aspak, ndërkohë që unë fle në krevatin tim, e si mund t'ua jap burrave që luftojnë vetëm kur më shikojnë mua, dhe shigjetat e tyre që hedhin, ndonjëherë e kapin shënjestrën e ndonjëherë dështojnë?" (Ibn el- Esir, Historia Islame, vol. X , faqe 241 - 242)

Allahu i Lartësuar i ka dhënë një fuqi të atillë lutjes, saqë një lutje e pranuar ka mundësi ta kthejë madje edhe ekzekutimin e caktimit. Sepse njeriu hyn menjëherë në raport të drejtpërdrejtë me poseduesin e caktimit (kaderit) dhe kadasë.

Imam Rabbani thotë kështu rreth kësaj çështjeje:

Për më tepër, lutja mund ta kthejë mbrapsht ekzekutimin e caktimit. Në të vërtetë, Profeti i nderuar ka thënë: "Nuk e kthen kadanë (ekzekutimin e caktimit) mbrapsht asgjë tjetër përveç lutjes." (Tirmidhi) Nuk ka fuqi në shpatë dhe në luftë që ta kthejë mbrapsht kadanë. Për rrjedhim, megjithëse ndodhin dobësime dhe thyerje, ushtria e duasë është më e fortë sesa ushtria luftëtare. Përveç kësaj, ushtria e lutjes është shpirti i ushtrisë luftëtare... Ushtria luftëtare konsiderohet sikur të jetë trupi i saj. Atëherë, pas ushtrisë luftëtare është e domosdoshme të jetë edhe ushtria e lutjes. Sepse, një trup pa shpirt nuk është kompetent të arrijë konfirmimin hyjnor dhe triumfin.

Imami, në këtë çështje tregon si argument kërkesën e ndihmës së Profetit tonë nga Allahu me fuka-

renjtë e muhaxhirëve-emigruesve, kur ai po dilte në betejë: *Thanë se: Prandaj, Profeti (a.s) me gjithë ekzistencën e ushtrisë dhe fuqisë së madhe të luftëtarëve, kërkonte çlirim për hatër të fukarenjve muhaxhirë. U formua ushtria e lutjeve, megjithëse fukarenjtë ishin shtresa më e nënçmuar dhe e braktisur. Në fakt, thonë se: "Varfëria është turpëruese edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër." Përveç këtyre situatave të vështira, edhe në disa situata të tjera ndjehet nevoja për ta dhe ata arrijnë një status të nderuar... Në këto situata që ndjehet nevoja për ta, si lufta me armiqtë, ata i lënë mbrapa të tjerët në aspektin e rëndësisë.*

Në të njëjtën mënyrë, sipas imamit shtresa tjetër të cilit i pranohet lutja, janë dijetarët që punojnë me diturinë e tyre. Boja e tyre është më e vlefshme sesa boja e dëshmorëve:

Profeti (a.s) ka thënë: *"Ditën e Gjykimit, boja e dijetarëve do të peshohet me gjakun e dëshmorëve, boja e dijetarit do të peshohet më rëndë." Subhanallah! Ajo bojë (substancë) dhe përçmim i lartësoi ata dhe i bëri krenarë. I shpuri ata në maja, duke u kacavjerrë nga skajet e veshjeve të tyre.*

Edhe imami, me këtë atribut, nuk mbetet mbrapa nga lutja që bën për udhëheqësit e kohës dhe thotë kështu: *"Këta të varfër, megjithëse nuk e meritojnë të konsiderohen prej ushtarëve të lutjes, vetëm për shkak të emrit të tyre të varfër dhe të mundësisë së pranimit të lutjeve të tyre, nuk hezitojnë të luten për shtetin e tyre madhështor...Pra, gjuha e tyre është gjithmonë e lagur për shkak të lutjes me mundësi e me gjuhë dhe të leximit të Fatihasë."*

Për këtë arsye, çdo shoqëri që dëshiron të përfitojë nga ndihmesa hyjnore, nuk duhet të zmbarsset nga marrja e lutjes së parisë fetare që zotëron një spiritualitet, dijetarëve, njerëzve të drejtë dhe fukarenjve. Përveç kësaj, ata që marrin udhëheqjen e shoqërisë, duhet ta kenë kujdes këtë situatë, triumfin nuk duhet ta kërkojë vetëm tek fuqia materiale por edhe në lutjet e tyre.



Nëse do të bësh plane FILLO NGA VETJA

Mehmet Dinç

Njeriu në këtë botë do më shumë fëmijën e vet. Kjo dashuri, pa dyshim sjell me vete edhe pritshmëritë. Prindërit duan që fëmija i tyre të jetë mirë, të jetë gjithnjë mirë, të jetë më mirë. Kjo dëshirë është mjaft e natyrshme dhe e drejtë. Sidoqoftë, siç thonë edhe etërit tanë, në këtë botë ekziston një fëmijë që është më i miri dhe çdo prind është zotëruesi i këtij fëmije kaq të mirë. Por nëse dëshira e mirë që përmendet këtu, bëhet shkak që prindërit të fillojnë ta shikojnë fëmijën e tyre si një plan dhe ta kurdisin atë si një aparaturë mekanike, në përputhje me planet që përfytyrojnë vetë, atëherë këtu ka një problem. Sepse njeriu nuk është një projekt, nuk ngjason fare me një makinizëm. Çdo fëmijë ka tepricat dhe mangësitë e botës së vet. Dikujt prej tyre i ka ardhur që prej lindjes, e dikush tjetër e ka fituar më pas; kanë imagjinatat dhe planet

e tyre, kanë të dashur dhe të urreyer, kanë mundësi apo pamundësi për të vepruar. Shpërfillja e të gjitha këtyre dhe shndërrimi i fëmijës në një mekanizëm që merr çfarë t'i japësh, bën çfarë t'i thuash dhe shkon atje ku e dërgon, është shpenzim i tepruar i kohës, shpenzim i marrëdhënieve dhe i së ardhmes, si për prindërit ashtu edhe për fëmijën.

Në fakt, shumica e prindërve i dinë të gjitha këto, por megjithatë, përsëri para nesh del një humnerë e thellë midis teorisë e praktikës dhe prindërit vazhdojnë përpjekjet e tyre, pavarësisht çdo gjëje, për të rritur fëmijë projektimi. Mirëpo, përse prindërit duhet t'i realizojnë me këmbëngulje disa gjëra mbi fëmijët e tyre, megjithëse i vendosin apo nuk i vendosin emrin projekt (*plan*) veprave që bëjnë?

Çdo fëmijë ka tepricat dhe mangësitë e botës së vet. Dikujt prej tyre i ka ardhur që prej lindjes, e dikush tjetër e ka fituar më pas; kanë imagjinatat dhe plane e tyre, kanë të dashur dhe të urreyer, kanë mundësi apo pamundësi për të vepruar. Shpërfillja e të gjitha këtyre dhe shndërrimi i fëmijës në një mekanizëm që merr çfarë t'i japësh, bën çfarë t'i thuash dhe shkon atje ku e dërgon, është shpenzim i tepruar i kohës, shpenzim i marrëdhënieve dhe i së ardhmes, si për prindërit ashtu edhe për fëmijën.



Pa dyshim, përgjigja e vetme e kësaj pyetje ndryshon sipas faktit se si e shikojnë prindërit të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen, në kuadër të kësaj pikëpamjeje dhe mënyrës së pozicionimit të vetes apo familjes së tyre.

Për shembull: disa prindër duan t'i mbyllin llogaritë sipas të kaluarës së tyre në kurriz të fëmijëve, fletorja e (*llogarive*) të të cilëve nuk është mbyllur ende. Ato çfarë ata nuk arritën dot t'i bënin dhe të kishin sukses në të kaluarën në pamundësi, me injorancë dhe provincialitet etj., dëshirojnë që fëmijët e tyre t'i bëjnë dhe t'ia dalin mbanë. Mobilizohen për të realizuar ëndrrat që nuk u realizuan në atë kohë, kur nuk shfrytëzuan dot kohën, përpjekjet dhe mundësitë e tyre. Por ajo ëndërr që nuk u realizua është ëndërra e tyre e përealizuar, jo e fëmijëve të tyre. Qëndrojnë me këmbëngulje mbi anglishten e fëmijëve, megjithëse në asnjëfarë mënyre nuk e rregullojnë dot anglishten e tyre; nëse nuk kanë aftësim muzikor, kërkojnë të marrin mësim muzikor; nëse janë të zhgënjyer në konceptin e pozitës, bëjnë çdo gjë që fëmijët e tyre të arrijnë një pozitë të caktuar.

Nëse fëmijët e tyre nuk tregojnë dëshirë të madhe për ëndrrat e prindërve të tyre, prindërit vënë në pikëpyetje në fillim aftësinë e fëmijëve, pastaj moralin e tyre, të cilët kanë qëndruar kaq indiferentë ndaj ëndërrave të tyre, vlera e të cilave është e pagjyqeshme, që e kanë bartur përbrenda si një nyjë për vite të tëra. Gjithsesi, për të mos realizuar një ëndërr të tillë, ose duhet të jesh i paaftë ose dembel. Megjithatë, nuk ka asnjë shkak që fëmija të shkojë pas asaj ëndërr. Prandaj, mund të mos jetë i motivuar aq sa dëshiron, siç kanë dëshiruar prindërit e tyre. Sa mund të jetë i motivuar njeriu me një ëndërr që nuk e ka thurur vetë?

Disa prindër nuk janë të lumtur nga gjendja e tyre e sotme. Ata nuk ia kanë dalë dot të bëhen ashtu siç dëshirojnë dhe pas kësaj ore, duket si e pa mundur të bëhen. Në këtë rast, e vetmja mënyrë për të dalë nga kjo, është që njerëzit t'i rrisin fëmijët e tyre ashtu siç duhet. Fëmija më i kualifikuar, më i veçantë, më i aftë dhe më i talentuar do të jetë fëmija i tyre, që nëse askush nuk ka folur për ta, të flasë për fëmijët e tyre. Për një prind që nuk ka asnjë pozitë të mjaftueshme për vete, të jetë babai i një fëmije që flitet gjithnjë rreth tij, është një pozitë mjaft e mirë. Për këtë arsye, ata ngarendin fëmijët e tyre nga një kurs në tjetrin, nga një provim në tjetrin, nga kjo shkollë në një shkollë tjetër. E mbajnë gjithnjë lart thuprën, që fëmijët e tyre të



jenë gjithnjë në lëvizje, të kryejnë vazhdimisht ndonjë gjë dhe t'ia dalin mbanë.


Nuk është problem, nëse nuk e di se për çfarë e kryen diçka apo përse ia ka dalë mbanë, do të vijë dita për ta kuptuar. Nga ana tjetër, në botën e fëmijës dominojnë disa fakte krejt ndryshe. Por rritet një njeri me një identitet dhe personalitet të shtypur e të nëpërkëmbur dhe që vrapon vazhdimisht me një ndjenjë pamjaftueshmërie pambarim, duke mos ditur se çfarë kërkon. Ndoshta është i sigurt nga sukcesi i së nesërmes, por është vazhdimisht në dyshim për lumturinë e vet.

Disa prindër kanë aspirata për të ardhmen. Prandaj, duan që fëmijët e tyre ta jetojnë plot e përplot jetën e tyre, të cilën nuk e jetuan dot vetë. Por për ta pasur të mbushur plot e përplot, punojnë për ta mbushur, duke parë të nesërmen krejtësisht prej ditës së sotme.

Mendojnë që fëmijët e tyre ta fillojnë të ardhmen të përgatitur, për arsye se vetë ata janë zënë të papërgatitur për ditët e sotme. I orientojnë fëmijët e tyre drejt profesioneve të famshme si profesione të së ardhmes, i marrin menjëherë aparatet që kanë mësuar t'i përdorin si teknologji e së nesërmes dhe dëshirojnë t'i mësojnë edhe fëmijët e tyre. Përpiqen t'i rrisin fëmijët e tyre përtej kohës që kanë jetuar vetë. Për këtë arsye, fëmijët e tyre mbeten të detyruar të takohen kryesisht me më të mëdhenj se vetja, në vend të bashkëmoshatarëve të tyre. Për këta fëmijë është sikur të kenë veshur rroba shumë të gjera dhe të papërshtatshme që i shqetëson ata.

Çfarëdolloj shkak të "*pranueshëm*" të kenë prindërit për veten e tyre, fëmija nuk është projekt-plan. Aktualja ose e ardhmja e tyre, nuk është fëmija apo bashkëshortja e tij, por vetëm dhe vetëm vetvetja. Për këtë arsye, nëse do të bëjë një plan, duhet ta bëjë mbi veten e vet. Është e padrejtë të presë nga i biri që është më i vogël dhe pa përvojë një njeri, i cili ekziston vetëm në kokën e tij. Natyrisht që prindërit duan të mirën e fëmijës së vet. Prandaj, ajo që kërkohet përsëri është të bëjnë plane mbi veten e jo mbi fëmijën e vet.

Sidoqoftë, fëmija ndikohet më shumë nga sjelljet e prindërve sesa nga fjalët e tyre; një prind që e kontrollon veten, që programon plane mbi veten e vet, pa dyshim që do të rrisë fëmijë më të drejtë se një prind që përpiqet ta konsiderojë fëmijën e vet si një plan dhe ta trajtojë si të tillë, duke mos bërë asgjë që ka lidhje me të dhe me qortime e ndëshkime.



Muhamedi (a.s.)

PROJEKTUES I QYTETËRIMIT

Ma. Merxhan Shehu

Personalitetet e famshëm ngjasojnë me malet e larta. Ata lartësohen mbi të tjerët, dallohen lehtë dhe duken edhe nga larg, por në të njëjtën kohë, ngjitja në lartësi është pak e gjatë dhe e mundimshme që kërkon vullnet dhe durim. Në vetëdijen njerëzore, malet simbolizojnë krenarinë, madhështinë dhe bukurinë. Mbi majat e tyre gjenden dhe drejtohen vështrimet nga të gjitha anët e horizontit.

Personaliteti i Profetit Muhamed (a.s.), është në gradën më të lartë. Në librin "Njëqind personalitetet më me ndikim në histori", autori Majkëll Hart e ka renditur Profetin Muhammed (a.s.), të parin personalitet me ndikimin më të madh në historinë e njerëzimit, duke thënë: "Nuk kam asnjë shkak (arsye) të mos e rendis të parin këtë personalitet kaq të madh." Profeti Mu-

hamed (a.s.), si i dërguari i Zotit për mbarë njerëzimin, është personaliteti që u pajis me të gjitha bukuritë dhe lartësitë e shpirtit, zotëroi vetitë më të mira e të rralla, mendjen më të zgjuar, zemrën më të pastër, si dhe moralin më të lartë. Ai përfaqëson modelin në gradën më të lartë të kënaqësisë me Allahun, Krijuesin e gjithësisë. I ftoi njerëzit me fjalë të thjeshta dhe të qarta ta pranonin Islamin, jo vetëm për të mirën e tyre, por dhe të popujve të tyre. Profeti (a.s.), është simboli i përsosmërisë shumëdimensionale, si të individit, ashtu edhe liderit të shoqërisë njerëzore.

Nga çdo aspekt ai rrezaton dhe shërben si model perfekt i një njeriu të ndershëm, të drejtë, të besueshëm e të mëshirshëm, jo vetëm për bashkëkohësit e tij, por për të gjitha gjeneratat e mëvonshme të

njerëzimit. Në kupën qiellore yjet ndriçojnë më mirë gjatë natës së errët. I njëjtë është Muhamedi (a.s), është ylli i orientimit. Kush orientohet nga ky yll, nuk e humbet rrugën e drejtë në këtë dhe botën tjetër, që është e përjetshme.

Në botë nuk mund të gjesh ndonjë personalitet që të krahasohet me Profetin Muhamed (a.s), si burrë shteti, si mbrojtës i të drejtave njerëzore, si reformator në shoqëri, familjar, mik, shok, e mbi të gjitha, si i besuari dhe i Dërguari i Allahut dhe i ngarkuari me një mision për mbarë njerëzimin.

Çdo qenie e ndershme njerëzore gjen prehjen e qetësinë shpirtërore kur lexon, mëson dhe udhëhiqet nga cilësitë dhe virtytet e larta morale të këtij personaliteti. Ta njohësh Profetin (a.s), do të thotë të kuptosh se si ai dallon nga të tjerët, jo në nevojat materiale dhe në realitetet utilitare (dobi të çastit), por kryesisht në vizionin ndaj reales, në të gjykuarit e drejtë dhe në shpresën shpirtërore.

NJERIU I DIJES DHE I QYTETËRIMIT

Kurani në suren Nexhm, në ajetin 53, na bën të ditur se: **“Ai (Muhamedi), nuk flet nga vetja e tij. Ajo që thotë, s’është (gjë tjetër), përveçse shpallje që i frymëzohet”**, prandaj, duhet kuptuar se çdo thënie, veprim, miratim apo pëlqim i Pejgamberit (a.s), e ka burimin nga Allahu, prandaj Tradita Profetike është burimi kryesor, pas Kuranit, në ndërtimin e fesë, jetës, ligjit dhe qytetërimit islam.

Në kohën tonë ka nga ata njerëz që e akuzojnë Pejgamberin (a.s), se është kundër shkencës dhe qytetërimit. Mirëpo, nëse studiojmë jetën e tij, do të shohim se në të vërtetë ka ndodhur krejt e kundërta. Do të vërejmë se Muhamedi (a.s), ishte ai që i vendosi themelet e shkencës dhe civilizimit, mbi të cilat u ngrit shteti islam, prej të cilit u rigjallërua shekuj me radhë rruzulli tokësor.

Është e pamundur që ky njeri të mos jetë pishtari i shkencës dhe i civilizimit, kur fjala e parë që i’u shpall ishte “Lexo”. Madje, sipas Kuranit dhe Profetit (a.s), kërkimi i dijes dhe shkencës është obligim për myslimanët.

Muhamedi (a.s), ndërtoi shoqërinë islame, një shoqëri e virtyteve dhe moralit, shoqëri e civilizuar njerëzore, e pastër, e dëlirë, në të cilën imoraliteti nuk është i përhapur, e keqja nuk mbizotëron dhe shthurja

nuk është e zakonshme. Kështu u ndryshua botëkuptimi i njerëzve në shoqëri. Ai tregoi dhe vërtetoi se ishte shpëtimtari i gjithë njerëzimit. Ai hyri në një epokë të re të ndriçimit dhe rizgjimit të mendjes dhe solli një ringjallje konceptuale në zhvillim, së pari të qytetërimit islam dhe, së dyti, bëri që ky qytetërim të ndikonte edhe në zhvillimin e qytetërimeve të tjera të të gjitha kohërave.

Profeti (a.s), ishte shembulli i përkryer në zbatimin e Islamit në praktikë. Ai ishte sunduesi, gjykatësi e udhëheqësi ideal i njerëzve. Ai (a.s), transmetonte porosinë e Zotit, vendoste parime, i printe umetit, i mësonte popujt të krijonin familje dhe shoqëri të shëndoshë, si dhe ishte thesar i pafund i të gjitha virtyteve dhe i shpresës. Ai ishte themeluesi i shoqërisë më të përsosur islame, për të cilën çdo shoqëri e mëvonshme ka nevojë.

Dashuria për Profetin (a.s), është e detyrueshme për të gjithë myslimanët e sidomos për synuesit e jetës së devotshme. Kjo dashuri nuk duhet marrë vetëm në një kuptim sentimental dhe individual, por në tërësi, sepse shpirti i tij shpaloste madhësinë, të cilën e ndjen çdo mysliman i devotshëm. Për myslimanin ai është personifikimi i fisnikërisë, vëllazërisë, sinqeritetit, mëshirës, mirësjelljes dhe zemërgjerësisë. Ky aspekt i Profetit (a.s), shpaloset plotësisht në kohën kur ai ka jetuar mes shokëve të tij, emërtuar Epoka e Artë ose e Lumturisë, që në të vërtetë ka qenë modeli i periudhave vijuese dhe të cilën kanë synuar ta ndjekin të gjithë brezat e myslimanëve pas tij.

Nëse do të bënim një përmbledhje të vlerave dhe virtyteve të Profetit (a.s), të cilat projektuan qytetërimin islam, do të radhisnim si vijon:

1. Besimi i drejtë, i pastër dhe i qartë i njëshmërisë së Allahut (xh.sh) (Teuhid). Në çdo shoqëri, burimi i normave është besimi i cili eviton çdo lloj paqartësie. Normat e nxjerra nga besimi, i japin jetës një kuptim të qartë. Themeli shpirtëror i qytetërimit është besimi.

2. Parimi i unitetit dhe barazisë njerëzore. Islami është i integruar nga parimi i unitetit, që është boshti i ekzistencës së tij. Uniteti qytetërues islam, në një masë të madhe është i ngritur mbi bazën e normave ligjore të dala (nxjerra) nga Kurani dhe të zbatuara nga Profeti (a.s). Ai (a.s), theu të gjitha barrierat racore e nacionale, duke dhënë një kontribut unik për bash-



kimin dhe vëllazërimin e njerëzve në një komunitet multi-etnik dhe multikulturor, me një besim të vetëm, me besimin në Një Zot.

3. Proklamimi i prestigjit dhe ekselencës njerëzore. Ishte Profeti (a.s), ai i cili vendosi themelet e një qytetërimi të ri, që bëri kthesë të madhe në avancimin e qytetërimit njerëzor. Barazia dhe të drejtat individuale e shoqërore, që garantoreshin dhe jetësoheshin në kushtet e shoqërisë islame, ngritën lart imazhin dhe prestigjin e kësaj bashkësie në nivelin qytetëruar të kohës.

4. Kthimi i prestigjit të gruas dhe dhënia e së drejtave dhe privilegjeve të saj. Siç mund të jetë e drejta civile që gruaja të gëzojë të drejtën bazë të zgjedhjes, shprehjes si dhe të edukimit, mund të jetë edhe e drejta sociale, politike dhe ekonomike. Kjo nënkupton të vërtetën se ndër faktorët kryesorë për zhvillimin e një shoqërie të suksesshme mund të kërkohej tek nënat që e rritin dhe e edukojnë atë shoqëri.

5. Përdorimi i mendjes dhe shfrytëzimi i saj, luftimi i dëshpërimit dhe pesimizmit, si dhe ngjallja e shpresës, aspiratës, mirësisë, drejtësisë dhe nderit, të cilat janë vlera qytetëruese që duhet të afirmohen në të gjitha mënyrat e mundshme.

6. Bashkimi i fesë dhe kësaj bote. Në qytetërimin islam, i cili është krijuar në bazë të mendimeve dhe ideve të pastra, feja dhe bota janë të gërshetuara me njëra-tjetrën. Islami është një fe, e cila i kushton vëmendje dhe rëndësi, si aspektit material, ashtu edhe fetar të njerëzve. Feja është një mjet për zhvillimin dhe plotësimin e njeriut dhe është e lidhur fort me mendjen dhe intelektin. Sociologu i njohur mysliman, Ibn Khaldun, lidhur me këtë thotë: "Aspektet fetare dhe mendore të njeriut, duke u ndërthurur me ato njerëzore të tij, krijojnë një civilizim të madh." Vlen të theksohet se qytetërimi islam ka eliminuar elementët dhe faktorët negativë të së kaluarës dhe, duke përdorur dhe zgjeruar faktorët pozitivë, ka krijuar kushte për lulëzimin dhe formimin e qytetërimit të madh islam.

7. Krijimi i lidhjes së shenjtë të përhershme mes fesë dhe shkencës, ky binom tregon vlerësimin dhe inkurajimin për zhvillimin e shkencës dhe është në dobi të vërtetimit të fakteve të krijimit të gjithësisë.

Përsëritshmëria e Islamit, modeli i së cilës është Profeti (a.s), nuk nënkupton refuzimin e botës, por tejkalimin e saj nëpërmjet integritimit në një qendër dhe vendosjes së një harmonie, tek e cila mbështetet kërkimi i Absolutit. Në këto cilësi që i shpalosi aq dukshëm, Profeti (a.s), është njëherësh shembulli i përsosmërisë njerëzore e shpirtërore dhe udhëzuesi në realizimin e saj.

8. Detyrimi i umetit islam për ta pranuar përgjegjësinë e udhëzimit të botës dhe mbikëqyrjes së moralit, drejtiveve dhe sjelljes së individëve dhe popujve, si dhe ta bartë përgjegjësinë për drejtësi dhe dëshmi për hir të Zotit. Nga pikëpamja islame, parimi i njëshmërisë (tevhidit) zbatohet në shpirt dhe materie, shpirt dhe trup, shkencë dhe fe, njeri dhe natyrë, si dhe të vetë myslimanët: Qëllimi i tyre i përhershëm është formimi i unitetit në formë të Umetit (bashkësisë).

Vetëm nëpërmjet realizimit dhe praktikimit të këtyre virtyeve, parimeve dhe vlerave, myslimani arrin gradën ideale dhe nëpërmjet tyre ndërtohet qytetërimi islam, duke mos harruar se njeriut i është dhënë aftësia për të qenë i qytetëruar që në krijimin e tij dhe që atëherë, ai ka arritur ose të paktën ka kërkuar rrugët e të qenit i qytetëruar.

Këto ishin virtytet e Profetit (a.s), të cilat projektuan qytetërimin, nëpërmjet të cilave ndjekësit e tij (a.s), administruan qytetet dhe qeverisën provincat.

Në sajë të tyre njerëzit jetuan të lumtur, duke shijuar drejtësinë e vërtetë. Ata përhapën në popull paqen dhe qetësinë dhe i bënë njerëzit të jetonin me njëri-tjetrin si vëllezër.

Është edhe një realitet, që duhet cekur (theksuar) dhe që duhet ta ketë në mendje çdo mysliman: qytetërimi islam nuk mund të ndikojë në qytetërimin njerëzor- botëror, nëse bëhet imitues apo vjedhës i qytetërimeve të tjera. Kështu, ai nuk mund ta ruajë identitetin e tij e jo më t'i shtyjë popujt e tjerë ta përvetësojnë atë! Ndikimin mund ta arrijë, vetëm nëse myslimani beson bindshëm se qytetërimi i tij është i pavarur, i përsosur, me identitet të posaçëm hyjnor qiellor, i vlefshëm për çdo kohë e vend, i ngritur mbi baza të forta dhe i mbështetur në Kuran dhe Traditën Profetike.

Ai hyri në një epokë të re të ndriçimit dhe rizgjimit të mendjes dhe solli një ringjallje konceptuale në zhvillim, së pari të qytetërimit islam dhe, së dyti, bëri që ky qytetërim të ndikonte edhe në zhvillimin e qytetërimeve të tjera të të gjitha kohërave.

Ku jeni ju, ku jemi ne?

Fehmi Çiçek

Sot do të shkruaj diçka për ju... Duke dredhur e dredhur lapsin në dorë... Ndoshta unë nuk jam i kualifikuar për të shkruar, ndoshta frikësohem se mos keqkuptohet, ndoshta ngaqë do ta tregoj gabim?.. Mangësia në fjalë, i takon atij që e thotë.

Ashtu, apo jo! A ka ndonjë gjë më të rëndë në këtë botë për një shkrimtar sesa "moskuptimi"? Sidomos "keqkuptimi"?.. A mund ta mendoni, kur ju jeni me të vërtetë shumë bujar, njerëzit t'ju njohin si kopracc? Ju jeni shumë i mëshirshëm, por njerëzit përreth ju konsiderojnë sikur jeni "të vrazhdë"? Ju jeni artist, mjeshtër, poet, dijetar; por njerëzit nuk e vlerësojnë artin tuaj?.. Neve na vjen kaq rëndë "moskuptimi" dhe "keqkuptimi"; po ata që nuk e njohin Zotëruetin e Lartësuar "Fuqia e të Cilit është e Pafundme", i cili drejton dhe sundon këtë gjithësi? Ata që e keqkuptojnë këtë? Ata që e mohojnë? Ata që i bëjnë ortakëri (shirk)?..

Një herë e pyetën mjekun e madh Ibn Sinain (Avicenën): "Cila është sëmundja e pashërueshme?" Dijetari përgjigjet: "Nevoja e dijetarit për injorantët."

Ja kështu pra. Profeti i nderuar ka thënë në Ligjëratën e Lamtumirës: "Këto fjalë që po them, ata (dëshmitarë) që ndodhen këtu t'ua tregojnë atyre që (mungojnë) nuk ndodhen këtu. Ka prej atyre që dëgjojnë një fjalë dhe e kuptojnë më mirë sesa ata që e thonë atë (rubbe mubellagin ev'a min mubellig)." Gjithsesi, unë do ta shkruaj përsëri. Ndoshta ai që e lexon e kupton më mirë se ai që e shkruan...

Një grua pyet xhematin:

- Çfarë është bujaria?

- Pasuria që është shpenzuar në rrugë të hajrit, iu përgjigjen.

Gruaja:

- Kjo është bujaria e banorëve të kësaj bote dhe

masës (njerëzit e zakonshëm). Unë ju pyes për bujarinë e parisë (njerëzve të zgjedhur, krerëve të vendit), thotë.

Ata:

- Bujari është shpenzimi i gjithë energjive dhe i përpjekjeve drejt bindjes ndaj Allahut, - i përgjigjen.

Gruaja:

- A prisni ndonjë sevap (shpërblim) si shpërblim për këtë?- i pyet.

- Natyrisht që po, - i përgjigjen ata.

Gruaja:

- Allahu i Lartësuar thotë: "**Kush bën një vepër të mirë, do të shpërblehet dhjetëfish...**" (En'am: 160) Ju merrni dhjetë në një. Ku është bujaria këtu?

Pas kësaj, kur xhemati e pyet gruan:

- Mirëpo, çfarë thua ti? - ajo u jep këtë përgjigje:

- Bujari është ta kryesh një punë vetëm për hir të Allahut!.. As për xhenet, as për xhehenem... As për shpërblim, as nga frika për dënim... As për të fituar shpërblimet e xhenetit, as për t'u mbrojtur nga ndëshkimi i xhehenemit... Ta bësh vetëm për hir të Allahut...

Çfarë perspektive është kjo, çfarë pune? Çfarë lavdie është kjo, çfarë delikatese është kjo? Çfarë filozofi jete është kjo, çfarë konceptimi është ky? Kush del, kush mbërrin në këtë pozitë? Kush tjetër përveç Havvassu'l-Havvas (më i zgjedhuri prej të zgjedhurve-elitës), i cili nuk i ka sytë (për të përfituar) tek asgjë, i cili dëshiron vetëm të arrijë tek Allahu dhe zemra e të cilit digjet me zjarrin e dashurisë?..

Dëgjoni mirë fjalët e mëposhtme që ka thënë gruaja përmendore me vlera të larta, Rabiātu'l-Adevijje:

O Zoti im! Këto adhurime që po bëj, nëse i kam bërë për shkak të frikës së xhehenemit Tënd, më hidh brenda në xhehenem!.. Këto adhurime që po bëj, nëse i bëj ngaqë shpresoj xhenetin Tënd, më privo nga xheneti!.. Por, nëse këto adhurime i bëj vetëm për të fituar kënaqësinë (pëlqimin) Tënde, mos më privo nga shikimi i bukurisë Tënde. Mos e bëj, Zoti im!..

O njerëz të mëdhenj, që keni shkruar, o!.. Ku jeni ju... ku jemi ne... Paqja qoftë mbi ju...

MREKULLITË E Kuranit

TRËNDAFILI I KUQ

Kjo foto është marrë në hapësirë nga agjencia ajrore amerikane NASA. Në të pasqyrohet një yll, i cili kur shpërthen, merr një formë që i përngjan trëndafilit të kuq. Prandaj edhe shkencëtarët perëndimorë e kanë quajtur "trëndafili kuq". Nga surprizat e Kuranit është se ai ka folur për këtë dukuri që para 1400 vjetësh kur Zoti (xh.sh) na rrëfen se një nga peripecitë e Ditës së Gjykimit është: **"Veç kur të çahet qielli dhe të bëhet i kuq si trëndafili."** (Rahman, 37) Vëreni me mua se si studiuesit perëndimorë shprehen me të njëjtat shprehje të Kuranit. A nuk tregon kjo se Kurani është libri i Zotit (xh.sh.)?

YLLI TROKITËS

Ky vizatim përfaqëson një ndër yjet që studiuesit e hapësirës i kanë emërtuar si yjet goditëse. Këto yje, të cilat sapo janë zbuluar, nxjerrin një zë që i ngjason goditjes së çekiçit, prandaj dhe studiuesit i quajnë "çekiçët gjigantë". Nga veçoritë e këtyre yjeve është se ato lëshojnë rreze gama dhe valë elektromagnetike që përshkojnë çdo gjë që u del përpara. Thotë Allahu (xh.sh) thotë: **"Pasha qiellin dhe yllin ndriçues (të natës)! E ku e di ti se çka është trokitësi? Ai është ylli që shpon terrin."** (Tarik, 1-3) Realisht shkencëtarët kanë zbuluar se këto yje godasin sipërfaqen e qiellit duke lëshuar rreze përshkuese. Pyetja që ngrihet është se kush e lajmëroi Profetin Muhamed (a.s), rreth këtij realiteti kozmik? A nuk është Ai, Allahu (xh.sh)?



Një Ajet

"A mendoni se do të hyni në Xhenet, pa i provuar Allahut ata që kanë luftuar prej jush dhe pa i provuar ata që kanë duruar?"

(Al 'Imran, 142)

Jeta, vdekja, toka, qielli shkurtimisht i gjithë universi është krijuar për një qëllim të caktuar. Dhe qëllimi është testimi dhe provimi i njeriut në tokë. Allahu, krijuesi i gjithësisë, e ka caktuar dynjanë si vend sprove për njeriun.

Sprova do të bëjë të mundur dallimin e të mirit nga i keqi, paqësorit nga ngatërrestari, punëtorit nga shkatërruesi. Përmes kësaj sprove do të dallohet cili është ndjekësi i mësimave hyjnore dhe cili është ndjekësi i shejtanit. Sipas kësaj do të realizohet edhe vlerësimi në Ditën e Gjykimit.

Në jetën e kësaj bote jemi përballë një zgjedhjeje. Dhe gjithsecili bën zgjedhjen e vet. Dikush punon për dynjanë, dikush për ahiretin, dikush zgjedh drejtësinë, dikush tjetër padrejtësinë.

Jeta e kësaj bote për besimtarët është si një rrugë me pengesa. Këto pengesa nganjëherë shfaqen si fatkeqësi, nganjëherë si mirësi. Shpëtimin e përhershëm do ta arrijë ai që i kalon një për një këto pengesa. Çdo fushë e jetës luan rolin e një site për njeriun, çdo veprim vë në dukje sinqeritetin, besnikërinë ose dyfytërsinë tonë.

Kurani jep shembuj konkretë për sprovën e njeriut në këtë botë. Ngjarja e Talutit me Xhahun është një nga ato. Taluti merr pjesë në luftë për të luftuar kundër armiqve, por gjatë rrugës ndodh një sprovë e papritur: Allahu ua ndalon të pinë ujë në lumin që do t'u dalë përpara, përveçse një grushti uji. Mirëpo ushtarët, të etur për ujë nuk e respektuan këtë urdhër dhe pinë ujë deri sa u ngopën. Në këtë mënyrë humbën provimin.

Sprova të tilla i përjeton gjithsecili prej

nesh në jetën e tij. Ne sprovohemi në punë, në shtëpi, në rrugë. Sprova, herë shfaqet në planin individual, herë në planin shoqëror. Ne mund gjendemi përballë një sprove në çastet më kritike të jetës sonë. Tundimet e shejtanit dhe egos janë një sprovë për besimin dhe besnikërinë tonë. Në të tilla raste vigjilenca është shumë e rëndësishme.

Në të tilla raste besimtari është i vetëdijshëm për vëzhgimin e rreptë hyjnor. Prandaj besimtari vihet me të gjithë forcën për të përballuar sprovën me të cilën është përballur.

Jeta e njeriut është e mbushur me ulje dhe ngritje, herë jemi të lumtur herë të hidhëruar, herë të pasur herë të varfër. **"Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë "Ne besojmë", pa u vënë në provë? Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë."** (Ankebut, 2-3) Siç theksohet në ajetin e mësipërm, sprova është pjesë e kaderit të njeriut në tokë.

Të gjithë njerëzit do të kalojnë nëpër sprova, nga ky rregull nuk kanë bërë përjashtim as pejgamberët. E gjithë jeta e pejgamberëve ka qenë e mbushur me sprova nga më të ndryshmet.

Njeriu, përballë çdo provimi mban një qëndrim të caktuar, është pikërisht ky qëndrim i cili nxjerr në pah natyrën e moralit të personit. Këtë rregull Kurani na e kujton në këtë mënyrë: **"Ne do t'ju vëmë në provë ju, derisa t'i njohim ata midis jush, që luftojnë (në rrugën e drejtë) dhe durojnë e derisa të provojmë ato që thuhet për veprat tuaja."** (Muhamed, 31)

Pejgamberi -salall-lahu alejhi ve selem-, ka thënë:

“Janë dy mirësi të cilat shumica e njerëzve i neglizhojnë; shëndeti dhe koha e lirë.”

(Buhari, Rikak,1)

Zoti në Kuran, për mirësitë e pafundme dhuruar njeriut, nga një anë kërkon të jetë falënderues dhe mirënjohës dhe nga ana tjetër tërheq vëmendjen të mos përfshihet nga vetë-kënaqësia. **“O njerëz! Pa dyshim, premtimi i Allahut (Dita e Gjykimit) është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtroni kurrsesi jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtroni djalli për Allahun.”** Ndërsa në njërin anë na kujton se do të vijë një ditë ku do të kërkohet llogari për çdo mirësi, në anën tjetër kërkon të jemi vigjilentë përballë armiqve të cilët synojnë të harrojmë Ditën e Gjykimit.

Kurani na jep shpesh shembuj konkretë të atyre që u mashtruan nga pozita, fama, pasuria dhe mirësitë e tjera kalimtare, në mënyrë që të mos biem në të njëjtën grackë. Kurani na këshillon të mos mashtrohem, sepse kur të vijë dita që të na dalë në pah mashtrimi, nuk do të ketë asnjë dobi.

Pejgamberi (a.s), i cili është prijësi ynë në jetën e kësaj bote, na ka tërhequr vëmendjen për dy mirësi, të cilat shumë prej nesh i neglizhojnë. Shëndetin dhe kohën e lirë. Këto dy mirësi nuk janë të domosdoshme për jetën tonë vetëm në këtë botë, por janë të domosdoshme edhe për të ndërtuar botën tjetër. Sepse për të kryer detyrat duhet shëndet dhe të gjitha detyrat kryhen në një kohë të përcaktuar.

Megjithëse rëndësia e shëndetit theksohet pothuajse në çdo mjedis, ai është ndër mirësitë më të neglizhuara dhe të lëna pas dore.

Pasuria materiale pa shëndet është krejtësisht e pakuptimtë dhe e pavlerë. Feja islame ka treguar një kujdes të veçantë në mbrojtjen e shëndetit. Hadithet që flasin për mirushqyerjen, pastërtinë e dhëmbëve, gojës, trupit, enëve, mjedisit, sportit etj., janë të gjithë tregues të kujdesit që tregon Islami për shëndetin e njeriut.

Një tjetër mirësi, të cilën e neglizhojmë shpesh, është edhe koha e lirë. Allahu na ka dërguar në këtë botë për të na sprovuar se cili është vepërmirë e cili jo, në një kohë të caktuar. Mirëpo ne, të mashtruar nga kënaqësitë e kësaj bote, harrojmë detyrat që kemi përballë Allahut me shpresën se jeta jonë është e gjatë dhe me iluzionin se vdekja është shumë larg, harrojmë që çdo moment i kaluar është i pakthyesëm.

Vetë betimi që bën Allahu mbi kohën është një tregues i qartë i rëndësisë dhe vlerës së saj në jetën e njeriut. Ata që e investojnë kohën në vepra të këqija, në Ditën e Gjykimit do të pendohen dhe do të kërkojnë leje për t'u rikthyer, por atëherë do të jetë tepër vonë dhe përgjigja ndaj kërkesës së tyre do të jetë: **“Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)? Madje juve ju erdhi edhe paralajmërimi!”** (Fatir, 37), prandaj besimtari duhet të vlerësojë më së miri çdo moment të jetës së tij dhe vazhdimisht të falënderojë Allahun për këto dy mirësi të mëdha.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Koha dhe shëndeti janë dy nga mirësitë më të çmuara që ka njeriu.
2. Njeriu i neglizhon këto dy mirësi.
3. Njeriu në përgjithësi është neglizhent ndaj mirësive.

Mje: Hadith



SHQETËSIMI I NJË BESIMTARI PËR BREZAT

Midis njeriut dhe botës ekzistojnë ngjashmëri dhe lidhje të mëdha. Për rrjedhojë, thuhet se gjithësia është “alem-i kubra/makrokozmosi”, ndërsa njeriu, përfshi gjithçka të gjithësisë, është një kopje e vogël e saj, pra një “alem-i sugra/mikrokozmos”.

Arsyeja e kësaj, është se bota është krijuar për spro-ven e njeriut dhe se çdo gjë në gjithësi është vënë në shërbim të njeriut. Çdo gjë, me atë që të sjell ndërmend dhe të bën të meditosh, i tregon njeriut të vërtetën e vetes së tij. Për këtë arsye, kur shihet me syrin e zemrës, çdo cep i gjithësisë, madje siç shprehet Shejh Sadi, edhe një gjethë e vetme e një pemë, shpreh divane të tëra.

Po, ajo gjethë i ka hapur dorën mëshirës hyjnore dhe, energjinë që ka marrë prej diellit, e kthen në ushqim, duke e bartur në trupin e pemës së saj. Ajo bëhet ushqim dhe siguron hije për njeriun dhe krijesat e tjera... Por edhe rrënjët e pemës përfitojnë prej atyre që vijnë pranë saj të tërhequr nga këto mirësi... Ajo gjethë, herë bëhet ushqim i një krimbi mëndafshi, duke u kthyer në një mëndafsh të butë dhe herë bëhet ushqim për kafshët që ushqehen me gjethë, të cilat kthehen në mish dhe qumësht për njeriun. Ndërsa gjethet që thahen e bien në tokë, kthehen në furnizim për shumë gjallesa të tjera dhe në ushqim për tokën.

Në atë gjethë të vetme vërehen edhe shumë fenomene dhe aventura të mrekullueshme, të cila sot i quajmë “sistem ekologjik”.

[Veçanërisht në ditët e sotme, prindërit fetarë duhet ta vendosin kokën midis dy duarve dhe të mendojnë: Fëmijët janë të tyre apo mos vallë janë të rrugicave të errëta e të ndyra me vjelljen e të dehurve dhe me lloj-lloj gjërash të mallkuara?]

Le të meditojmë pak. Përse gjithë ky sistem i mrekullueshëm vetëm në një pemë?

Pikësëpari, për një ekspozitë të bukur hyjnore lule dhe, natyrisht edhe për fruta...

Mirëpo, ndërkohë që pema u shërben njerëzve dhe krijesave të tjera me frutat e saj, lind edhe një qëllim tjetër:

VAZHDIMËSIA E BREZIT...

Sa bukur e ka shprehur këtë qëllim të madh jetik poeti i famshëm turk, Nexhip Fazëll:

“Pema që s’e ka hall sythin, është thjesht dru!”

Fëmijët tanë arrijnë të përdorin televizionin, internetin dhe telefonin apo këto aparate po i komandojnë fëmijët tanë?

Me të vërtetë që kriteri jetik për të bërë dallimin midis drurit dhe pemës, trungut dhe rrënjës është aftësia për të dhënë filiza. Ta kesh hall sythin, do të thotë të synosh përhapjen e farës. Me një fjalë, të sigurosh vazhdimësinë e brezit.

Pema; rrënjë, trung, gjethë dhe frut... Secila dhe të gjitha; janë dërguar nga Krijuesi i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur për ta bartur në të nesërmen bërthamën e vendosur në qendër të çdo fruti, me qëllim që të sigurojnë vazhdimin e brezit.

I njëjti instinkt ndodhet edhe tek zogu që përpiqet për të voglin e vet...

Të njëjtën detyrë kanë edhe me mijëra lloje gjallesash që jetojnë në tokë e në det, të cilat përshkruajnë me mijëra kilometra në rrugën e migrimit që s’e kanë parë kurrë, për të gjetur klimën e përshtatshme për ta, me qëllim që të sjellin në jetë të vegjlit e tyre, gjë të cilën e bëjnë prej mijëra vitesh...

[Kush i formon fëmijët tanë? Me botëkuptimin dhe orientimin e kujt edukohen? Çfarë shembujsh dhe cilët



personalitete ndodhen në zemrat, idealet dhe synimet e fëmijëve tanë?]

Ky ligj hyjnor mbizotëron në të gjithë botën e kafshëve, që u japin gjë të vegjëlve të tyre të pangrënë e të papirë, të uritur e të mjerë; që kërkojnë ushqim për ta; që bëjnë fole dhe i mbrojnë të vegjlit me jetët e tyre përballë çdo rreziku...

E njëjta dëshirë e fortë gjendet edhe tek bleta që bën mjaltë, tek zogjtë që bëjnë vezë, tek delja që jep qumësht, madje edhe tek gjarpri kur ushqen të voglin e vet...

Ky ligj i vendosur nga Allahu i Madhëruar në gjithësi, për besimtarin është një pasqyrë mesimdhënëse ku shfaqen pamje të urtësive të thella.

Në bazë të ligjit të botës së cilës i takon, edhe njeriu bart dëshirën për të siguruar vazhdimësinë e llojit të tij. Në zemrën tij, ai bart gëzimin për fëmijën, përpjekjen për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre dhe shqetësimin për të ardhmen e tyre. Ai punon dhe bën përpjekje vetëflijuese për ta.

Kush i formon fëmijët tanë? Nëse përgjigja e kësaj pyetjeje nuk është "Ne", në kuptimin e vërtetë dhe të sinqertë të fjalës, ashtu si natyra, edhe zemra e fëmijëve tanë nuk do të pranojë zbrazëti dhe vendin "tonë" do ta zënë të huajt.

Mirëpo, për një besimtar, ky nivel është i pamjaftueshëm. Po ashtu, edhe shqetësimi për brezin që bart njeriu, i cili është edhe krijesa më fisnike, ngrihet mbi themele më të larta dhe më shpirtërore.

Besimtari nuk ka hall të vazhdojë vetëm llojin dhe gjakun e vet me fëmijë, nipër e mbesa. Shqetësimi i tij,

është që parimet e besimit, adhurimit dhe moralit me të cilat është pajisur në sajë të bujarisë së Allahut dhe përpjekjeve të të parëve, t'ua përçojë edhe fëmijëve të vet. Një besimtar, e ndjen si një amanet të shenjtë në supet e tij, përgjegjësinë e përcimit të vlerave shpirtërore që ka trashëguar prej të parëve tek brezi pasardhës, pra, tek bijtë e vet.

Horizonti i tij i shqetësimit për të nesërmen nuk është i kufizuar me këtë botë, sepse një besimtar e di se:

T'i afroresh edukimit të brezave me një interes të përciptë, duke i dërguar fëmijët në xhami vetëm tre-katër javë për një apo dy sezona verore dhe gjatë gjithë kohës së mbetur t'i lësh ata në mëshirë të rrugëve, nuk të shpëton as prej gjynahut dhe as prej përgjegjësisë.

Jeta e vërtetë është ajo e botës tjetër...

Besimtari që ndjen shqetësim për fundin e fëmijës dhe të brezit, më tepër se për këtë botë kalimtare, e cila ka kushte të sprovvave me ngritje dhe zbritje, mendon për fundin final të fëmijëve të tij, pra gjendjen e tyre në botën tjetër. Dhe për këtë përpiket vazhdimisht.

Ashtu siç përpiket t'i përgatitë fëmijët e tij për këtë botë edhe mirësitë e kësaj

bote i fiton prej atyre që janë hallall, ai nuk lë pas dore as devotshmërinë, e cila është kapitali i vetëm për në rrugën e pafundme të botës tjetër.

Në edukimin e fëmijëve nuk është e mundur të mjaftohesh dhe të rehatohesh me marrjen e masave vetëm sa për ta hequr qafe. Është shumë e qartë se një gotë ujë nuk ka asnjë kuptim përballë flakëve që ngrihen si malet.



Pema; rrënjë, trung, gjethe dhe frut... Secila dhe të gjitha; janë dërguar nga Krijuesi i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur për ta bartur në të nesërmen bërthamën e vendosur në qendër të çdo fruti, me qëllim që të sigurojnë vazhdimin e brezit.



Sigurisht, në këtë botë, besimtari mendon për furnizimin e fëmijës së tij. Por shqetësim i tij i vërtetë është se a janë hallall apo jo ato kafshata që i jep atij. Në lidhje me orientimin e edukimit që i jep fëmijës, ai mendon se a do t'i japë fëmijës të shijojë prej mirësive të xhenetit, apo -Allahu na ruajtë- prej zakumit¹ dhe dënimeve me ujë të qelbur të xhehenemit.

Sigurisht, çdo nënë e mbulon të voglin e saj që ka ftohtë. Ajo dëshiron ta shohë atë të veshur me rrobat më të bukura. Mirëpo, një nënë me besimin në botën tjetër, mendon dhe shqetësohet më tepër se, a do ta mbështjellë fëmijën e saj me mëndafshin e xhenetit apo me zjarrin flakërues të xhehenemit në botën tjetër.

Njeriu që i beson Allahut dhe botës tjetër, kur vihet përball me lumturinë e fëmijëve të tij në këtë botë dhe në tjetrën, pa menduar për asnjë moment, e shtyn këtë botë me të pasmen e dorës dhe zgjedh botën tjetër... Ai nuk bëhet mendjelahtë dhe të lërë de-tin për një pikë ujë.

Njeriu, vlerën e tij të lartë, mund ta ruajë vetëm duke qëndruar në rrugën e drejtë të devotshmërisë ndaj Zotit të tij dhe duke jetuar në botën e Kuranit dhe Sunetit.

Ai nuk mund të thotë kurrë për fëmijën; le të hajë këtu në këtë botë, pa në botën tjetër le të hajë ç'të dojë! Le të ketë një të ardhme të ndritur në këtë botë, pa në botën tjetër le të bëhet edhe prej faqezinjve!

Ai nuk mashtrohet nga pëshpëritjet e shejtanit: "Le të bëjë jetë në këtë botë se, sidoqoftë, në botën tjetër do të falet". Por e kupton fare qartë se, përveç botës tjetër, ai mund të fitojë madje edhe lumturinë e kësaj bote, vetëm e vetëm duke bërë një jetë të pastër e të qetë, siç ka urdhëruar Allahu dhe siç e ka jetuar Pejgamberi (a.s). Ai nuk mashtrohet nga shejtanët prej njerëzve e xhindëve, që si liri paraqesin mjerimin mendor, dhënien pas epsheve dhe poshtërsitë; as nga reklamat dhe modat e ndryshme. Dhe po ashtu, nuk kaplohet as nga erërat e ftohta e të mbytura që fryjnë nga vendet e kufrit (mohimit).

Ai e njeh të vërtetën dhe e ndjek atë; e njeh të kotën dhe jeton me parimin dhe lutjen e ruajtjes prej saj. Po në

këtë drejtim i edukon edhe fëmijët e tij. Ai e di mirë se për njeriun e çmuar, rruga për të siguruar vazhdimësinë e brezit, nuk është biologjike, por shpirtërore.

Lidhur me këtë, një prej të parëve të letërsisë turke, Ashik Pasha, i cili ishte njeri i brumosur me besim dhe autori i veprës "Garib-name" në fushën e tasavvufit, ka numëruar katër rrugë për vazhdimësinë e brezit njerëzor:

Një njeri pa Kuran, edhe pse është ende gjallë, nuk ndryshon aspak prej gropës së varrit, si gropë xhehenemi të disa fatzinjve.

Katër lloj brezash

1. Brezi i gjakut: Ky përbëhet nga fëmijët që vijnë prej sojit të vetë njeriut dhe vazhdimësia e këtyre varet nga kaderi. Vjen një ditë dhe mund të ndërpritet. Por edhe nëse nuk ndërpritet, një njeri, më së shumti mund të shohë vetëm nipin e nipit. Nëse ata që vijnë pas janë të dobishëm, s'ka më mirë. Por në të kundërtën, njeriut nuk i bën asnjë dobi.

Besimtari nuk ka hall të vazhdojë vetëm llojin dhe gjakun e vet me fëmijë, nipër e mbesa. Shqetësimi i tij është që parimet e besimit, adhurimit dhe moralit me të cilat është pajisur në sajë të bujarisë së Allahut dhe përpjekjeve të të parëve, t'ua përçojë edhe fëmijëve të vet.

Për rrjedhojë, pas disa brezash, shumica e njerëzve nuk i njeh as gjyshërit e vet. Në fakt, nuk dihet nëse fëmijët do të dalin të dobishëm apo jo. Prandaj, një besimtar nuk mund të bëjë më tepër se një lutje me vepër dhe me fjalë, si Ibrahim (a.s)², me qëllim që pasardhësit e tij të jenë besimtarë, falës të namazit dhe breza të bindur ndaj Allahut.

2. Brezi ekonomik: Ky është shërbimi i bamirësisë, që njeriu e ka bërë me pasurinë dhe pronën e tij. Për sa kohë që ato bamirësi vazhdojnë të kenë dobi, ato vazhdojnë t'i shkruhen si sevape edhe atij që i ka bërë. Të parët tanë që e din mirë këtë, në vend që t'i linin më shumë pasuri brezit të gjakut të tyre, krijuan vakëfe për bamirësi, duke i shërbyer popullit dhe duke adhuruar Allahun. Në këtë mënyrë, ata arritën t'ia zgjatnin jetën librit të punëve të tyre me shekuj të tërë. Sot ka aq shumë bamirës, emrat e të cilëve i kemi ende në

1. - **Zakkum:** Emri i një peme në xhehenem, frutat e së cilës janë si koka djajsh. Shih. es-Saffat, 37/62-66.

2. - shih. el-Bekare, 2/128.

gjuhët tona në sajë të xhamive, vakëfeve e çezmave që kanë lënë pas, por që nga ana tjetër, nuk dihet dhe nuk interesohet kush se, a ka vazhduar më tej apo jo brezi i gjakut të tij...

[Besimtari e ndjen si një amanet të shenjtë në supet e tij, përgjegjësinë e përçimit të vlerave shpirtërore që ka trashëguar prej të parëve tek brezi pasardhës, pra, tek bijtë e vet.]

3. Brezi i udhëzuar: Këta janë fëmijët dhe nxënësit e mirë, të cilët njeriu i ka edukuar dhe i ka lënë pas. Ky brez vazhdon, nëse edhe këta vazhdojnë të edukojnë njerëz të tjerë pas tyre. Për shembull, sot, dijetarët që janë edukuar në medh'hebin Hanefi, a nuk janë si fëmijët e Ebu Hanifes, të cilët kanë ardhur shekuj më pas? Po ashtu, deri pak kohë më parë, nxirrej gjenealogjia e dëshmimeve të dijes, siç nxirrej gjenealogjia e sojit të sejjidëve³. Në këtë mënyrë, çdo nxënës e dinte se me cilin zinxhir i kishte ardhur dija që prej Pejgamberit tonë (a.s), duke u krenuar me këtë në formë falënderimi.

4. Brezi i diturisë dhe urtësisë: Këta janë librat e dobishëm që njeriu ka shkruar, me qëllim që të jenë ushqyes të mendjeve dhe zemrave të njerëzve të tjerë. Ky është edhe brezi më i frytshëm dhe më i vazhdueshëm. Një vepër e shkruar, është si një letër udhëzimi që u dërgohet njerëzve të panjohur që do të vijnë deri në Ditën e Kiametit.

[Njeriu që i beson Allahut dhe botës tjetër, kur vihet përballë me lumturinë e fëmijëve të tij në këtë botë dhe në tjetrën, pa menduar për asnjë moment e shtyn këtë botë me të pasmen e dorës dhe zgjedh botën tjetër...]

Kështu është "*Mesnevia*" e Mevlanës, "*Mektubati*" i Imam Rabbanit, "*Ihja Ulumi'd-Dini*" i Imam Gazaliut, poezitë e Junus Emresë, etj., vëllimet e të cilëve kalojnë dorë më dorë, ndërsa përmbajtja e tyre përçohet gojë më gojë, vesh më vesh dhe zemër më zemër, duke jetuar vazhdimisht...

Nëse shihet me syrin e urtësisë për të marrë mësim, do të kuptojmë se, vetëm nëse plotësohet kushti në pikën e tretë, brezi i gjakut mund të bëhet me të vërtetë një brez i vazhdueshëm. Brezi që do ta gëzojë dhe do ta qetësojë një besimtar, është brezi i dobishëm, i virtytshëm dhe i devotshëm. Janë bijtë dhe bijat e mira. Përndryshe, një fëmijë jo i mirë, ashtu siç shprehet edhe Kurani në lidhje me Kenanin, birin e Nuhut (a.s), nuk është prej familjes dhe brezit të një besimtari.

Besimtari nuk bëhet mendjelehtë dhe të lërë detin për një pikë ujë. Ai nuk mund të thotë kurrë për fëmijën; le të hajë këtu në këtë botë, pa në botën tjetër le të hajë ç'të dojë! Le të ketë një të ardhme të ndritur në këtë botë, pa në botën tjetër le të bëhet edhe prej faqezinjve!

3. - **Sejjid:** Pasardhësit e gjakut të Pejgamberit (a.s).

Një besimtar, e di mirë se, fëmija është një sprovë, ashtu si pasuria. Nëse atij i është dhënë një edukim dy krahësh në cilësinë e një "sadakaje xharije"⁴, ai fëmijë, për prindin do të jetë drita e syrit në të dyja botët; një fëmijë me të vërtetë i mirë, i cili do t'u vijë në ndihmë atyre në vendin e mahsherit⁵. Mirëpo, nëse nuk është edukuar me këto cilësi, në botën tjetër ai do të kthehet në një fatkeqësi, gjykimi dhe dënimi i së cilës do të jetë i vështirë dhe prej së cilës njeriu do të mundohet të ikë duke vrapuar.

Nisur nga kjo, të edukosh fëmijën dhe t'i dalësh për zot brezit, është një nga detyrat më kryesore të besimtari. Dhe shembullin më të bukur të plotësisimit me sukses të kësaj detyre, e ka dhënë Pejgamberi (a.s):

Një besimtar e di mirë se fëmija është një sprovë, ashtu si pasuria. Nëse atij i është dhënë një edukim dy krahësh në cilësinë e një "sadakaje xharije", ai fëmijë, për prindin do të jetë drita e syrit në të dyja botët.

SHEMBULLI I PEJGAMBERËVE

Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun për xhenetin. Dhe babain me nënën e njerëzimit, Ademin dhe Havanë, i vendosi në xhenet. Mirëpo, me të rënë në kurthin e shejtanit, i cili i shtyu në gjynah, filloi edhe aventura e sprovës për njerëzimin.

Nëse meditohet lidhur me këtë, kuptohet se Allahu i Madhëruar, njeriun e parë e ka krijuar me një familje. Allahu i Madhëruar, i Cili e krijoi Ademin, padyshim që e kishte fuqinë të krijonte edhe mijëra njerëz në të njëjtën kohë. Mirëpo, Ai dëshiroi që njerëzimi të rritej e zhvillohej brenda një familjeje prej një babai pejgamber, që e njehej egon dhe shejtanin, gabimin dhe pendimin dhe me dorën e një nëne, që i është gjendur pranë në këto çështje.

Fëmijë me të vërtetë i mirë, i cili do t'u vijë në ndihmë atyre në vendin e mahsherit. Mirëpo, nëse nuk është edukuar me këto cilësi, në botën tjetër ai do të kthehet në një fatkeqësi, gjykimi dhe dënimi i së cilës do të jetë i vështirë dhe prej së cilës njeriu do të mundohet të ikë duke vrapuar.

Gjithashtu, nëse meditohet, shihet se edhe pejgamberët e mëvonshëm që Allahu i Madhëruar ia dërgoi njerëzimit, i përzgjedhi prej një gjenealogjie të caktuar, prej familjeve dhe brezave të pastër, fisnikë dhe të mirë. Ai zgjodhi Ibrahim (a.s), bijtë e tij Is'hakun dhe Jakubin, birin e Jakubit, Jusufin... Po prej këtij gjaku zgjodhi Musain dhe Harunin... Daudin dhe djalin e tij Sulejmanin... Zekerian dhe djalin e tij Jahja... Gruan e

4. - **Sadaka Xharije:** Një vepër e mirë, e cila vazhdon edhe pas vdekjes së personit. P.sh. edukimi i brezave, mbjellja e një peme etj., prej të cilave do të kenë dobi njerëzit dhe krijesat e tjera edhe pas vdekjes së personit.

5. - **Mahsher:** Vendi (sheshi) ku do të mblidhen njerëzit në ditën e gjykimit, menjëherë pas ringjalljes.

Imranit dhe bijën e tij, Merjemën... për rrjedhojë edhe Isain (a.s)... Prej gjakut të djalit tjetër të Ibrahimit (a.s), Ismailit (a.s), zgjodhi Pejgamberin tonë, Muhamed Mustafanë (a.s)...

Në një ajet fisnik, urdhërohet: **“Pas atyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh!”** (Merjem, 59)

Pas Pejgamberit tonë (a.s), midis atyre që kanë mbajtur lart pishtarin e dijes dhe urtësisë, kanë qenë veçanërisht prej Ehlibejtit⁶...

Mund të themi se Allahu i Madhëruar edhe edukuesit e mësuesit më të mëdhenj të njerëzimit, pejgamberët, i ka ngarkuar me përgjegjësinë që të tregojnë përpjekje dhe sukses në radhë të parë në shtëpinë, familjen dhe gjakun e tyre.

Muhamedi (a.s), është një nga pejgamberët që e ka kuptuar dhe e ka realizuar në mënyrën më të bukur këtë përgjegjësi. Dhe me dritën e syrit të tij, Fatmën (r.a), Aliun (r.a), të cilin e rriti si djalin e vet... me skllavin e liruuar, të cilin e donte si djalin e vet, Zejd bin Harisen (r.a), djemtë, vajzat, fëmijët e birësuar, dhëndurët, nipërit dhe mbesat e tij, arriti të ndërtojë çerdhen familjare më të bukur në botë, duke na lënë shembullin më të mirë.

Gjithashtu, ai edukoi personalitete të lartë prej fëmijëve të sahabëve, si Usame bin Zejd, Abdullah Ibn-i Abbas, Abdullah Ibn Omer dhe Enes ibn Malik, radijallahu anhum. Ata u bënë uji i jetës së filizit të Islamit; dikush në sheshin e luftës, dikush në luginën e dijes e dikush tjetër në fushën e hadithit dhe fikhut.

[Fatkeqësisht, sot, rrugicat tona rënkojnë dhe vajtojnë shpirtërisht. Për fat të keq ato janë si gropa xhehenemi.]

Njëri prej tyre, Enesi (r.a), pati nderin t'i shërbente Pejgamberit tonë (a.s), që prej moshës 10- vjeçare:

Kur Resulullahu (a.s), e nderoi Medinën me ardhjen e tij, të gjithë ensarët⁷, burra e gra, i sollën atij dhurata të ndryshme. Mirëpo, Ummu Sulejme (r.a), nuk kishte asgjë për të dhënë dhe për këtë ndihej e mërzitur. Më vonë, erdhi tek Resulullahu (a.s), me djalin e saj Enesin për dore dhe tha:

“O Resulullah! A do të pranoni që Enesi t'ju shërbenete?” Dhe Pejgamberi (a.s), pranoi. (Semhudi, I, 271)

Është e qartë se një fëmijë dhjetëvjeçar nuk mund t'i shërbenete Resulullahut (a.s), në çështje të mëdha. Resulullahu (a.s), e mori Enesin nën edukimin e tij, duke dëshiruar t'i përçonte umetit islam kriteret e edukimit të fëmijëve. Për këtë arsye, e pranoi edhe lutjen e një nëne të sinqertë.

Për rrjedhojë, edhe Enesi (r.a), na ka përcjellë shembuj të bukur se si Pejgamberi (a.s), ua mësonte fëmijëve dhembshurinë dhe dashurinë. Gjithashtu, edhe cilësitë morale brenda kësaj dashurie, si drejtësinë, besnikërinë, dorëzimin dhe kënaqësinë e shpirtit.

[Mos vallë vendin e atij populli, që deri dje kujdesej edhe për jetimët e umetit së bashku me fëmijët e tij, do ta zënë prindër që i braktisin në rrugë edhe fëmijët e tyre?..]

Ja një shembull i tillë:

Enesi (r.a) tregon:

“...Një ditë, Resulullahu (a.s), më dërgoi diku. (...) Kur dola në rrugë, iu afrova disa fëmijëve që po luanin (dhe e humba kohën aty). Ndërkohë, Resulullahu (a.s), m'u afrova nga mbrapa dhe më vuri dorën në qafë. Kur u ktheva të shihja, ai po buzëqeshte. Pastaj më pyeti:

«O Enes! A shkove atje ku të thashë?»

«Po shkoj menjëherë o Resulullah!»- i thashë unë” (Muslim, Fedail, 54)

Pejgamberi (a.s), i jep një detyrë fëmijës, ndjek rezultatin dhe më në fund, siguron bindjen me anë të dashurisë. Ai i drejtohet me fjalë të ëmbla dhe butësi. Tregon interes për të, duke i vënë dorën në qafë, me qëllim që fëmija ta ndjejë përgjegjësinë dhe të zhvillojë dashurinë dhe besnikërinë.

[A thua vallë, vendin e djelmoshave që e kufizonin shikimin në majat e këmbëve dhe vajzave të zbukuruar me maturi dhe edukatë islame e të pajisura me mburojën fizike dhe shpirtërore të mbulesës; po e zënë një kategori njerëzish që mezi dallohen, a janë burra apo gra, të cilët zvarriten të përkushtuar vetëm pas qëllimeve të ulëta?..]

Enesi (r.a), tregon një tjetër kujtim:

“Një ditë, pasi i shërbeva Resulullahut (a.s), shkova tek fëmijët e tjerë me mendimin se: «Pejgamberi është në gjumin e drekës.». Kur isha duke shikuar lojën e tyre, Resulullahu (a.s), erdhi, përshëndeti fëmijët me selam dhe më pas më thirri për të më dërguar diku. Unë shkova, ndërsa Pejgamberi (a.s), u ul në një hije derisa u ktheva unë. Për këtë arsye u vonova të shkoja në shtëpi tek nëna ime. Kur shkova në shtëpi, nëna më pyeti:

«Përse u vonove?»

«I Dërguari i Allahut më dërgoi për një punë.»-ia ktheva unë.

«Çfarë pune?»- pyeti përsëri nëna.

«Ky është sekret i Resulullahut!»- thashë unë.

«Atëherë edhe ti ruaje mirë sekretin e Resulullahut!»- tha nëna.

[Sigurisht, çdo nënë e mbulon të voglin e saj që ka ftotë. Ajo dëshiron ta shohë atë të veshur me rrobat

6. **Ehl-i Bejt:** Pasardhësit e gjakut të Pejgamberit Muhamed (a.s).

7. **Ensar:** Epiteti i myslimanëve të Medinës, që do të thotë “ndihmës”, të cilin e kanë marrë pasi myslimanët e Mekës (muhaxhirët) emigruan në Medinë.

më të bukura. Mirëpo, një nënë me besimin në botën tjetër, mendon dhe shqetësohet më tepër se, a do ta mbështjellë fëmijën e saj me mëndafshin e xhenetit apo me zjarrin flakëruës të xhehenemit në botën tjetër.]

Sabiti (r.a), i cili e transmeton këtë hadith, thotë:

“Enesi (r.a), më tha: «Nëse do t’ia tregoja dikujt atë sekret, ai do të ishte ti o Sabit!»” (Ahmed, III, 195)

Në këtë ndodhi shihet se Pejgamberi (a.s), u afrohet fëmijëve me dashuri dhe i edukon ata me seriozitet.

[Zemra e njeriut që shërben në rrugën e Allahut, duhet të jetë si një tokë e begatë. Gjallesat që lëvizin mbi tokë ushqehen nga ajo dhe nxjerrin jashtë tepricën. Por toka e pastron të gjithë këtë papastërti dhe duke mbirë bimë të shumëllojshme, njëra më e bukur se tjetra, i ushqen të gjitha krijesat që lëvizin mbi të.]

ME DASHURI DHE SERIOZITET

Pejgamberi (a.s), ulej në nivelin e fëmijëve, përshëndetej me ta, u drejtohej atyre sikur të ishin të rritur, u jepte sekrete, duke i mësuar ata të mbanin sekret dhe ndikonte thellë në shpirtin e fëmijëve. Në një hadith fisnik, Resulullahu (a.s), ka thënë:

“Kush të ketë fëmijë le të bëhet fëmijë me të!” (Dejlemi, III, 153)

Mirëpo, ndërkohë që ulej në nivelin e fëmijës dhe bëhej fëmijë me fëmijët, ai e ruante distancën dhe masën e familjaritetit dhe kurrë nuk sillej në mënyrë të pakujdesshme. Në këtë mënyrë, ai tregonte se afrimi ndaj fëmijëve me maturi dhe seriozitet, nuk do të thotë të bëhesh i ashpër dhe i egër me ta; ndërsa afrimi ndaj tyre me dashuri dhe butësi, nuk nënkupton të silllesh në mënyrë të pakujdesshme dhe të humbësh seriozitetin me ta.

Veçanërisht sot, në sajë të botëkuptimeve ekstremisht liberale që vijnë nga perëndimi, prindërit i kanë “lëshuar” fëmijët e tyre në rrjedhën e frikshme të jetës me mendimin se ky është një “edukim i lirë me dashuri”. Prandaj, është e domosdoshme që këta prindër ta vendosin përsëri ekuilibrin e dashurisë dhe seriozitetit, duke e mësuar prej Pejgamberit tonë (a.s).

[Shfaqja më e bukur dhe më kuptimplote e dashurisë ndaj Pejgamberit (a.s), është ndjekja e gjurmëve të tij.

Në bazë të parimit “kush do dikë, do edhe gjithçka të tij”, ndjekja fizikisht (me vepra) dhe shpirtërisht e Pejgamberit (a.s), është një kusht i domosdoshëm.]

Pejgamberi (a.s), ishte i mbushur me dashuri për nipërit e tij të dashur Hasanin dhe Husejnin, aq sa i lejonte të lodronin edhe në shpinën e tij. Mirëpo, kur njëri prej tyre mori një nga hurmat që ishin dhënë sadaka, të cilën nuk duhej ta hante, Resulullahu (a.s), ndërhyri me seriozitet, duke ia nxjerrë nga goja.

Pejgamberi (a.s), nuk i linte fëmijët në qejf të tyre, por i afronte me butësi dhe i edukonte. Duke u martuar me Ummu Selemen (r.a), e cila kishte ngelur e ve, ai mori përsipër edhe edukimin e fëmijëve të saj. Një prej fëmijëve të adoptuar të Pejgamberit (a.s), Ebu Hafsi (r.a), tregon:

“Unë jam një fëmijë, i cili është rritur dhe edukuar nën mbrojtjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s). Kur haja ushqim, dora më shkonte në çdo anë të pjatës. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (a.s), më tha.

«Biri im! Bëj bismillah! Ha me dorën e djathtë! Ha gjithmonë para teje!»

Prej asaj dite, hëngra ash-tu siç më porositi ai. (Buhari, Et’ime 2-3; Muslim, Eshribe 108, Ibn Maxhe, Et’ime, 8)

Delikatesë në të folur...

Esencializmi në shprehje...

Forcë ndikimi...

Sukses në rezultat...

Pejgamberi (a.s), ua ka mësuar metodën e edukimit të fëmijëve edhe sahabëve të tij, duke u thënë:

“Qerasini fëmijët dhe edukojini mirë!”

(Ibn Maxhe, Edeb, 3)

[Disa nga amanetet e Pejgamberit tonë (a.s):

“Kini frikë Allahun në lidhje me ata që i keni nën vete; Kini frikë nga Allahu në lidhje me dy të dobët: Gruan e ve dhe fëmijën jetim.”]

Pejgamberi (a.s), ishte një mësues i jashtëzakonshëm. Në sajë të bisedave plot dashuri, këshillave plot urtësi dhe të një morali që buronte nga Kurani, ai arriti të edukojë në mënyrë të përsosur një brez të përbërë prej ensarëve dhe muhaxhirëve. Ky ishte një edukim i tillë, ndikimi i të cilit do të zgjasë deri në Ditën e Kiametit.



*Sot, në sajë
të botëkuptimeve
ekstremisht liberale që
vijnë nga perëndimi,
prindërit i kanë “lëshuar”
fëmijët e tyre në rrjedhën
e frikshme të jetës me
mendimin se ky është
një “edukim i lirë
me dashuri”.*



Salim Ibn Umejr

Salim Ibn Umejr, (r.a), ishte një person i dashur, që shqetësohej shumë po të rrinte larg Profetit tonë të Nderuar, (a.s)!...

Një hero trim, i cili nuk e honepste dot çifutin Ebu Afek dhe betohet se do ta vrasë atë ose do të vritet në këtë rrugë, sepse e shtriu armiqësinë e tij me poezi deri në ofendime!..

Ai u lind dhe u rrit në Medine. Jetoj si anëtar i degës *Bijtë Eshxha* nga fisi *Evs*.

U bë mysliman pa hezitim, kur Islami filloi të përhapej në Medine. U takua me të Dërguarin e Nderuar, (a.s), në Akabe dhe bëri bej'at (bëri

besatimin). (Isabe, III, 8-9. Usdu'l-gabe, II, 159)

Salim Ibn Umejri, (r.a), nuk donte të ndahej aspak nga i Dërguari i Nderuar, (a.s), për shkak të dashurisë që kishte për të.

Kur u ndërtua Xhamia e Profetit (Mesxhid-i Nebevi), ai qëndroi këtu. Mori pjesë tek nxënësit e *suffe-së*. Mori dije dhe njohuri nga Profeti i Nderuar, (a.s).

Ai ishte një luftëtar i vërtetë. Mori pjesë në të gjitha ekspeditat me Profetin tonë të Nderuar, (a.s).

Pas Luftës së Bedrit, Ebu Afek prej parisë çifute të Medines, kishte avancuar shumë në xhelozitë dhe armiqësi. Filloi ta fyente rëndë Profetin tonë të Nderuar, Diellin e dy Botëve.

Salim Ibn Umejri, (r.a), nuk e duroi dot këtë gradë armiqësie të Ebu Afek-ut. Zemra nuk ishte e kënaqur ndaj ofendimeve trashanike të tij. Në vetvete vendosi ta vrasë atë dhe një natë e vrau në oborrin e shtëpisë së tij.

Salim Ibn Umejri, (r.a), ishte një hero i këtillë guximtar dhe një sahabi sypatrembur.

Ai, krahas këtij heroizmi, kishte një zemër shumë të ndjeshme, sy të përplotur dhe zotëronte mëshirë e dhembshuri. U përmend midis shtatë sahabëve, që u cilësuan si "*Bekkain-Të përjetshmit*".



Ai ishte një luftëtar që qante me ngashërim, ngaqë nuk mori dot pjesë në luftën për hir të Allahut. Ishte një prej shtatë sahabëve që aplikuan te Profeti i Nderuar, (a.s), për kuaj (kafshë shalimi).

Dëshira e tij e sinqertë për të marrë pjesë në ekspeditë, përpjekja dhe sinqeriteti që tregoi për të dalë në xihad transmetohej si më poshtë:

“Në kohën e përgatitjeve për ekspeditën e Tebukut, sahabët, bashkë me Pejgamberin (a.s), u mbushën me një entuziazëm të fuqishëm në mobilizim, për të sakrifikuar veten e tyre në rrugë të Allahut.

Por shtatë persona prej të varfërve nga sahabët e nderuar, nuk kishin gjetur dot kuaj për të marrë pjesë në ekspeditë. Midis kafshëve që ishin në dispozicion, një ushtari apo tre ushtarëve u binte një deve. Këtyre u hipnin me radhë njëri pas tjetrit.

Këta sahabë, të cilët donin me gjithë zemër të qëndronin në çdo moment me të Dërguarin e Allahut, ia paraqitën gjendjen e tyre të Dërguarit të Allahut, duke ardhur tek ai për të gjetur një deve për të hipur qoftë edhe duke u alternuar.

Dielli i dy Botëve, Profeti i Nderuar në një gjendje të trishtueshme tha: *“Në këtë moment nuk kam asgjë në të cilën do të mund hipni ju, që t’ju jap.”* Sahabët, të cilët morën këtë përgjigje filluan të qanin. Këta lot që u derdhën në rrugë të Allahut, u pranuan prej Allahut dhe u bënë shkak për zbritjen e këtij ajeti madhështor: **“(Nuk ka gjynah) as për ata të cilët, kur vijnë te ti (O i Dërguar!) për të kërkuar kafshë shalimi e (ti) u thua: ‘Unë nuk mund t’ju siguroj kafshë shalimi’, kthehen me sytë e tyre që u rrjedhin lot, ngaqë nuk mundën të gjenin gjë për të dhënë (në rrugë të Allahut).”** (Tevbe, 92)

Kur po ktheheshin duke qarë, Abdurrahman ibn Ka’b dhe Abdullah ibn Mugaffel, të cilët ishin prej

njerëzve që merituan këto komplimente hyjnore, Ibn Jaim i pyet ata: “Përse qani ju?” Ndërsa ata të shqetësuar i treguan hallin e tyre, duke thënë:

“Ne kishim ardhur te i Dërguari i Allahut për të na siguruar kafshë shalimi. Me vete nuk kishte asgjë për të hipur mbi të. Ne, gjithashtu, nuk kishim asnjë kafshë shalimi që të hipnim dhe të dilnim në ekspeditë bashkë me të Dërguarin e Allahut!”

Ibn Jaim, (r.a), u jep atyre të dyve një deve dhe disa hurma për t’u ushqyer. Hazret-i Abbasi, (r.a), siguroi një kafshë shalimi për dy prej atyre që u kthyen me lot në sy; ndërsa Hazret-i Osmani, (r.a), për tre vetë.” (Ibn-i Hisham, IV, 172; Vakidi, III, 994)

Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s), më pas siguroi kafshë shalimi për disa prej nevojtarëve. (Buhari, Megazi, 78)

Këta sahabë, të cilëve u vinte zor të qëndronin në ndarë nga i Dërguari i Allahut, megjithëse ishin të liruar nga përgjegjësia për të shkuar në luftë, zemrat e tyre i kishin plot dashuri për Allahun e Madhëruar. (Usdu’l-gabe, II, 159. Istiab, II, 567)

Kjo ngjarje, në të cilën merr pjesë edhe Salim Ibn Umejri, (r.a), ishte një shenjë e dashurisë dhe e miqësisë që kishin sahabët e nderuar ndaj të Nderuarit të gjithësisë, Profetit tonë të dashur.

Salim Ibn Umejri, (r.a), u transferua në Kufe pas ndërrimit jetë të Profetit tonë të Nderuar, (a.s). Vdiq këtu në periudhën e kalifatit Hazreti Osman.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Allahu na mundësoftë të gjithëve të marrim prej dashurisë dhe miqësisë, prej trimërisë dhe heroizmit të tij.

Amin!



MIRËSIA E *Dashurisë*


Zejneb Allbajrak

Allahu i Lartësuar e ka krijuar këtë botë për njerëzit dhe e ka pajisur me begati që të kënaqet zemra e njeriut. E ka bërë atë superior ndaj qenieve të tjera, dhe na ka dhënë disa ndjenja të caktuara. Një prej ndjenjave më të rëndësishme është "*dashuria*". Buri mi i dashurisë është Allahu. Para se foshnjat të vijnë në jetë, Allahu vendos dashuri në zemrën e nënave të tyre. Kur foshnjat vijnë në jetë dhe rriten, edhe dashuria e nënave të tyre rritet. Nëse njerëzit nuk do të kishin dashuri në zemrat e tyre, nuk mund ta toleronin njëri-tjetrin. Dijetari i madh islam, Mevlana, në lidhje me dashurinë ka thënë këtë fjalë: "Ujrat e turbullta dhe të papastra, bëhen të pastra e të kulluara nga dashuria. Nga dashuria hallet zgjidhen. Nga dashuria ringjallen të vdekurit. Nga dashuria padishahët (*sulltanët*) bëhen shërbëtorë. Kjo dashuri është si rezultat i diturisë"

Dashuria e parë është dashuria dhe ndjenja e dashamirësisë për Allahun. Allahu është ai që e krijoi njeriun nga mosekzistenca, e mban gjallë, e përçon në pjekuri me krijimin e cilësive të përsosura, krijon

shkakun e pjekurisë dhe udhërrëfen përdorimin e këtyre shkaqeve. Personi që do atë që vjen nga dikush tjetër dhe atë (*prindin*) që e solli atë; pa dyshim që e do edhe Atë që e krijoi nga mosekzistenca, që e mban gjallë që ekziston nga zanafilla e deri në përjetësi dhe ka krijuar edhe të tjerët. Ai që nuk e do Atë, vjen nga injoranca për veten dhe për Zotin e tij. Dashuria është fryt i zgjuarsisë, prandaj vjen pas zgjuarsisë. Pa dituri (*njohje të Allahut*) nuk ka as dashuri. Allahu i Lartësuar na urdhëron kështu: "**...njerëz, që i do dhe që e duan (Atë); (e besojnë Atë) të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi (për shkak të besimit dhe Islamit)...**" (Maide, 54)

E dyta, është dashuria për Profetin tonë të nderuar. Dashuria për Profetin, (a.s), është një nga kushtet e Islamit dhe të besimit. Ai që beson ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut, beson edhe te profeti i fundit që dërgoi. Prandaj, çdo mysliman duhet të dëshmojë se Profeti është një i dërguar nga Allahu



dhe të vërtetojë të gjitha fjalët dhe veprat që vijnë prej tij. Dashuria për Profetin, (a.s), është një nga treguesit më të rëndësishëm të adhurimit. Sepse Profeti i dashur, (a.s), urdhëron kështu në hadithet Sherife të Buharit dhe Muslimit që transmeton Enes b. Malik, (r.a): *“Asnjë prej jush nuk ka besim-iman (të plotë), derisa unë të jem për të më i dashur se babai i tij, se fëmija i tij dhe se të gjithë njerëzit bashkë.”* (Buhari, Iman: 8; Muslimi, Iman, 69, 70)

Pa dyshim që njeriu është krijuar me një gjendje shpirtërore që ndjen dashuri kundrejt atij që i bën mirësi. Njeriu e do atë që i bën mirësi dhe ia kthen atij me dhurata. Nëse një person e do dikë dhe e bën këtë, atëherë si do të jetë qëndrimi ynë kundrejt Profetit tonë të nderuar që solli udhëzimin hyjnor për të gjitha botët, që është shkaku i mëshirës për gjithë njerëzimin, që ua mësoi njerëzve librin dhe urtësinë dhe që shpjegoi rrugën e arritjes së lumturisë së dynjasë (*kësaj bote*) dhe ahiretit (*botës tjetër*)? Për të arritur lumturinë e dynjasë dhe ahiretit, e gjithë frymëmarrja që harxhohet në rrugë të Islamit ka një qëllim; dhe ai është të fitosh dashurinë dhe kënaqësinë e Allahut. Mënyra e vetme është ndjekja e Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s).

E treta, është dashuria që kemi për prindërit tanë. Bamirësia ndaj prindërve dhe sjellja kundrejt tyre me respekt, zë një vend të veçantë në Islam. Ebu Hurejre, (r.a), ka thënë: “Një burrë, duke ardhur tek i Dërguari i Allahut, (a.s), i thotë: ‘Kush është ai kundrejt të cilit duhet të sillem mirë?’ I Dërguari i Allahut, (a.s), i thotë: ‘Nëna jote!’ Burri e pyet: ‘Po pas saj kush është?’ ‘Nëna jote!’ - iu përgjigj. Burri e pyet përsëri: ‘Kush vjen pas saj?’ ‘Nëna jote!’ - i thotë. Burri e pyet përsëri: ‘Kush vjen pas saj?’ ‘Babai yt!’ - i përgjigjet.” (Buhari, Edeb 2; Muslimi, Birr ,1)

Një nga kushtet e domosdoshme është që të vazhdojë në mënyrë të shëndetshme dhe të sigurt ky raport “e drejtë-detyrë”, që buron nga dashuria dhe respekti që krijoi Allahu midis prindërve dhe fëmijëve pa degjenerimin e llojit njerëzor. Allahu i Lartësuar na urdhëron kështu në Kuranin e Madhërisëm: **“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Prandaj, Ne i thamë atij: ‘Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu!’** (Lukman, 14)

Artikulli tonë le ta përfundojmë me një fjalë të Mevlanës: “Nëse dëshiron të fitosh një zemër, mbll farën e dashurisë. Nëse dëshiron të fitosh xhenetin, hiq dorë nga përhapja e gjembave në rrugë.”

Me dëshirën për të mos munguar gonxhet e dashurisë në zemrat tuaja...

REFLEKTIM MBI RIPËRTËRTIJEN IKBALISTE TË MENDIMIT ISLAM

(1887-1938)

Dr. Muhamed Mustafi

Shumë vite më herët rashë në kontakt me librin e Muhammed Ikbalit, që ishte përkthyer në Jugosllavinë e hershme nga origjinali në gjuhën angleze: 'Reconstruction of religious thought in Islam', dhe prej atëherë, shumë shpesh më interesonte të lexoja diçka prej tij dhe rreth tij, sepse kjo kohë është shumë e papërshtatshme për myslimanët e mbarë botës dhe ndihet nevoja për një lexim të ri frymëzues të teksteve të tij. Ai i ofroi myslimanit një opsjon që është i përshtatshëm në nivel ndërkombëtar dhe e frymëzoi me ide që të ndihet i pasur në mendime e qëndrime. Ky libër më ndihmoi që të shkruaj pak më tepër për atë dhe të organizoj një takim intelektualësh myslimanë nga Maqedonia për të kremtuar rastin e 116 vjetorit të lindjes së tij dhe më vonë, ligjëratat e tilla u botuan në gjuhën shqipe në një libër me titull: 'Mendimet filozofike dhe politike të Dr. Muhamed Ikbalit në vitin 1994'. Në këtë kohë të vështirë për myslimanët, mendoj se një reflektim mbi mendimet e tij do të freskojë mendimin tonë islam që të ballafaqohemi më lehtë me problemet aktuale në nivel ndërkombëtar. Në bazë të stilit të tij të shkrimit, u inspirova që edhe unë të përdor

të njëjtin sistem me fusnotat dhe të jem sa më afër shpirtit analitik të tij.

Ky artikull është një orvatje e një myslimani nga Maqedonia që merret me studime islame për të kuptuar rindërtimin e mendimeve të tij fetare mbi Islamin në bazë të mundësive të kufizuara, sepse fizikisht është larg vendlindjes së tij, por shumë afër tij në bazë të veprave dhe shkrimeve rreth tij...

Çdo lexues i veprave të Ikbalit, si në gjuhën angleze ashtu edhe në atë urde e arabe, konkludon se pas këtyre veprave fshihet ideja e Muhammed Ikbalit rreth ripërtëritjes së mendimit fetar islam, edhe atë duke e mbështetur në zhvillimet e kohës sonë moderne, si në shkencë ashtu edhe në filozofi.

Edhe pse jemi në prag të shekullit të ri, ai përsëri ngel një ndër ata të cilët e shqyrtojnë Islamin në frymën e filozofisë moderne.

S'ka dyshim se ekziston një numër i madh i mendimtarëve të mëdhenj myslimanë që formuan ide të ndryshme dhe doktrina të llojllojshme, mirëpo pa e shqyrtuar çështjen e ripërtëritjes së mendimit islam ashtu siç e shqyrtoi Muhammed Ikbali. Prej dijetarëve të tillë ishin Shejh Mustafa Sabri nga Pushteti Osman, Muhammed Kurd Ali nga Siria, Muhammed Abduhu dhe Reshid Rida nga Egjipti, Tabataba'i nga Irani, por sa i përket njohjes së gjerë të filozofisë perëndimore dhe shkencave të tjera, si fizika, psikologjia, gnoseologjia

NJERIU MUND TË SHTROJË EDHE SHUMË PYETJE TË TJERA, MIRËPO NE KËTU DO TË ORVATEMI TË ZHVILLOJMË VETËM NJË SHQYRTIM HYRËS QË DO TË PASQYROJË ROLIN E MENDIMIT TË TIJ ERUDITIV NË IDENË RIPËRTËRITËSE TË ISLAMIT.

dhe metafizika, mendoj se Muhamed Ikbali meriton një pozitë pak më të dalluar.

Nuk mohoj e as kundërshtoj faktin se myslimanët e kohës bashkëkohore ndjejnë nevojë të domosdoshme për një koncept ripërtëritës islamik, gjegjësisht të mësimëve islame.

Çdo njeri pa kurrfarë kompleksi mund të shtrojë pyetjen se a mund të rikomentohet Kurani apo forma e mendimit islam me ndonjë formë tjetër të kontekstit filozofik dhe shkencës moderne? Gjegjësisht, a arsyetohet një orvatje e tillë me Kuranin famëlartë dhe me hadithin e Muhamedit (a.s), përmes mendimeve filozofike me ata të inspiruara islame?

Natyrisht, njeriu mund të shtrojë edhe shumë pyetje të tjera, mirëpo ne këtu do të orvatemi të zhvillojmë vetëm një shqyrtim hyrës që do të pasqyrojë rolin e mendimit të tij eruditiv në idenë ripërtëritëse të Islamit.

Vetë termi "Kuran" nënkupton "Librin e lexuar" apo "Librin e përkryer", kurse leximit dhe studimit i është destinuar pozitë e lartë, gjë që nënkuptohet nga ajeti i parë i Kuranit "Ikre-Lexo".

Sipas aspektit kuranor, Muhamedi (a.s), është i Dërguar, mësues, i përulet Allahut të Madhëruar dhe gjithmonë e lut Atë t'i shtojë njohjen, diturinë dhe perceptimin e të vërtetave të gjërave, ngase vetëm në këtë mënyrë përkryhet autoriteti i njeriut, i shfrytëzon fuqitë natyrore dhe formon konceptione induktive.

Një qasje të tillë e hasim në shumë hadithe të Muhamedit (a.s).

Vlen të cekim të vërtetën se Islami është fe dinamike, ngase lejon zhvillimin e interpretimeve varësisht nga nevojat dhe kërkesat e jetës dhe atë nëpërmes "ixhtihadit" (zellit), që konsiderohet burim i tretë në sheriatin islam. Ixhtihadi (zelli), sipas Muhamed Ikbalit, paraqet parimin e lëvizjes në strukturën islame.

Në anën tjetër, mendimtarët myslimanë mund të shfrytëzojnë potencialin e tyre për induktimin e nocioneve të pazbuluara në tekstin kuranor dhe Kurani paraqet burimin më të lartë të njohjes së intelektit, ngase nëpërmjet Kuranit epifanohen principet themelore për myslimanët që pastaj të vazhdojnë zhvillimin dhe progresin shkencor, shoqëror dhe ekonomik.

Përveç Kuranit, po ashtu edhe Muhamedi (a.s), i nxiste shokët e vet t'i shfrytëzojnë kapacitetet e tyre shkencore për analizimin e problemeve të tyre delikate, si p.sh. dialogu i zhvilluar mes Muhamedit (a.s) dhe shokut të tij Mu'adhit. Kur e pyeti Muhamedi (a.s), atë se me çka do të gjykojë, ai së pari i përgjigjet se do të gjykojë me Kuranin, pastaj me hadithin dhe më në fund me mendjen e tij të shëndoshë, ndërsa Muhamedi (a.s), i përgjigjet: *"Falënderoj Allahun, i cili i udhëzon të dërguarit e të Dërguarit e tij..."*

Ikbali jo vetëm teorikisht, por edhe praktikisht është orvatur t'i interpretojë këto principe të lëvizjes së strukturës islame në bazë të filozofisë dhe shkencave moderne.

Në realitet, termi "filozofi" është derivuar nga gjuha Greke dhe nënkupton "dashurinë për dituri", "kurse dituria është gjëja e humbur e besimtarit, të cilën e merr aty ku e gjen".

Kur Villiam Xhejmsi e definoi dashurinë, thotë se ajo është orvatje për përsiatje të qartë dhe sistematike rreth çështjeve dhe bindjeve të posaçme që i preokupojnë intelektet tona e që janë të domosdoshme

për mendjen tonë, por shkencat ekzakte nuk flasin gjë rreth tyre.

Sipas Bertrand Rasellit, filozofia vlen në horizontet postshkencore, kurse sipas disa të tjerëve ajo (filozofia) është orvatje për harmonizimin e eksperiencave të jetës me rezultatet e shkencave ekzakte.

Edhe pse definicioni i parë është analitik kurse i dyti sintetik, përsëri vërejmë se nocioni i filozofisë është çështje teorike ose studim abstrakt, kurse urtësia është më e lartë dhe më e pastër se teoria abstrakte, ngase është koncepton teorik i gjithësisë, por edhe shkëndijë që pastron brendësinë si dhe sistematizon shpirtin, egon (unin) dhe përkatësinë shoqërore. Nga ky aspekt, kur flitet në Kuran për urtësinë, thuhet:

“Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhënë mirësi e madhe. Përveç të mençurve këtë nuk e kupton askush.” (Bekare, 269)

Mësimet e Kuranit aq shumë e nxisin njeriun të humtojë në çdo gjë, sa që Muhamed Ikbali, i nxitur nga ky aspekt, thotë se “lindja e Islamit, në realitet, është lindja e intelektit induktiv.” Vlen të cekim këtu se në Kuran termi “ajet” nënkupton ajete të Kuranit dhe fenomene natyrore, në mënyrë që natyra të konsiderohet si Kuran me formë tjetër dhe se çdo mysliman obligohet ta studiojë e humtojë.

Në realitet, Kurani gjithmonë i obligon myslimanët të përsiatin rreth të vërtetave të natyrës teorikisht dhe praktikisht, gjë që nuk i ngjan filozofisë teorike, që është në këtë aspekt larg urtësisë së vërtetë.

Njohja e përfutur në bazë të shqisave nuk shpie në humbje, por përkundrazi, konsiderohet begati e çmueshme nga Allahu i Madhëruar për robërit e Tij që t’i njohin të vërtetat e gjërave.

Nëse i hedhim një vështrim historisë islame, do të bindemi se Islami asnjëherë nuk ka qenë antishkencor, por ka luajtur rol pozitiv dhe nxitës në zhvillimin e tyre derisa e kanë arritur shkallën më të lartë.

Sipas Ikbalit, dijetarët evropian e kanë mësuar metodën empirike përmes burimeve islame e jo greke dhe atë duke u mbështetur në thënien e njohur të Brifos në veprën e tij “The Making of Humanity”: “Vlera arabe në shkencat tona nuk përmbidhet vetëm me zbulimet e mahnitshme të teorive që shkaktuan revolucion të ri në shkencë, por vetë shkenca i ka shumë borxh kulturës arabe, gjegjësisht ekzistencën e vetes.”

Filozofia te grekët ishte vetëm importim i sistematizuar në frymë greke dhe nuk kishin njohuri të detajuar empirike, kurse atë që e quajmë shkencë në Evropë ishte e panjohur për grekët antikë. Shpirti i shkencës

dhe këto metoda kanë hyrë në Evropë nga ana e arabëve. (Brife)

Kypasazh citohet në veprën e Ikbalit mbi ripërtëritjen e mendimit fetar.

Siç shihet, aspekti ripërtëritës i Muhamed Ikbalit arsyetohet edhe me Kuran, kurse tash erdhi koha të shohim nëse arsyetohet edhe me filozofi!

Principi kryesor i mendimit filozofik të Muhamed Ikbalit mbështetet në monoteizmin islam ngase sipas tij, e vërteta është një, por me forma dhe shkallë të ndryshme materiale, jetësore dhe racionale, kurse e vërteta më e vlefshme është ajo e egos (unit).

Sipas tij, mjetet e njohjes janë: perceptimi shqisor, gjykimi racional dhe zbulimi profetik dhe të gjitha këto mund të shfrytëzohen për njohjen e të vërtetës dhe fenomeneve të saj të ndryshme.

Islami nuk kërkon prej individit të largojë fenë, shkencën dhe filozofinë nga morali.

Pastaj, ai thotë se disa filozofë myslimanë janë orvatur ta sintetizojnë besimin e tyre me njohjen filozofike dhe me njohuritë shkencore, por gjithashtu ka pasur prej tyre të cilët, jo vetëm që nuk e kanë pëlqyer një besim të tillë sinkretik, por edhe e kanë sulmuar.

Ikbali e kuptonte shumë mirë se myslimanët e shekullit njëzet mund të jetojnë pa suksesin perëndimor në fushat e njohjes njerëzore dhe konkretisht për këtë shkak ai u orvat të komentojë Islamit në bazë të shkencës dhe filozofisë moderne, teorikisht dhe praktikisht.

Pas kthimit të tij nga Evropa e kuptoi se myslimanët ishin ende të prapambetur në çdo aspekt shkencor, si në atë ekonomik, politik, teknologjik, kulturor ashtu edhe në atë ideologjik, ngase fenë e kishin shndërruar në formë pa shpirt dhe në burim të përtacisë. Kështu, ata nuk kanë mundur t’u përballojnë zbulimeve perëndimore dhe i kanë importuar idetë dhe mendimet e tyre në forma të huaja. Pra, ky është faktori më i madh që ndikoi në zgjimin e myslimanëve në botë nga pavetëdija dhe ëndrra, të nxitë gjallërimin e një jete të re që të ripërfitojnë famën e tyre të lartë.

Dhe në fund cekim deklaratën e dijetarit pakistanez Aziz Ahmed në librin e tij “Reforma e re”:

“Njeriu nuk mund të largohet nga mendimi i Ikbalit pa e përjetuar kulturën e tij të gjerë; patjetër duhet të lexohen librat e Rumit, Niçes, Bergsonit, filozofisë greke, filozofisë islame, hinduse, moderne evropiane, si dhe të poezisë gjermane, angleze persiane, urde, arabe...”

Përveç kësaj, për ta kuptuar Ikbalin, ndihet nevoja për lexim dhe shfletim më të gjerë.”



ZEMRA QË NUK KUPTOJNË

Muhamed El-Gazall

Që thirrja jonë në Islam të jetë e suksesshme, duhet që kjo thirrje të ketë dy gjëra: Zgjuarsinë dhe pastërtinë, kam për qëllim, zgjuarsinë e mendjes dhe pastërtinë e zemrës.

Me zgjuarsi nuk kam për qëllim gjeniu e lartë, mjafton t'i shikojë gjërat ashtu siç janë, pa u hequr dhe pa u shtuar gjë.

Kam parë disa njerëz që nuk i fiksojnë të vërtetat. E shohin traditën adhurim, nafilen farz dhe formalen esencë. Nga kjo, u ngatërrohen ilaçet e punëve dhe thirrja goditet prej duarve të tyre me dështime të mëdha!

Ashtu, siç nuk kam për qëllim me pastërtinë e zemrës, dëlirësinë e engjëjve. Por, kërkoj zemër që do njerëzit dhe të dhembshur ndaj tyre, që nuk gëzohet me të metat e të tjerëve dhe nuk kënaqet me ndëshkimet e tyre, madje hidhërohet për gabimet që bëjnë dhe shpreson për ta të mirën.

Më erdhi një student universiteti e më lajmëroi se disa të devijuar duan të organizojnë një festë muzike dhe se ai dhe shokët e tij do ta ndalojnë me forcë këtë festë!

I thashë: "Jam dakord me ty për mosorganizimin e kësaj feste dhe përcillu atyre mendimin tim me këtë këshillë! Nuk ka vend për hare në ditët e mbushura me hidhërime rajonale e botërore! Si të këndojmë, ndërkohe që mijëra myslimanë ndodhen mes vrasjes, plagëve dhe pastrehës? Të plagosurit tanë në Palestinë dhe Afganistan pikojnë gjak dhe e ardhmja e Islamit atje është e zymtë. Lufta civile në Somali shton viktimat një qind herë, apo me qindra e mijëra të tjerë në luftën civile në Jugosllavi. Në Egjipt, akoma jemi afër periudhës së fatkeqësisë detare në Detin e Kuq dhe viktimave të përmbytjeve në Aleksandri. E atëherë, për çfarë të këndojmë? A i kanë zemrat prej guri?"

Studenti m'u përgjigj se atyre nuk u bëjnë dobi këto fjalë!

I thashë: "Pyeti me çfarë këndojnë? Me gazel të lehtë, tinguj të ulët? Ambientet artistike janë me shije dhe

perceptime të sëmura dhe prej tyre nuk dalin, veçse të këqija! Dhe është detyrë në ditët e fatkeqësive, të cilat na rrethojnë, t'i pastrojmë veshët prej fjalëve kote."

Studenti, përsëri m'u përgjigj: "Nuk do t'u them asgjë prej asaj që po më këshillon!"

Atyre do t'u them: 'Islami e ka bërë haram muzikën dhe do t'ua shkatërroj më festën e organizuar mbi kokat e tyre!'

I thashë: "Ti je i brishtë në fushën e thirrjes, prandaj përse nuk përfiton prej eksperiencave të atyre që kanë kaluar përpara teje? Islami ka dashakeqës që i rrinë gati, kështu që mos u jep argument prej keqkuptimit dhe sjelljeve tona të këqija!"

Ai refuzoi çdo gjë, përveç asaj që kishte në mendjen e tij dhe më në fund, kishte ndërhyrë policia dhe i kishte arrestuar disa prej tyre!

Akoma nuk ndalem së këshilluari myslimanë që të kujdesen për urtësinë në fushën e thirrjes dhe të mos i lejojnë dashakeqësit e Islamit t'i bëjnë keq, për shkak të entuziazmit mendjelehtë!

Le të jetë qëllimi i parë ndërtimi i akides, i moralit dhe i adhurimit, ndërsa ndryshimet juridike (fikhore) nuk kanë lidhje fare me fushën e thirrjes dhe as me rregullin e urdhrat për mirë dhe ndalimit nga e keqja!

Davudi dhe Sulejmani (a.s), nuk u grindën për shkak të çështjes së arës, në të cilën hynë bagëtitë dhe prej juristëve (fukahave) ka mendime se gjidhënia e të rriturit është si gjidhënia e të miturit! Le të ketë ndryshime dhe le të studiohen në fushat e tyre, ndërsa transferimi i tyre në fushën e thirrjes, ky është gabim i tepërt.

Thirrësi, i cili nuk bashkon mes zgjuarsisë dhe pastërtisë, shkakton probleme të ndërlikuara në përhapjen e Islamit. Në Kanada dhe Amerikë - ku Lidhja e Botës Islame më kishte dërguar atje - kam parë thirrës që kishin vendosur gurë në rrugën e thirrjes islame, të cilët i kishin transportuar prej mjediseve nga kishin ardhur, në mënyrë që të ndalej lëvizja e thirrjes në botën e re!

Ata zemërohen për medhhebet dhe epsheet e tyre në emër të zemërimit për Islamit. Allahu e di sa kanë nevojë për t'i ndriçuar mendjet dhe pastruar zemrat.

Përktheu nga arabishtja: **Lavdrim Hamja**

Ihsani

PËRMASA KULMORE E FESË



Dr. Selver Xhemalli

Omer ibn el-Hattabi përcjell ngjarjen në vijim: “Një herë, kur ishim bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s), erdhi një njeri me veshje shumë të bardha e flokë shumë të zinj. Në trupin e tij nuk dukej asnjë shenjë udhëtimi dhe asnjëri nga ne nuk e njhte. Pasi u ul përballë Pejgamberit (a.s), duke i mbështetur gjunjët përballë gjunjëve të tij dhe pasi ia vendoi duart mbi kofshët e tij me respekt, filloi t’i parashtronte pyetje, duke i thënë: O Muhamed, më informo për Islam-in-nënshtrimin ndaj Zotit?”

Ai u përgjigj: “Islam do të thotë që njeriu të dëshmojë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut Madhëriplotë dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij, të falë namaz, të dhurojë zekat, të agjërojë muajin e Ramazanit dhe ta vizitojë Qaben (ta kryejë haxhin), nëse ka mundësi dhe aftësi”.

Njeriu i panjohur i tha: “Ashtu është, të vërtetën the”. Ne u habitëm se si ai edhe pyeste edhe e vërtetonte përgjigjen. Pastaj përsëri e pyeti: “Tani më informo, më trego për imanin-besimin.”

Ndërsa ai u përgjigj në këtë mënyrë: “Iman-besim do të thotë që njeriu të besojë te Allahu Madhëriplotë, melekët e Tij, librat e Tij, pejgamberët e Tij, botën e ardhshme (ahiretin) dhe në përcaktimin e Tij të së mirës dhe të së keqes”. Burri i panjohur përsëri e vërtetoi përgjigjen e Pejgamberit (a.s), duke i thënë, të vërtetën the. Dhe vazhdoi me pyetjet, kësaj radhe i tha: “Më trego për Ihsanin-bërjen e mirësisë, të asaj që është e bukur, e mirë”.

I Dërguari i Allahut (a.s), iu shpjegua në këtë mënyrë: “Ihsan-bërja e së bukurës do të thotë që njeriu ta adhurojë Allahun sikur e sheh Atë, megjithëse njeriu nuk e shikon dot, Ai e shikon njeriun.” në fund të kësaj bisede, thotë Omer (r.a), i Dërguari i Allahut m’u drejtua mua dhe më tha: “O Omer, a e di se kush ishte ai që parashtronte pyetje?” Unë iu përgjigja: “Allahu dhe i Dërguari i tij e dinë më mirë.” Ai tha: “Ishte Xhebraili; erdhi për t’jua mësuar fenë tuaj”.

Në pikëpamjen islame feja përfshin tre elementë kryesorë, ashtu siç na jep një tablo të qartë hadithi i lartpërmendur, i njohur si hadithi i Xhebrailit, i paraqitur në formë të dialogut në mes tij dhe Muhamedit (a.s). Në përfundim të atij dialogu Muhamedi (a.s), u drejtohet shokëve të tij duke u thënë se ky ishte Xhebraili, erdhi për t’ua mësuar fenë.

Përmasa e parë e fesë islame është nënshtrimi ndaj vullnetit hyjnor, i cili përfshin një varg veprimtarish, si dëshmimi-shehadeti, falja, agjërimi, dhurimi i zekatit etj. Përmasa e dytë është besimi në Zotin, engjëjt, pejgamberët... Ndërsa përmasa e tretë është veprimi i Ihsanit, gjegjësisht bërja e asaj që është e bukur, estetike.

Sistemi metafizik i Islamit mundëson një kënaqësi, e cila formulohet në organizimin e brendshëm shpirtëror dhe përfaqësohet nëpërmjet një paraqitjeje logjikut të rrumbullakuar. E vërteta dhe e bukura gjithsesi duhet të jenë në marrëdhënie të nduarnduartë; në të gjitha

aspektet ku ato futen të ndara, që të dyja ngelin si vlera skeptike. Bukuria që me vete nuk e ka të vërtetën, gjegjësisht shpalljen, nuk ka guxim të thirret në të vërtetën, nuk do të jetonte në bazat dhe nga ndihma e saj, do të ishte një humnerë boshe. Pra feja është një rrugë e drejtë dhe korrekte. Nënshtrimi është përmasa e fesë për sa ka të bëjë me veprimet, besimi është përmasa e fesë për sa ka të bëjë me mendimet dhe bërja e së bukurës është elementë i fesë që ka të bëjë me synimet-qëllimet. Këto tri përmasa të fesë bashkohen në një realitet të vetëm, që njihet me emrin ISLAM.

Në këtë rast i Dërguari i Allahut ihsanin e shpjegon në këtë mënyrë: "Ta adhuroni Allahun sikur ta shikoni Atë, sepse nëse nuk e shikoni ju Atë, ju shikon Ai ju."

Ihsani vjen nga fjala *husn*, që tregon cilësinë e të qenit i mirë dhe i bukur. Fjalorët tregojnë se *Husn* nënkupton çdo cilësi pozitive (virtytin, mirësinë, bukurinë, pamjen e pëlqyeshme, hijeshinë, harmoninë, etj) *Ihsani* kërkon që njerëzit të jenë të vetëdijshëm për praninë e Zotit dhe të veprojnë në përputhje me këtë, por ai kërkon edhe që ata të mendojnë, ndjejnë dhe synojnë në mënyrë të përshtatshme. Nuk mjafton që aktiviteti i jash-tëm të jetë korrekt, por duhet që mendimet dhe qëndrimet e brendshme të puthiten saktësisht me veprimin e jashtëm. Nuk duhet të ketë kundërshti midis asaj që njerëzit mendojnë dhe asaj që bëjnë. Personaliteti njerëzor ka nevojë të jetë i harmonishëm, i baraspeshuar dhe i plotë, pa prirje dhe impulse që tërheqin në drejtime të gabuara.

Mesazhi kuranor nuk kufizohet veç me urdhëresa, ndalime dhe qëndrime teologjike. Përkundrazi, një nga mesazhet e tij parësore është që njerëzit duhet të njohin të bukurën e të bëjnë të bukurën. Kurani gjithashtu thekson se edhe njeriu Zotit e krijoi në formën më të bukur.

"Ai i ka krijuar qiejt dhe Tokën me të vërtetën, ju ka dhënë format tuaja dhe jua ka bërë ato të bukura; të gjithë tek Ai do të ktheheni." (Tegabun, 3)

Nëse Zotit bën atë që është e bukur nëpërmjet krijimit të qenieve njerëzore, njerëzit kanë detyrimin të bëjnë atë që është e bukur në marrëdhëniet e tyre me Zotin dhe me krijesat e tjera. Me fjalë të tjera, ata duhet të veprojnë në pajtim me fitren e tyre- natyrën fillestare

të njeriut që Zotit e vendosi brenda tyre:

"...Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty Allahu. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët." (Kasas, 77) **Pra bëni atë që është e bukur, ashtu si Zotit ka bërë për ju atë që është e bukur.**

"Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër!..." (Junus, 26)

Kurani i përshkruan gjithmonë si njerëz të mirë dhe të vlefshëm ata që bëjnë të bukurën. Ata kanë pjesë në cilësinë e *ihsanit* të Zotit, prandaj janë më pranë Atij e marrin pjesë në urtësinë dhe në mëshirën e Tij. Përdërisa bëjnë të bukurën, ata janë edhe vetë të bukur. Pra nuk është për t'u habitur që në pesë nga të gjashtëmbëdhjetë vargjet-ajetet kuranore, ku thuhet se Zotit i do njerëzit, ata përshkruhen si *muhsin* (veprues të së

bukurës) ndërsa në njëmbëdhjetë ajetet e tjera u jepen cilësi të tjera të mira e të bukura.

"Bëni atë që është e bukur. Zotit i do ata që bëjnë të bukurën." (Bekare, 195) **"Kush është besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, të cilin Allahu e ka marrë për mik të ngushtë?"** (Nisa, 125)

Një tregues i rëndësisë së *husnit* në botëkuptimin islam është fakti se dy nipërit e Pejgamberit (a.s), quheshin Hasan dhe Husejn (i bukur).

Muhamedi (a.s), vendosjen e vlerave të shpallura nuk e ka bërë mbi shkatërrimin, tiraninë dhe parregullsinë. Shembulli më i mirë për këtë është çlirimi i Mekes dhe sjellja e Pejgamberit (a.s), me banorët e këtij qyteti. Është tejet e rëndësishme që të bëhet dallim mes porosisë universale islame dhe disa pasqyrimeve tradicionale dhe lokale. Imperativet kuranore për mirësjelljen, drejtësinë, sinqeritetin, faljen dhe mëshirën, veprat e mira, parapëlqimin e drejtësisë dhe durimit, paqen, kanë ndikuar që myslimanët të jenë më të suksesshëm në situata paqësore sesa luftarake, sepse në periudhën e paqes mënjanohej pengesat që inkuadrohen në mesin e përfaqësimit të Islamit dhe arsyes; emocionet dhe urrejtja ia lënë vendin vetëdijes dhe mençurisë. Ndjekja e traditës profetike nuk duhet kuptuar vetëm si formë e ngurrte dhe norma të palëvizshme, përkundrazi si një ngjarje e cila është e hapur për ripasqyrim dhe e bart

Nënshtrimi është përmasa e fesë për sa ka të bëjë me veprimet, besimi është përmasa e fesë për sa ka të bëjë me mendimet dhe bërja e së bukurës është elementë i fesë që ka të bëjë me synimet-qëllimet. Këto tri përmasa të fesë bashkohen në një realitet të vetëm, që njihet me emrin ISLAM.

në praktikë frymën dhe bërthamën kuranore.

Në Islam etika është e pandashme prej fesë dhe është plotësisht e mbështetur në të. Ai me të drejtë ka pohuar se njeriu, në të vërtetë, është një homo religious, një qenie vetëdija e së cilës gjithnjë punon rreth një prezence boshtore të hyjnisë. Islami nuk e konsideron botën si të huaj për drejtësinë apo lumturinë fetare. Në vetvete, bota nuk mund të mohohet e të luftohet. Përkundrazi, ajo është e pafajshme dhe e mirë, e krijuar enkas për t'u përdorur e shfrytëzuar nga ana e njeriut. E keqja nuk qëndron tek ajo, por te shpërdorimi i saj nga ana e njeriut. E liga që meriton të mohohet e të luftohet është përdorimi i pamoralshëm i botës. Pejgamberi (a.s), i ka porositur shokët e tij t'i largohen stërzgjatjes së ritualeve të adhurimit (namazit), beqarisë, agjërimit të tepruar, pesimizmit dhe gjendjes së zyrtë shpirtërore. I ka urdhëruar që të prishin agjërimit para faljes së namazit të akshamit, që trupin dhe dhëmbët e tyre t'i mbajnë të pastër, që të stolisen e parfumohen, si dhe të veshin rrobat më të mira që kanë kur tubohen për namaz, të martohen, të ndajnë kohë për pushim e fjetje dhe të argëtohen me sporte e arte të ndryshme. Natyrisht, Islami i porositi ithtarët e tij që t'i zhvillojnë zotësitë e tyre, ta kuptojnë vetveten, natyrën dhe botën ku jetojnë. E gjithë kjo, sa është histori është edhe kulturë. Ta bësh historinë, ta krijosh kulturën dhe këto t'i bësh ashtu si e lyp puna, krejt këto përbëjnë atë që përmban vullneti hyjnor. Kjo është virtutshmëria. Në të vërtetë, Islami çdo veprim të aftë për t'i shtuar diçka sado të vogël vlerës së përgjithshme të kozmosit e konsideron si akt adhurimi, akt shërbimi ndaj Zotit, me kusht që të kryhet për hir të Zotit. Pra të përmbajë nënshtrimin, besimin dhe ndjenjën estetike apo qëllimin e pastër.

Për këtë arsye, myslimani nuk ndjen ndonjë shqetësim për trupin e tij apo për kënaqjen e instinkteve. Si një besimtar i ndërgjegjshëm, këto kënaqje për të janë një "shije" e gëzimeve të Parajsës që do të pasojnë në qoftë se ai vazhdon ta kryejë detyrën e tij ndaj Zotit. Kurani në mënyrë retorike pyet: **"Kush i ka ndaluar stolitë e Allahut dhe ushqimet e mira, të cilat Ai i ka bërë për robërit e Vet?"**, dhe me theks të veçantë përgjigjet: **"Ato janë në këtë botë për ata që besuan,**

e në Ditën e Kiametit janë të posaçme për ta". Kurani në mënyrë të përsëritur urdhëron: **"Hani e pini, por mos e teproni!"**. Kjo nënkupton qartë punën me nder, suksesin dhe arritjen në transformimin e natyrës. Kurani thekson se Zoti e ka krijuar botën për njeriun dhe se gjithë çfarë është e krijuar i nënshtrohet përdorimit dhe shfrytëzimit të njeriut.

Mirëpo njeriu, i cili guximshëm e ka pranuar amanetin, ka aftësinë ta përbushë ose jo vullnetin e Zotit. Prandaj, në mesin e të gjitha krijesave, vetëm ai i gëzon parakushtet, gjegjësisht lirinë për *veprim moral*. Për shkak të kësaj dhurate, njeriu qëndron më lart se melekët, sepse ai mund të bëjë më tepër se ata. Ai mund të veprojë moralisht, respektivisht lirisht, gjë që ata s'mund ta bëjnë. Njeriu si qenie fizike e ndan në mënyrë të barabartë nevojën e shkaktueshmërisë natyrore në

jetën e tij bimore dhe shtazore si një gjësend ndër gjësendet e tjera në tokë. Mirëpo, si qenie përmes së cilës mund të realizohet pjesa më e lartë e vullnetit të Zotit, ai absolutisht mbetet i pashoq.

Çdo njeri, sipas mësimeve të Islamit, është *mukel-lef* (i ngarkuar) me realizimin e vullnetit të Zotit. Prandaj Islami, jo vetëm që të gjithë njerëzit i shpall përgjegjës, por në mënyrë të prerë e mohon çdo mendim që pohon *jo-teklifin* (papërgjegjësinë) e një qenieje që nuk është as fëmijë e as mendërisht e sëmure. Ai kërkon që çdo njeri ta bartë barrën e vet personale me një vetëdije të plotë, ndërsa ndarjen e respektit e bën në përpjesëtim me

realizimin e përgjegjësisë nga ana e tij. Kjo rrjedh nga natyra e *amanetit*, besueshmërisë që Zoti ia ka dhuruar njeriut. Vetëm njeriun e ka krijuar ndryshe, duke ia dhuruar lirinë për zbatimin apo shkeljen e vullnetit të Zotit dhe kësisoj, duke ia mundësuar të jetë përgjegjës për veprat e veta. Kjo përgjegjësi ka karakter qenësor për jetën morale, sepse në mungesë të saj asnjë vepër nuk do të kishte vlerë morale, andaj edhe pjesa më e madhe dhe më e lartë e vullnetit të Zotit nuk do të mund të realizohej. Realizimi universal i vlerës nga ana e shoqërisë islame duhet të bëhet me përgjegjësinë më të madhe ndaj Zotit të madhërishtëm, me nënshtrim të thellë, me besim të paluhatshëm si dhe me *ihsan* të plotë, nëse dëshiron që ajo të bartë karakter moral.

Por sigurisht që mbjelljen apo ngjizjen e vetëdijes



së përgjegjesisë te njeriu, gjegjësisht kultivimin e ndjenjës për të menduar, vepruar dhe për të shfaqur sjellje të bukura e bën edukata (edeb). Siç dihet fjala edeb përdoret për njerëzit me sjellje dhe karakter të mirë, për veprimtaritë estetike, për njeriun e kulturuar, për shprehjen e arteve të bukura, prandaj dhe vetë letërsia në disa gjuhë që flasin myslimanët është quajtur edebijat, pra një angazhim estetik. Ose edhe e kundërta, një ndër shprehjet më të rënda për njerëzit e pamoralshëm, të paturpshëm (qofshin edhe të ditur) është përdorimi i shprehjes “pa edeb” (pa edukatë). Rolin e edukatës në ndërtimin e karakterit të besimtarit deri në shkallën e ihsanit, ndoshta më së bukur na e ilustron tregimi në vazhdim:

Në kohërat e lashta, në një debat në prani të vetë kalifit, janë kontestuar filozofët dhe ulemaja rreth asaj çka do të dominojë në qenien njerëzore, në ndërtimin e personalitetit të tij gjegjësisht vetëdijësimin e tij. Natyra apo arsimitimi, trashëgimia fisnore apo edukimi, gjaku në damarë apo djersa në bankat shkollore.

Filozofët pohonin se në qenien e njeriut do të dominojë arsimitimi kundrejt natyrës. Gjatë gjithë shqyrtimit ata konsideronin se arsimitimi e kultivon karakterin dhe natyrën njerëzore dhe qëndron mbi natyrën e pastër njerëzore.

Ulemaja, sërish, nga ana tjetër pohonte se te njeriu, pas arsimitimi megjithatë dominon epshi, karakteri dhe natyra, veçan në kohën e të këqijave, luftës, rrëmujës e intrigave. Natyra është gjithnjë e sidomos atëherë, më e fuqishme kundrejt arsimit të pastër, thjesht sepse natyra është ajo e brendshme, ajo e pandryshueshmja, “ajo andej”, ajo që është në gjak!

Ulemaja në këtë ka pohuar se arsimitimi është një, kurse edukimi është krejtësisht një gjë tjetër. Vetëm edukimi i mirë, krahas arsimit të themeltë, mund të jetë pendë e mirë që qetëson rrebeshet e natyrës së vërtetë.

Kalifi i dëgjoi me kujdes këto dy grupe dhe pastaj kërkoi që palët kontestuese t'i shtrojnë dëshmitë. Natën vijuese, filozofët që të dëshmojnë se arsimitimi është më i rëndësishëm se natyra sollën një mace, të cilën paraprakisht e mësuan, d.m.th. e kanë dresuar, që, duke u shërbyer me këmbët e para, t'i ndajë filxhanët e çajit në ndejë. Dhe, me të vërtetë, macja ua

ndau apo serviri pijen e tyre të dashur pjesëmarrësve të këtij debati!

Dukej se në këtë debat ulemaja që mposhtur krejtësisht.

Por, ndonëse kjo e magjepsi ulemanë, ana e tyre kërkoi nga kalifi që të shihen edhe natën vijuese dhe që macja sërish të dëftojë atë që filozofët e kanë mësuar.

Dhe pikërisht, kur macja i ndante filxhanët e çajit, ulemaja nga xhepat e xhybeve të veta i lëshuan disa minj.

Macja po atë çast e hodhi filxhanin e çajit dhe nxitoi në zënien e minjve.

Edhe pse njeriu është i ndryshëm nga macja, she mbujt e përditshëm na tregojnë se njeriu, pa edeb, pa edukatë, pa formimin e vetëdijes

së përgjegjesisë, pa ndjenjën e ihsanit, kur ballafaqohet me interesin e vet personal anashkalon amanetin, tradhton përgjegjësinë.

Për ta përmbledhur këtë diskutim të shkurtër, mjafton të themi që theksi kuranor mbi mirësinë e bukurinë si cilësi hyjnore e si cilësi të dëshirueshme njerëzore ka inkurajuar zhvillimin e një larmie formash arti ndër myslimanët. Myslimanët gjatë së kaluarës kanë qenë mjaft të ndjeshëm ndaj përmasës së tretë të Islamit, pra ihsanit, për të pranuar që bukuria formale është po aq e rëndësishme dhe thelbësore për jetën, sa edhe bukuria e karakterit, veprimi, dhe unit.

Qeniet njerëzore janë vendosur në këtë botë për të zhvilluar vetveten në harmoni me frymën/mesazhin hyjnor dhe për të arritur kështu afërsi me Zotin. Kjo afërsi e dëshiruar ka standarde në çdo nivel. Veprimtaria-aktiviteti duhet të jetë në përputhje me rregullat juridike të fesë, të kuptuarit duhet harmonizuar me shkencat e besimit dhe personaliteti i besimtarit, gjegjësisht karakteri i tij, ka nevojë të formohet nga veprimi i asaj që është e bukur-ihsan, sinqeriteti-ihlas, dhe vëmendja ndaj Zotit-takva.

Dhe krejtësisht në fund po e mbyllim me lutjen të cilën i Dërguari i Allahut e kishte zakon të bënte:

O Zot, Ti ma ke bërë trupin të bukur, ndaj bëma të bukur edhe karakterin tim.

*Qeniet njerëzore
janë vendosur
në këtë botë
për të zhvilluar
vetveten në harmoni
me frymën/mesazhin
hyjnor dhe për të
arritur kështu afërsi
me Zotin.*

Ritual i çeljes

Edison Çeraç

Ndoshta domethënia më kyçe në poezinë e Rumiut dhe të Tagorës është se na kultivojnë prirjen e qenësishme për të bujtë te temat e mëdha, e si rrjedhojë për të lënë ato mijëra vogëlsira e çikërrima në të cilat biem kaq shpesh në përditshmërinë tonë, ku secila syresh përbën një pengesë që vështirëson komunikimin e domosdoshëm që duhet të ndërmarrim herë pas here me vetveten. Që këtej, këto janë pengesa edhe për meditimin, pasi ky i fundit, zakonisht, është rrjedhojë e komunikimit me vetveten.

E meqë ra fjala, le të kujtomë këtu se qenësia me të cilën ndajmë më pak kohë është pikërisht vetja. Kështu, një nga shtysat më të vërteta – domethënë, më të qëndrueshme – që mund të na përmendë për të qëndruar më shumë me veten është poezia, sidomos poezia.

Bradley thotë se një nga ndikimet e poezisë do të duhej të ishte ky: të na krijonte përshtypjen se po na kujton diçka të harruar, dhe jo të na zbulojë një gjë të re. Duke lexuar një poezi të bukur ne mendojmë se edhe ne mund ta kishim shkruar; se kjo poezi ka paraekzistuar tek ne. Kjo na shpie te përkufizimi që jep Platoni për poezinë: "kjo gjë e lehtë, flatrore dhe e shenjtë". (Borges, 2013)

Rumiut dhe Tagora i blatojnë lavde Asaj që mund t'i përbashkojë e t'i qetojë të gjithë, pavarësisht se jo të gjithë mund të trokasin te kjo Portë, dhe kjo ndarje mbetet mister.

Në fakt, Rumiut, fjala vjen, ka dhënë edhe propozimin e tij se çfarë duhet thënë dhe si duhet të përgjigjemi pasi të kemi trokitur: jam Ti! është përgjigjja e duhur kumton Rumiut. Kjo është përgjigjja për ekzistencën sipas tij, për të cilën janë derdhur e vazhdojnë të derdhen

dete me bojë shkrimi. Kjo është përgjigjja besore për zanafillën dhe fundin, të cilat janë përpirë nga honi i harresës kolektive sot, që edhe kur kujtohen me raste, shfaqen krejt të tërrnuara, si subjekte të një religjioni të ri, që quhet shkencë, ose si subjekte rrëfimesh të letrarizuara, të zhveshura me gjithsej nga domethënia e tyre burimore.

Por, në një mënyrë apo në një tjetër, ato qenësojnë me heshtjen e tyre pafundfjalëshe përherë diku rrotull nesh, qoftë edhe të mbështjella apo të shënuara me një pakuptimësi të radhës, qoftë edhe të reduktuara në një nivel poshtë nesh, për të na lënë kësisoj një shteg të mundshëm daljeje.

Ja pse poetët janë rojtarë të shtëpisë së qenies, siç i quante Heidegger-i. Ata mbeten përkujtuesit tonë në mënyrën e tyre të destinuar të tërthortë, por po aq edhe të drejtpërdrejtë për ata shpirta që ia kanë dalë të mos njollosen deri në tjetërsim nga shtresat e njëpasnjëshme të procesit të alfabetizimit (i gjuhës dhe i imazhit), se për të mbetur e qenësuar qelibar nuk është e mundur, jo për ndonjë arsye kushedi çfarë, por sepse kjo thjesht nuk është njerëzore.

Thuhet se arsyeja e lindjes së prozës si zhanër i letërsisë, ishte pakënaqësia në rritje e masave për shkak të moskuptimit të poezisë. Edhe sot e kësaj dite, e me sa duket kështu do jetë përherë, librat me poezi mbeten librat më me pak vëmendje, më pak të shitur, saqë përbëjnë një siklet të madh të cilit synon t'i shmanget pothuajse çdo botues. Me pak fjalë, poezia është lexuar dhe lexohet nga një rreth fare i ngushtë njerëzish, të cilët ia dinë vlerën.

Çështja është se pjesa dërrmuese e gjindjes e duan t'ua thuash gjatë, e duan të përpunuar esencën, se

përndryshe i zë, e sa të rrezikojnë najfarë dalldisjeje apo edhe të alivanosen, zgjedhin (me nuhatje, jo me vetëdije) të mos e përdorin fare këtë aromë.

Sot, në kohën kur shpërdorimi i fjalës ka marrë përmasa rrëqethëse, të denja për një përrallë a legjendë, leximi i poezisë është edhe më i nevojshëm; sepse poezia e ruan fjalën duke mbajtur të fshehur magjinë e saj, larg duarve që duan ta gjejnë e ta prishin.

Ky shpërdorim është edhe pasojë e një prej kurtheve më jetëgjatë në të cilin kanë ranë pafund njerëz, kurth që u pagëzua si "liria e fjalës".

Statusi i fjalës është ontologjik, sepse përmes fjalës ne lidhëm besën se nuk do harrohem (lexo: tjetërsohem) gjatë këtij udhëtimit që po bëjmë.

Pse Rumi dhe Tagora?

Për hir të së vërtetës, nuk ka se si të ketë një përgjigje të qartë e fikse se pse kam zgjedhur që këta dy poetë t'i bëj bashkë në një vëllim.

Në pamje të parë ata janë shumë të ndryshëm nga njëri-tjetrit: Rumi ka jetuar në shekullin e XIII, kurse Tagora në të XX; Rumi është nga Balkhi, që sot është pjesë e Afganistanit, ndërsa Tagora është nga India; Rumi është musliman¹, kurse Tagora i përket një besimi tradicional në vendin e tij; Rumi jetoi në kohën e perandorive, kurse Tagora në kohën e kombeve e kështu me radhë. Por, siç e thamë, ky është një lexim sipërfaqësor, që ka vlerë vetëm sa për t'u kujtuar në trajtë të dhënash për arsye të caktuara.

Duke qenë se poezia është një botë tek e cila trokas shpesh, dy ndër poetët që kanë lënë gjurmët e tyre tek unë janë edhe Rumi me Tagorën. Ndikimi ka qenë i tillë, sa që më ka shtyrë që ato përjetime që kam marrë nga vargjet e tyre t'i ndaj edhe me të tjerët me anë të përkthimit. Përkthimi në këtë rast ka qenë zgjatim i përjetimit që provoja kur i lexoja.

Tekembramja, e thënë me pak fjalë, letërsia është një nga ato "gjëra" që pasi e ke ndarë me veten, priresh ta ndash edhe me tjetrin.

Një tjetër gjë që dua të përmend është se këta dy poetë kanë aq shumë vargje e strofa të ngjashme, sa që po të mos jetë emri i autorit në fund e ke të vështirë të thuash se e cilit është. Ky nuk është gjë tjetër vetëm se një ndër ato shumë raste që provon se poetët e

1. Sigurisht që jo në kuptimin që kanë sot shumica e muslimanëve për veten dhe shumë e shumë të tjerë për muslimanët, kuptim i cili e redukton Islamin gati në një besëtytni, ose në një sekt. Ndërsa Rumi është një nga përfaqësuesit më të spikatur të botëkuptimit burimor islam mbi njeriun dhe jetën: një tërësi e gjerë me një numër të pafund dëshyrash ("Ka aq shumë rrugë drejt Zotit, sa çka shpirtit mbi tokë", shkruan Rumi) që i fton njerëzit për të ruajtur të qenurit njeri, duke zgjedhur derën që i përshtatet secilit, dhe kjo është e mundur kur njeriu i nënshtrohet me vullnet të lirë thjesht (thjeshtësi dhe vërtetësi njëherësh) Zotit dhe askujt tjetër, të Cilin Rumi e identifikon herë pas here me Dashurinë.

shuajnë etjen nga i njëjti Burim, dhe përveç thelbit të përbashkët, – për të shkruar poezinë e përkryer ose për t'i blatur mirënjohje Burimit – qëllon të jenë gati të njëjtë edhe në formë, gjë që ka ndodhur e ndodh edhe me poetë të tjerë.

Ja se si blaton Rumi:

*vetëm Ti
Ty të zgjedha në botën mbarë
vallë, a është e drejtë për Ty
të pakënaqur të më lësh?
e imja zemër, si një penë është në dorën tënde
çdo gjë varet nga Ti
të shkruash lumturinë a pikëllimin për mua
shoh vetëm atë që Ti ke zbuluar
e jetoj siç Ti thua
t'gjitha ndjenjat e mia kanë atë ngjyrë
që Ti ke dashur të pikturosh*

Ja dhe Tagora:

*t'pafund më ke bërë
ky është vullneti Yt
këtë t'brishtë vazo
vazhdueshëm ti e boshatis
vazhdueshëm e mbush
gjithherë me jetë të re*

Diku tjetër:

*s'e di si këndon Ti!
gjithnjë të dëgjoj
në qetësi i magjepsur
drita e tëndes muzikë
ndrit botën
shushurima e tëndes muzikë
shëtit nxitimthi nga qielli në qiell
vala e shenjtë e tëndes muzikë
shpërthen midis të gurtave ngrehina
e rrëmbyeshëm nxiton përpara*

Jam i mendimit se do ishte e tepërt nëse do orvatesha për të gjetur të përbashkëtat mes këtyre dy poetëve, e më pas t'i rendisja këtu në formë sasiore, sepse besoj se është gjithmonë e vyer sa më s'ka t'i bësh bashkë zërat e poetëve; natyrisht në letër, sepse si qenie, kur ata janë gjallë, është vetëm manipulim, – cilido qoftë qëllimi dhe cilado qoftë forma se si grupohen – që më së pari godet vetë artin e tyre. Kjo ngaqë zbulësia/frymëzimi vjen në vetmi, atëherë kur je mënjanë çdokujt e çdo gjëje.

Çdo lexues kujdesplotë dhe i vetëdijshëm për epërsinë e poezisë, do jetë në gjendje ta gjejë vetë përgjigjen se pse kuvendojnë në këtë vëllim pikërisht Rumi dhe Tagora.

Edhe po nuk u gjet, nuk ka gajle.

Rëndësia e edukimit të hershëm të fëmijës

Nuredin Nazarko



Shoqëria njerëzore në ditët e sotme është duke përjetuar një zhvillim dhe ecuri, gati të pandalshme në bastisjen e vlerave që sendërtojnë personalitetin dinjitoz dhe të qëndrueshëm të njeriut. Kjo, sepse në një botë ku gjithmonë e më tepër, jo vetëm që i mëshohet anës materiale, por edhe ndihmohet me të gjithë logjistikën e mundëshme, vlerat etiko-morale janë bërë gjithmonë e më tepër të huaja për njeriun e ditëve të sotme. *Kap momentin! Jetë çastin! E nesërmja ndoshta nuk vjen! Një herë jetojmë! Shijo jetën në maksimum!* Këto janë, jo thjesht fraza të lëshura nga gjuha dhe buzët e teenager-ve. Këto janë fraza që nuk artikulojnë dëshirat e një moshe të caktuar.

Artikulimi i vazhdueshëm i tyre, madje të ndihmuara dhe nga forca e propagandës së vazhdueshme, është shenjues i një fryme, shenjues i një filozofie, shenjues i një këndvështrimi mbi mënyrën e të jetësuarit të jetës. Këto janë fraza që i dëgjon nga gjithësa që të jetuarit mbi dhe në botë, e vështrojnë nëpërmjet optikës, *këtu dhe tani*. E artikuluar jo vetëm nga teenager-it, kjo mënyrë e të vështruarit të të jetuarit është bashkëjetuese e asaj mase njerëzish që e kanë transplantuar tek pasardhësit e tyre dhe më gjerësisht tek masa e shoqërisë.

Fëmija vjen në botë në një mjedis të caktuar. Zhvillohet dhe rritet po ashtu në një mjedis të caktuar. Kohën dhe vendin ku zhvillohet e rritet një fëmijë, nuk mund ta përcaktojmë ne. E në qoftë se ne nuk mund ta përcaktojmë këtë, atëherë çfarë mund të bëjmë ne, për të rritur fëmijë të edukuar? A duhet të dorëzohemi pa kushte ndaj trysnisë së modelit sundues të shoqërisë dhe ta lëmë edukimin e fëmijës të rrjedhë "natyralisht" sipas këtij modeli? Të edukosh një fëmijë nuk është aspak e lehtë, por as mision i pamundur, sepse njeriut nuk i kërkohet të realizojë atë që është e pamundur.

Pra, sot jemi përballë një sfide tepër të madhe, sfidë që është e mbushur me atë çfarë po na sfidon dhe na

duhet të sfidojmë për të sendërtuar një bazament, prej nga ku do të harliset shtati etiko-moral i fëmijës. Shumë syresh, duke bashkëjetuar ethshëm me filozofinë *këtu dhe tani*, ose nuk vramenden aspak, ose vramenden tepër pak mbi edukimin e fëmijës së tyre. Ata që nuk vramenden aspak, janë ata që besojnë se rrjedha e lirë e jetës do t'i nxjerrë në bregun e duhur fëmijët e tyre, të cilët në mos herët, vonë do ta kuptojnë së çfarë duhet të bëjnë me jetët e tyre. Ata që vramenden paksa mbi edukimin e fëmijëve të tyre, përpiqen të transmetojnë disa vlera të caktuara, por të ndërthurura edhe me karakteristika bashkëkohore.

Kjo tentativë për të vendosur në të njëjtin binar, këtu dhe tani me vlerat etiko-morale, nuk siguron aspak bazamentin që kërkohet për sendërtimin e personalitetit të njeriut, sepse është një tentativë që kërkon të përbashkojë dy gjëra krejt të kundërta nën forcën e diktatit, pa e kuptuar aspak se kështu mund të deformatojë dhe përcudnojë personalitetin e filizit të ri.

Kësisoj, duket qartë që shumë syresh e nënvleftësojnë rolin prindëror në edukimin e fëmijës ose e redukojnë thjesht dhe vetëm në përmbushjen e kushteve materiale, që fëmija të mos ketë kokëçarje në përbalimin e sfidës ekonomike të jetës, edhe pse kjo, jo gjithmonë është e mundur.

Ky perceptim mbi rolin që luan prindi në edukimin e fëmijës është shenjues i shterjes së kuptimësisë mbi atë se çfarë është edukimi. Para se prindi të punojë për edukimin e fëmijës së tij, duhet t'i shtrojë vetes pyetjen se çfarë është në të vërtetë edukimi. Shtrimi i kësaj pyetje është i nevojshëm dhe i domosdoshëm të kryhet, jo vetëm nga prindërit, por nga të gjithë aktorët e tjerë që interferojnë fuqishëm në edukimin e fëmijës gjatë zhvillimit dhe rritjes së tij.

Pa u dhënë përgjigjen reale kësaj pyetje dhe pa e kuptuar realisht se ç'është edukimi, gjasat për të pasur sukses në edukimin e fëmijës shuhën drejt zeros, në mos edhe më keq. Kuptimi mbi atë se çfarë është në të vërtetë edukimi është thelbësor për ndërtimin e një modeli paraprak, që do ta ndihmojë fëmijën për

t'i kumtuar, jo thjesht me sofizma, ç'është edukimi. Pa-kuptimësia apo keqkuptimi i edukimit, rrjedhimisht çon edhe në ndërtime platformash edukimi jashtë rendit natyror të gjërave. Nuk kemi pse të çuditemi më pas, në rast se shohim të qarkullojnë në atmosferën e zhvillimeve elementë të çorbituar, pasi që asgjë nuk ndodh rastësisht. Prej këndeje kuptojmë se sa e rëndësishme është të qenit vetë i edukuar më së pari, në mënyrë që të jesh një kontribues potencial në edukimin e pasardhësve. Në rast se mungon modeli paraprak, i ndërtuar mbi kuptimësinë reale të edukimit, atëherë nuk do të mungojë modeli i përkundërt i tij në jetën e fëmijës. Kjo do të ishte dhe pikënisja e lëvizjes jo në anën e duhur të filizit të ri, që nesër do të jetë model referimi për filiza të tjerë, në familjen e tij apo dhe më gjerë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm, që duhet çmuar dhe vlerësuar me seriozitetin e duhur, është edhe të kush-tuarit vëmendje maksimale edukimit të fëmijës qysh në vitet e para të jetës, veçanërisht në shtatë vitet e para të jetës së tij. Herët është thënë: *"Më jepni fëmijën tuaj deri në moshën shtatë vjeçare dhe do të jetë i imi për gjithë jetën."* Kjo tregon se sa e rëndësishme është mburjtja e fëmijës me edukatë qysh në vogëlinë e në shtatë vitet e para të jetës.

Shumë prindër kujtohen se kanë një fëmijë për të edukuar, kur fëmija i tyre hyn në moshën e adoleshencës dhe jo pak prej tyre çuditen se si fëmija po del nga binarët nën hundën e tyre. Në fakt, përgjegjës për këtë gjendje nuk mund të jetë thjesht hapësira dhe koha, por përgjegjës është pikërisht prindi që në vitet e para të jetës së fëmijës, ka munguar me modelin e tij etiko-moral (*gjithmonë nëse kemi një prind të këtij modeli*) dhe në këtë zbrazëti të krijuar nga tërheqja e prindit, zë vend modeli edukues që frymon nga modeli sundues i shoqërisë.

Prej këndeje, duke marrë në konsideratë edhe natyrën e pastër me të cilën vjen fëmija në jetë, mund të themi se është më se i drejtë konkluzioni se nuk ka fëmijë të këqinj, por ka fëmijë të edukuar keq. Për këtë nuk është përgjegjëse shoqëria dhe as institucionet e saj, pavarësisht se platformat e tyre të të edukuarit bazohen thjesht në sofizma, por përgjegjës direkt është prindi, i cili është farkëtuesi i parë dhe më i rëndësishëm i filizit të ardhshëm.

Një aspekt tjetër po kaq i rëndësishëm, që ndikon në angazhimin e prindit për edukimin e fëmijës, është edhe perceptimi mbi çështjen, nëse njeriu *lind apo bëhet*. Natyrisht që kur flitet për njeriun, asnjëherë nuk mund të ketë receta apo lëvizje skematike që çojnë në deduksione të përcaktuara. Një pjesë besojnë se njeriu lind dhe rrjedhimisht nuk kemi çfarë të bëjmë më pas

për edukimin e tij, përderisa ka lindur për të mos qënë i edukuar. Ky është justifikimi i shumë prindërve, që para se të kapitullojnë për edukimin e fëmijëve të tyre, kanë kapitulluar në edukimin ndaj vetes. Një pjesë mendojnë se njeriu nuk lind, por bëhet.

Rrjedhimisht, këta prindër mendojnë se fëmija i tyre mund të edukohet për të qenë njeri në çdo stad moshor, pasi që ai mund të bëhet i tillë nga ndikimi i mjedisit social ku rritet dhe kështu anashkalojnë rëndësinë e modelit prindëror në jetën e fëmijës. Një pjesë tjetër besojnë se njeriu edhe lind edhe bëhet.

Atë çfarë lind nuk mund ta përcaktojmë ne, por ne mund të punojmë me pjesën që bëhet, me pjesën që mund të farkëtohet dhe kjo është një nga misionet më të rëndësishme të prindit. Duhet të mbajmë parasysh, dhe kjo është shumë e rëndësishme, se njeriu lind si qenie njerëzore dhe rrjedhimisht përgjatë ekzistencës, pra përgjatë asaj që mund të bëhet, tek ai do të hedhë shtat pjesa që do të ushqehet, ashtu sikundërse na kumton ky proverb i vjetër.

"Një plak i vjetër Cherokee është duke mësuar nipin e tij mbi jetën. Një luftë vazhdon brenda meje-, i tha djalit. Është një luftim i tmerrshëm dhe është midis dy ujqërve. Njëri është i keqi- ai është zemërimi, zilia dhe lakmia, dëshpërimi, keqardhja, babëzia, arroganca, keqardhja ndaj vetes, faji, fyerja, inferioriteti, gënjeshttrat, krenaria false, të konsideruarit veten superior dhe egoizmi. Tjetri është i mirë – ai është gëzimi, paqja, dashuria, shpresa, paqja dhe qetësia, përvulësia, ëmbëlsia, dashamirësia, shpirtmadhësia e vërteta, dhembshuria dhe mëshira, dhe besimi. I njëjti luftim do të vazhdojë brenda teje – dhe brenda çdo personi tjetër gjithashtu. Nipi u mendua rreth tij për një minutë dhe pastaj e pyeti gjyshin e tij, Cili ujk do të fitojë? I vjetri Cherokee thjeshtësisht iu përgjigj, Ai që ti ushqen."

Edhe pse fatkeqësisht shumë prindër pikërisht këtë moshë e lënë pothuajse jashtë vëmendjes, me arsye-timin se është i vogël dhe s'ka çfarë të mësojë. Kjo pavëmendshmëri është shkatërruese për fëmijën, pasi që është një *tabula rasa* dhe në rast se nuk shenjohej nga parimet etiko-morale, do të shenjohej nga të kundërtat e tyre. Rrjedhimisht, ajo çfarë do të ndërtohet më pas, do të jetë thjesht zgjatim i asaj që është shenjuar

Ne nuk mund të ndryshojmë hapësirën apo kohën në të cilën jetojmë, por ne kemi detyrimin për të punuar që, qoftë ne më së pari, dhe fëmijët tanë të edukohen për t'u ushqyer me parimet etiko-morale, në mënyrë që jeta të jetohet denjësisht, ashtu siç i takon ta jetojë jetën një qenie njerëzore.

NUK KA UDHËZIM PA PEJGAMBERË

Idris Arpat

Për të arritur tek e vërteta, njerëzit zakonisht ndjekin dy rrugë. Ose lidhen me filozofë që pretendojnë se zgjidhin gjithçka vetëm me mendje, ose ndjekin pejgamberët që ka dërguar Allahu, të cilët janë udhërrëfyes që ndjekin udhëzimet e Zotit.

Sado që mendja është një mjet mjaft me rëndësi për të arritur tek e vërteta, të ndjekësh atë duke anashkaluar shpalljen hyjnore, sipas Imam Rabbanit, nuk është tjetër veçse devijim. Veçanërisht në ditët e sotme, kur mendja është idhujtarizuar dhe ka mbërritur deri aty sa të përshtaten tekstet fetare sipas mendjes, *Letra* e Imam Rabbanit përbën një rëndësi të veçantë. Imam Rabbani fillon *Letrën* e tij, duke kujtuar rëndësinë që kanë për njerëzimin pejgamberët: "Pejgamberët janë mëshirë për botët.

Allahu i Lartmadhëruar, për krijesat si ne, të mangët në arsyetim dhe me kufizime të caktuara gjykimi, përmes njerëzve të tillë të lartë, e ka bërë të ditur origjinalitetin (dhati) dhe cilësitë (sifat) e Tij. Kështu, Ai na i ka bërë të ditura thellësitë e gjykimit që kanë origjinaliteti dhe cilësitë e Zotit. Sërish, po këta njerëz të mëdhenj na kanë lajmëruar se cilat janë ato vepra që pëlqen Zoti dhe cilat janë ato që nuk i pëlqen Ai. Na kanë dhënë mundësinë të marrim përfitimet tona të kësaj bote dhe të tjetrës, si dhe na kanë mësuar se si të shpëtojmë nga dëmet.

Sikur të mos ishin këto personalitete, mendja njerëzore do të ishte e pafuqishme të perceptonte ekzistencën e Allahut e as që do të kuptonte përsosmërinë e Tij. Vetëm për këtë arsye, filozofët grekë që e shikonin veten si shumë të mençur, kanë refuzuar ekzistencën e Allahut, ndaj dhe ndryshimin që ndodh në gjithësi e kanë lidhur me kohën." (III, 23)

Imam Rabbani mendon se edhe ata filozofë që pretendojnë se kanë arritur tek e vërteta vetëm përmes arsytimit, këtë nuk e kanë bërë siç thonë ata përmes arsytimit, por duke shfrytëzuar dritën e pejgamberëve. Sidoqoftë, këta filozofë nuk i kanë lënë në pjesën e natyrshme të tyre ato



çfarë kanë marrë nga peygamberët, por i kanë përzier me dëshirat dhe egon e tyre: Si përfundim, pa pasur ndërmjetësimin e peygamberëve mendja është një mjet i mangët për të arritur të perceptojë origjinalitetin dhe cilësitë e Allahut.

Atëherë kur u përhap kumtesa që kanë bërë peygamberët për ekzistencën e Allahut, njerëzit e çdo epoke të dhënë pas epshit, kur panë që ftesat e tyre po pranohen, u detyruan të praninin ekzistencën e Allahut, si dhe krijimin e gjërave ia adresuan Allahut. Ky është një nur i marrë nga pishtari i peygamberëve, i cili do të ndizet deri në pafundësi. Ndërkaq edhe cilësitë e Allahut, dërgimi i peygamberëve, pafajshmëria e engjëjve, ringjallja, xheneti – xhehenemi, dhuntia e përhershme apo dënimi i përhershëm etj., janë të vërtetat që përcillen tek ne përmes kumtesës së peygamberëve. Mendja është e paaftë të perceptojë në mënyrë të pavarur ekzistencën e Zotit.

Një njeri që e sheh mendjen si burimi i vetëm i diturisë dhe nuk pranon asnjë mjet tjetër dijeje përveç saj, në fakt ka mohuar institucionin e profetësisë dhe u ka shpallur luftë të vërtetave të qarta. Imami, duke treguar se shumica e filozofëve grekë nuk kanë arritur tek e vërteta, shprehet kështu: "Sikur mendja të mjaftonte e vetme, atëherë filozofët grekë që kanë pranuar një gjë të tillë, nuk do të binin në greminën e devijimit dhe do ta njihnin Allahun më parë se të gjithë.

Mirëpo, ata janë njerëzit më injorantë lidhur me njohjen e origjinalitetit dhe cilësive të Allahut. Pasi ata mendojnë se Allahu po pret në një vend të zbrazët dhe pretendojnë se vetëm diçka del prej tyre dhe kjo gjë nuk del nga vullneti i Allahut dhe që do të realizohet në mënyrë të domosdoshme.

Filozofët kanë imagjinuar diçka me emrin "akli faal" (intelekti aktiv) dhe kanë menduar se gjithçka bazohet te kjo. Kështu, nuk ia kanë adresuar Allahut ngjarjet në gjithësi, si krijuesi i qiejve dhe tokës, pra nuk ia kanë dedikuar veprën mjeshtrit të vërtetë, por diçkaje të tillë imagjinare. Sipas tyre, përfundimi, është përfundimi i shkakut të afërm. Shkaku i të qenit larg nuk ka asnjëfarë ndikimi. Për arsye të

inJORANCËS SË TYRE, TË QENIT DIÇKA "E ALLAHUT", kanë menduar se është pjesë e përsosmërisë së Allahut dhe të qenit Allahu "i zbrazët" është një lartësim për Allahun.

Ndërkohë Zoti i Madhëruar në Kuranin Famëlartë lavdëron veten duke thënë: "Zoti i Tokëve dhe Qiejve dhe Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit!" Ata, sipas filozofisë së tyre, nuk kanë nevojë për Allahun dhe as që të mbështeten tek Ai. Kështu, kur gjenden në vështirësi, i referohen *intelektit aktiv* dhe kërkojnë prej tij atë çfarë u duhet. Mirëpo, sipas besimit të tyre, për arsye se është i domosdoshëm veprimi i *intelektit aktiv*, nuk duhet ta kërkojnë as prej tij."

Imami, së dyti, kritikon edhe ata që i besojnë vetëm zbulimit hyjnor (keshf) dhe frymëzimit hyjnor (ilham). Sado që ai është një sufi, nuk ruhet që të mos paraqesë gabimet që bëjnë sufitë. Aq sa mendja nuk mund të jetë mjet i mjaftueshëm që njeriu të arrijë tek e vërteta, pa ndihmën e profetëve; as *rijazeti* me *myxhahede*-në nuk mund të jenë si mjete të mjaftueshme për të mbërritur tek Allahu.

Imami këtë gjendje e shpreh kështu: "Një grup ngakëta filozofë në fjalë, kanë zgjedhur rrugën e *rijazeti*-it dhe *myxhahede*-së, ata nuk kanë pranuar si udhërrëfyes peygamberët, por sufitë që gjenden në çdo shekull. Këta njerëz, kanë pranuar si masë për gjendjet e tjera, zbulimet hyjnore (keshif) imagjinare duke u mashtruar pas ëndrrave dhe imagjinatave, sipas thjeshtësisë së gjendjes së tyre. Gjendja e qetë dhe e paqtë që përshkruajnë ata, në fakt është vetëm një gjendje e nefsit, që e shpie njeriun në devijim."

Si përfundim, çdo mjet që bëhet shkak për të arritur tek Zoti, qoftë zemra dhe qoftë mendja, ka nevojë për udhëzimin e peygamberëve dhe mbikëqyrjen e tyre. Ata që përjashtojnë ata njerëz të lartë, çfarëdolloj metode që të përdorin, qoftë atë të tasavvufit apo të filozofisë, nuk mund të arrijnë tek e vërteta.

Lutja që i bëjmë Zotit, është që të na udhëzojë në rrugë të vërtetë bashkë me mendjen dhe zemrën tonë brenda kontureve të Sunetit profetik dhe të na mbrojë nga teprimi. Amin!

Kur u përhap kumtesa që kanë bërë peygamberët për ekzistencën e Allahut, njerëzit e çdo epoke të dhënë pas epshit, kur panë që ftesat e tyre po pranohen, u detyruan të praninin ekzistencën e Allahut, si dhe krijimin e gjërave ia adresuan Allahut.



NEVOJA E NJERËZIMIT PËR *traditën profetike*

Muslimani beson se Allahu i Madhëruar ka zgjedhur nga mesi i njerëzve profetë, të cilëve u ka shpallur ligjin e Tij hyjnor, me qëllim që njerëzit të mos kenë justifikim përpara Zotit në Ditën e Kiametit. Allahu i ka pajisur profetët me argumente të qarta dhe me mrekulli të ndryshme.

Allahu i Madhëruar është Zoti i çdo gjëje, Krijuesi dhe Komanduesi i tyre. Ai është i Gjithëmëshirshëm. Pikërisht këto attribute hyjnore e bëjnë të domosdoshme ardhjen e të Dërguarve të Zotit, në mënyrë që njerëzit të njohin Zotin e tyre dhe të udhëzohen drejt lumturive në të dy botët. Allahu i Madhëruar i ka krijuar të gjitha krijesat me qëllim që ata të adhurojnë vetëm Atë. Allahu (xh.sh), thotë: **"Nuk i kam krijuar xhindët dhe njerëzit për gjë tjetër, përveçse të më adhurojnë mua."** (Dhariaj, 56). Allahu i madhëruar i ka dërguar pejgamberët me qëllim që ata t'u mësojnë njerëzve si ta adhurojnë Zotin e tyre dhe t'i binden Atij.

Meqë njeriu është një qenie e dobët dhe mund të bjerë lehtë në gabime, Zoti, me bujarinë e Tij, e ka mbështetur atë me anë të profetëve. Pasi ia ka bërë të qarta njeriut kufijtë e përgjegjesisë me anë të librave dhe të profetëve, duke mos përjashtuar nga ky favor asnjë popull, Zoti e ka shpallur njeriun përgjegjës për veprat e tij. Allahu (xh.sh), thotë: **"Çdo popull Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): 'Adhuroni Allahun dhe qëndroni larg idhujve!'"** (Nahl, 36)

Thelbi i shpalljeve që u bëheshin profetëve, ishte adhurimi i Zotit të Vetëm ashtu siç e meritonte. Ai të adhurohej dhe këshillimi i njerëzve për të kryer vepra të mira gjatë gjithë jetës.

Shpërblimi dhe dënimi janë rezultatet e bindjes dhe rebelimit në shpirt ndaj urdhrave të Zotit, pasi i pari e

purifikon zemrën, ndërsa i dyti e fëlliq atë. Ardhja e të dërguarve të Zotit dhe e pejgamberëve, synon që njerëzit të mos kenë arsye të thonë në Ditën e Kiametit: "Zoti ynë! Ne nuk dinim se si të bindeshim Ty dhe nuk i dinim gjërat e ndaluara prej Teje, se po t'i dinim, nuk do t'i kryenim ato." Në këtë rast, ata do të kishin një justifikim përpara Allahut të Madhëruar. Ky fakt e bën të domosdoshëm dërgimin e profetëve, në mënyrë që gjynahqarët të mos kenë pretekst për t'u justifikuar për gabimet dhe gjynahet e tyre. Allahu (xh.sh), thotë: **"Të Dërguarit japin sihariqe dhe paralajmërojnë, në mënyrë që njerëzit të mos kenë me se të justifikohen para Allahut. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm."** (Nisa, 165)

Njerëzit kanë nevojë për profetët dhe të dërguarit e Zotit, sepse vetëm ata ua ndriçojnë rrugën drejt Zotit dhe mirësisë. Ata i udhëzojnë njerëzit të mos devijojnë nga feja e tyre e vërtetë, u mësojnë njerëzve gjëra të cilat i kanë të pamundura t'i dinë vetëm me anë të intelektit, siç janë për shembull ekzistenca e xhenetit dhe e xhehenemit. Profetët dhe të dërguarit kanë ardhur si përgjësuesit e xhenetit për ata që i binden Zotit dhe paralajmëruarit e xhehenemit për ata që refuzojnë mësimet e Zotit. Profetët dhe të dërguarit e Zotit janë mësuesit e njerëzve në të gjitha aspektet dhe modelet më të mira që duhen ndjekur prej tyre.

Ibn Tejmije Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Dërgimi i pejgamberëve është domosdoshmëri, në mënyrë që njerëzit të jenë të lumtur në këtë jetë dhe në botën e ardhshme. Njeriu nuk ka shpëtim në botën tjetër, në qoftë se nuk pason shembullin e Pejgamberit në këtë botë."

Shpallja e Allahut është dritë mbi tokën, drejtësia



ideale për njerëzit dhe kështjella më e sigurt ku mund të strehohet njeriu. Njëri nga synimet e dërgimit të profetëve është kumti fetar (teblig). Po të mos kishin ardhur profetë, njeriu nuk do të mund të dinte gjë në lidhje me çështjet e adhurimit, të urdhrave dhe ndalimeve fetare dhe nuk do të mund të konceptonte kufijtë e vërtetë të përgjegjësisë. Ç'është namazi, agjërimi, zeqati, haxhi? Pse janë të ndaluara pijet alkoolike, kumari, fajdeja etj.? Të gjitha këto dhe shumë çështje të tjera të ngjashme me to, njeriu i ka mësuar me anë të profetëve. Pejgamberët janë urat lidhëse mes Allahut dhe krijesave, janë komunikuesit e urdhrave të Allahut dhe ndalesave të Tij, ambasadorët e Allahut për robërit e Tij.

Njeriu është krijuar nga një Zot i vetëm, kështu që ai patjetër duhet ta njohë Krijuesin e tij, duhet ta dijë se çfarë kërkon Krijuesi prej tij dhe pse e ka krijuar atë. Njeriu e ka të pamundur t'i njohë këto të vërteta pa pasur pejgamberë dhe të dërguar, të cilët u kanë mësuar njerëzve udhëzimin dhe dritën e vërtetë.

Njeriu përbëhet nga trupi dhe shpirti. Ushqimi i trupit është ngrënia dhe pirja, kurse ushqimi i shpirtit është njohja e Krijuesit, tek i Cili beson sinqerisht dhe kryerja e veprave të mira. Të gjithë të Dërguarit e Zotit kanë shpallur besimin e vërtetë dhe i kanë udhëzuar njerëzit për të kryer vepra të mira. Njeriu ka nevojë të gjejë rrugën e cila i mundëson atij fitimin e pëlqimit të Allahut në këtë botë dhe hyrjen në xhenet, ku do të kënaqet me begatitë që i ka përgatitur Allahu aty. Këtë rrugë njeriu nuk mund ta gjejë, përveç me anë të pejgamberëve dhe të dërguarve.

Njeriu është i dobët dhe ka shumë armiq, prej të cilëve më të rrezikshmit janë shejtani, i cili dëshiron ta shmangë njeriun nga rruga e drejtë, shoku i cili ia paraqet si gjëra normale dhe të pranueshme veprimet e këqija dhe egoja e prirë për keq (nepsul emare).

Për këtë arsye, ai ka nevojë ta ruajë veten nga kurthet e armiqtë të tij. Pejgamberët dhe të dërguarit e Zotit i kanë treguar njeriut rrugën se si të mbrohet nga të gjithë armiqtë e tij.

Njeriu i duhet patjetër një shariat (ligj) për rrethin dhe shoqërinë ku jeton, në mënyrë që situatat e paqarta të gjykohen me drejtësi, përndryshe jeta e tij do të bëhet shumë e vështirë. Ky shariat, për të cilin njerëzit kanë nevojë, duhet patjetër t'ia japë secilit person të drejtën që i takon pa bërë asnjë lloj padrejtësie. Nuk ka mundësi që ndokush tjetër përveç pejgamberëve dhe të dërguarve të sjellë një shariat kaq preciz.

Njeriu ka nevojë të realizojë gjërat me anë të cilave ai arrin qetësinë, sigurinë dhe rehatinë dhe të udhëzohet drejt rrugës së lumturisë së vërtetë. Për këtë kanë ardhur edhe pejgamberët dhe të dërguarit e Zotit.

TEKNOLOGJIA DHE VIRUSI HIV

Diagnostikimi i infeksioneve si virusi HIV, kërkojnë prova klinike të shtrenjta, duke i bërë procedurat shumë të kushtueshme për shumë pacientë të varfër apo për ata që jetojnë në zona rurale. Por një teknologji e re mund t'i bëjë testimet më të qasshme për shumë njerëz.

Telefonat inteligjentë janë si kompjuterë që futen në xhepa, të aftë për të luajtur shumë programe të komplikuar – që nga lojërat e deri tek ndihma mjekësore.

Aplikime të tjera i shtojnë edhe më shumë këto mundësi të telefonave sot.

Shkencëtarët në universitetin Kolumbia në Nju Jork kanë zhvilluar një pajisje që kur lidhet në telefon, e kthen atë në një mjet për të diagnostikuar sëmundje infektive si Hiv apo sifilizi.

Sam Sia ndihmës profesor për inxhinierinë biomjekësore në universitetin Kolumbia thotë se diagnostikimi i hershëm mund të jetë çështje jete apo vdekje për pacientët si për shembull për gratë shtatzëna në pjesë rurale të Afrikës.

“...Duke përdorur diagnostikim më të lehtë për këta pacientë, ata mund të trajtohen, foshnjat e tyre mund të lindin dhe të jetojnë normal. Pra nuk është më çështje jetë a vdekje nëse i kanë këto mjete diagnostikimi.”

Për 10 një ekip shkencëtarësh punuan për të zhvilluar një pajisje që ata thonë se mund të kryej prova laboratorike si ato të pajisjeve që kushtojnë 18 mijë dollar.

“Në vend që të marrin gjak dhe ta dërgojnë në laborator, ata mund ta bëjnë testimin këtu dhe ta marrësh përgjigjen për 15 minuta me një cilësi të ngjashme me ato të testeve në laborator.”

Testimi i një numri të vogël pacientësh në Ruanda dha rezultate me saktësi të lartë. Ndjeshmëria në gjetjen e antitropave ishte 92 deri në 100 përqind, ndërsa përjashtimi i njerëzve të pa infektuar ishte 79 deri në 100 përqind i saktë.

Kjo nuk do të jetë e kufizuar vetëm për sëmundjet seksualisht të transmetueshme por edhe për sëmundje të tjera si hepatitis malarja dhe sëmundje të tjera kronike.

Shkencëtarët po përgatiten tani për një prove klinike në shkallë të gjerë që kërkohet për miratimin e pajisjes nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.


PËRDORIMI I MAGNETIT PËR TË HEQUR QELIZAT KANCEROZE

Shkenca mjekësore ka mësuar deri tani disa mënyra të ndryshme për të vrarë qelizat kanceroze në trupin e njeriut. Por shumë herë këto metoda janë treguar shumë jo-preçisjoze, duke dëmtuar organe të tjera të trupit, dhe duke dëmtuar gjithashtu qeliza të shëndetshme.

Prandaj shkenca ka shtyrë që të gjenden metoda të ndryshme për të hequr qelizat kanceroze pa dëmtuar shëndetin e pacientit. Dhe duket sikur hulumtuesit ja

kanë arritur qëllimit. Disa shkencëtarë nga Korea e Jugut kanë gjetur një mënyrë për të përdorur magnetat për të hequr qelizat kanceroze.

Ideja që këta shkencëtarë kanë prezantuar është shumë e thjeshtë: ata prezantuan në trup nanopjesëza prej hekur oksidi. Hekur oksidi i bashkangjitet automatikisht antitropave, të cilat më pas u bashkangjiten receptorëve të qelizave të tumorit. Kur mbaron ky proces, krijohet një fushë magnetike, e cila lejon që



nanopjesëzat përbrenda qelizave të tumorit të bashkohen në një tufë dhe të vetë-shkatërrohen nëpërmjet procesit të apoptosjes.

Si rezultat i këtij eksperimenti, më shumë se gjysma e qelizave kanceroze në trup ishin shkëtërruar pa dëmtuar ndonjë qelizë të shëndetshme. Deri tani, ekipi i shkencëtarëve Koreano-Jugorë e kë testuar këtë

eksperiment vetëm me peshk të llojit zebër. I vetmi efekt që shkencëtarët vunë re ishte rritja jo-normale e bishtit të peshkut.

Hulumtimet dhe eksperimentet vazhdojnë akoma, dhe do të marrë shumë kohë para se ky eksperiment të provohet në trupat e njerëzve.

TESTIMET PËR IMPLANTIN E TRURIT QË NGADALËSON SKLEROZËN

Kirurgët e një spitali në Amerikë kanë aplikuar me sukses një pajisje stimuluese truri me shpresat për të ngadalësuar efektet e sklerozës. Kjo është një nga operacionet e para të këtij lloji në SHBA.

Kjo pajisje stimuluese përmban një komplet elektrodash që dërgojnë impulse me ndihmën e baterisë që vendoset nën lëkurë. Këto elektroda përdoren për të stimuluar rritjen e hipokampusit, pjesën e trurit që është përgjegjës për kthimin e memories së humbur afat-shkurtër, në afat-gjatë. Dhe kjo është pjesa e parë e trurit që fillon të zvogëlohet, kur një njeri ka sklerozë.

Si pjesë e studimit, në vitin e ardhshëm rreth 40 pacientë me raste të buta skleroze nga Amerika Veriore do të operohen.

Implantimi i stimulimit të thellë të trurit është përdorur më përpara në Evropë dhe Kanada për të trajtuar sëmundjen e Parkinsonit, depresionin, sindromën e Tourette-s (sëmundje e sistemit nervor), dhe sëmundje të tjera të trurit.

Në një studim në 2010-n në Kanada, masa e hipo-

kampusit në një nga gjashtë pacientë u rrit me tetë përqind pas 12 muajve stimulim, një rritje rekord kjo, pasi asnjëherë më parë nuk kishte pasur rritje të hipokampusit, sidomos në pacientët me sklerozë.

Por këto studime janë në fazat e para, dhe asgjë nuk është në konkluzion, por n.q.s. stimulimi i trurit nuk ka ndonjë efekt negativ në ndonjë organ tjetër, atëherë mund të themi se kemi arritur përparime të mëdha. Ngadalësimi i efektit të sklerozës do të rriste pa dyshim kualitetin e jetesës për njerëzit me atë sëmundje.



10 USHQIMET QË JU NDIHMOJNË TË DIGJNI MË SHUMË KALORI

PA DISKUTIM QË NUK MUND TË MUNGOJË MOLLA

Mund të mos jenë të mirë dhe tëshijshem si çokollata dhe sallami, por ka ushqime që kanë ende avantazhin e të bërit mirë dhe madje t'ju ndihmojnë të humbni peshë. Janë ushqimet që të lirojnë nga fajet, dhe i pari siç



mund të imagjinoni është molla. Është një ushqim aq i mrekullueshëm sa të mbaje mjekun larg jush, duke përfshirë dhe dietologun. Por të kujdesshëm, që të jetë efektive si ushqim duhet të jetë e gjelbër në mënyrë rigoroze. Vlera e shtuar e këtij fruti është bolleku me fibra dietetike, e cila jep një ndjenjë ngopjeje dhe shërben për të djegur yndyrnat. Me pak fjalë, për këto 52 kalori që na lënë 100gr mollë nuk duhet të ndjeni faj për asgjë. Përkundrazi.

KASTRAVECI

Dieta e ushqimeve me kalori negative mund të djegë shumë shpejt rezervat e yndyrës së tepert në trup. Një nga këto ushqime me kalori negative është padyshim kastraveci. Mjafton vetëm ta shohim dhe ta shijojmë



atë për të kuptuar se kjo nuk është një bombe kalorike, por kjo perime nuk ka merite vetëm që përmban 16 kalori në 100 gram, ajo ka shumë më shumë: Kastraveci redukton nivelet e inflamacionit, është i pasur me vitaminë C dhe acid kafeik, të cilat ndihmojnë në uljen e dehidratimit.

ASPARAGU

Një tjetër ushqim i denjë për një vend në mesin e ushqimeve është asparagu. Është diuretik dhe një ilaç i



vërtetë për shtatzaninë. Kjo perime është vërtetë një thesar i ushqimeve të dobishme dhe ndihmon në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, në sajë të vetive anti-inflamatore dhe antioksidante. Vlen të theksohet se 100gr asparag është ekuivalente me praktikisht 20 kalori.

LULELAKRA

Sigurisht ta gatuash ajo nuk jep erën e dëshiruar në shtëpi, por ja vlen në sajë të 25 kalorive për 100 gr. Lule-



lakra është e pasur me vitaminë C dhe vitamine K, nuk ka yndyrë, është një burim i shkëlqyer me fibra dhe ka avantazhin e të qenit mjaft e shijshme për të ngrënë. Se fundi aktivizon metabolizmin. Për nxjerrjen e kalorive nga lulelakra trupi duhet të punojë më shumë se me ushqimet e tjera.

SELINOJA

Në të ngrënë nuk është aq e mirë, por ajo është aq e pasur dhe përfitimet që keni nuk do arrini ti besoni. Së pari për një 100gr selino kaloritë e përfutuara janë



16. Por përmbajtja e saj prej 75% ujë tregon se djeg me tepër se ajo që konsumohet. Pa harruar se 25% e mbetura janë fibra të cilat janë të pasura me natrium dhe kalium.

GJELI I DETIT DHE PULA

Lajme të mira. Për të humbur peshë nuk duhet vetëm të hamë ushqime me përmbajtje të lartë uji. Edhe mish-



ra të caktuar kanë mundësi të hynë në listën e ushqimeve me kalori negative. Gjeli i detit përmban 145 kalori për 100gr dhe gjoksi i pulës 172 kalori, por cilësia e tyre më e mirë është fakti se janë burim i proteinave, duke e detyruar sistemin e tretjes për të punuar më fort.

DOMATJA

18 kalori për 100gr, vitaminë C dhe licopen (antioxidant) do ta bëjnë atë një mikeshë të vlefshme të shëndetit, madje edhe më e rëndësishme se dietat. Domatja është konsideruar e rëndësishme në parandalimin



e sëmundjeve të zemrës, për shkak të efikasitetit të saj kundër kolesterolit dhe presionit të lartë të gjakut. Acidi citrik stimulon prodhimin e lëngjeve gastrike dhe ndihmon metabolizmin. E pasur me ujë, sasi të vogël yndyre, e mbushur me kalori. Dhe jo rastësisht ajo gjendet në pothuajse të gjitha dietat.

PAPAJA

Për 100gr papaja ju përfitoni 43 kalori, por mbi të gjitha papaja lufton kapsllëkun dhe ndihmon për të mbajtur nën kontroll kolesterolin. E pasur me fibra dhe



antioxidante ajo përmban sasi të medha të vitaminës A, C dhe E dhe forcon muret arteriale. Sheqernat e këtij fruti përshpejtojnë metabolizmin dhe favorizojnë djegjen e kalorive.

SPECI I KUQ DJEGES

Ai ka 40 kalori për 100gr dhe shkakton djegie në të gjitha kuptimet. Ai përmban kapsaicine. Speci djegës



ka aftësinë për të rritur metabolizmin tuaj dhe detyron trupin për të djegur më shumë kalori, madje ky efekt ndodh menjëherë pasi e keni konsumuar.

KAFEJA

Kafeja përmban vetëm 2 kalori, me kusht që mos të korigjohet me sheqer ose diçka tjetër. Pra kafeja e zezë është një prej përbërësve që mund të konsiderohen me zero kalori. Nuk është gjithmonë një substance miqësore me shëndetin pasi me doza të tepruara mund të jetë e dëmshme për zemrën. Por ajo ka fuqi të jashtëzakonshme në djegjen e yndyrës.

